

# TOLERANCA FETARE NË SHQIPËRI



*Empowered lives.  
Resilient nations.*







**Institute for Democracy and Mediation**  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



*Empowered lives.  
Resilient nations.*

# Toleranca Fetare në Shqipëri

Ky raport është një botim i pavarur i porositur nga UNDP. Pikëpamjet, analizat dhe rekomandimet e politikave të shprehura në këtë botim i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Kombeve të Bashkuara, të UNDP-së, të Bordit Ekzekutiv ose të Shteteve të tij Anëtare.

**Ekipi hulumtues i IDM:**

Gjergji Vurmo, autor dhe hulumtuesi kryesor  
Enis Sulstarova, autor kontribues dhe hulumtues  
Aleka Papa, autore kontribuese dhe hulumtuese

Elona Dhembo, hartimi i metodologjisë  
Dalina Jashari, hulumtuese

**Shqyrtimi nga Paneli i Ekspertëve i UNDP-së**

Eno Ngjela, UNDP Shqipëri  
Eni Kristo, UNDP Shqipëri

Jagoda Walorek, Qendra Rajonale e UNDP në Stamboll, Turqi  
Natalia Mirimanova, Qendra Rajonale e UNDP në Stamboll, Turqi  
Shelley Inglis, Qendra Rajonale e UNDP në Stamboll, Turqi

# Përmbajtja

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>4</b>
<b>II. PARATHËNIE</b>	<b>8</b>
<b>III. METODOLOGJIA</b>	<b>10</b>
III.1. Instrumentet e hulumtimit	11
III.2. Sondazhi publik për tolerancës fetare: kampionimi statistikor	14
III.3. Diskutimet në fokus grupe për gjetjet e sondazhit	16
<b>IV. ÇFARË ËSHTË TOLERANCA FETARE DHE CILËT JANË FAKTORËT QË E MUNDËSOJNË ATË NË SHQIPËRI? SHOYRTIM I LITERATURËS</b>	<b>18</b>
IV.1. Përkufizimi i tolerancës	19
IV.2. Faktorët që mbështesin tolerancën fetare	22
<b>V. SONDAZHI PUBLIK</b>	<b>26</b>
V.1. Përshkrimi i kampionit	26
V.2. Gjetjet e sondazhit	36
V.2.1. Individit dhe e shenjta	36
V.2.2. Perceptimet për tolerancën fetare	45
V.2.3. Qëndrimet dhe eksperiencat lidhur me tolerancën fetare	51
<b>VI. DISKUTIMET NË FOKUS GRUPE PËR GJETJET E SONDAZHIT</b>	<b>62</b>
<b>VII. PËRFUNDIME</b>	<b>74</b>
<b>VIII. BIBLIOGRAFIA</b>	<b>79</b>
<b>IX. SHTOJCAT</b>	<b>80</b>
IX.1. Pyetësi i sondazhit	80
IX.2. Shpërndarja e Kampionit të Sondazhit	90

# I. PËRMBLEDHJE

**SH**QIPTARËT e konsiderojnë tolerancën fetare si një vlerë themelore, më shumë të rrënjosur thellë në traditën dhe vlerat e tyre morale e shoqërore sesa të përjetuar si praktikë, bindje, apo politikë sociale, të cilat mbështeten në njohjen e feve të ndryshme dhe pranimin e ndryshimeve fetare. Kështu, tradita, edukimi qytetar dhe vlerat morale shërbejnë si bazë e përbashkët për pjesën më të madhe të shqiptarëve (jofetarë), të cilët besojnë se një shoqëri më fetare ka të ngjarë të jetë më pak tolerante për sa i përket fesë nga njëra anë, ndërsa besimtarët e përkushtuar nuk e perceptojnë besimin fetar dhe tolerancën si përjashtuese të njëra tjetrës.

Shumica e shqiptarëve bëjnë një jetë laike. Ata kanë pak informacion apo njohuri për fenë dhe kundërshtojnë idenë se pikëpamjet fetare duhet të formësojnë apo të kushtëzojnë mënyrën e tyre të jetesës. Ndonëse më shumë se një e treta (37 për qind) e konsiderojnë veten si besimtarë praktikantë të fesë, vetëm pak më shumë se një e katërta (28 për qind) pohojnë se miqtë dhe bashkëpunëtorët e tyre i identifikojnë ata si persona që praktikojnë fenë. Këto përqindje janë më të ulëta mes atyre që praktikojnë fenë, me më pak se dy nga dhjetë shqiptarë që praktikojnë ritet fetare rregullisht, ose që udhëhiqen nga rregullat fetare në jetën e tyre të përditshme.

Konstatohet se perceptimi që mbizotëron tek shqiptarët që praktikojnë fenë lidhet me bindjen se besimi fetar ka të bëjë më shumë me besimin në Zot sesa me kryerjen e riteve fetare. Në këtë kuptim, falja/lutja si rit apo zakon fetar nuk është domosdoshmërisht tregues i një personi që praktikon fenë. Rreth gjysma e shqiptarëve që falen/luten rregullisht, çdo ditë apo javë, deklarojnë se i praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare. Sidoqoftë, qëndrimet që i japin rëndësi më të madhe praktikimit të riteve fetare kanë disa baza të qëndrueshme në shoqërinë shqiptare, veçanërisht në komunitetet rurale dhe në një farë mase edhe tek shqiptarët e moshës mbi 45 vjeç. Këta individë janë më shumë të ndërgjegjshëm për besimin e tyre fetar dhe, po ashtu, e shohin praktikimin e riteve fetare si një pjesë themelore të jetës si besimtarë fetarë që praktikojnë fenë e tyre.

Shumica e shqiptarëve bëjnë një jetë laike:  
Ata kanë pak informacion apo njohuri për  
fenë dhe kundërshtojnë idenë se pikëpamjet  
fetare duhet të formësojnë apo të kushtëzojnë  
mënyrën e tyre të jetesës.

Shqiptarët e mirëpresin diversitetin fetar që është i pranishëm në vend dhe e kundërshtojnë me forcë idenë e epërsisë së një feje të caktuar ndaj të tjerave, pavarësisht nga madhësia e komunitetit përkatës fetar. Ata tregojnë pak mbështetje për deklarata të tilla si: “Vetëm një fe është e vërtetë, fetë e tjera janë false” dhe mbështesin më shumë opinionet dhe qëndrimet që evidentojnë dhe nxjerrin në pah një bazë të përbashkët mes feve të ndryshme si dhe moralin dhe vlerat hyjnore që ato promovojnë në shoqëri. Përveç kësaj, shqiptarët i kundërshtojnë me vendosmëri stereotipet negative rreth grupeve ose individëve fetarë që bazohen në përkatësinë e tyre fetare. Kështu, përkatësia fetare nuk është faktor me të cilin të karakterizohen njerëzit sipas cilësive, si punëtorë, miqësorë, inteligjentë, të dhunshëm ose dembelë. Shumica e shqiptarëve ndajnë të njëjtin mendim rreth ndjenjës së rrezikut apo shqetësimit kur bëhet fjalë për anëtarë të grupeve të tjera fetare, duke zbuluar kështu një empati (ndjeshmëri) jo-sektare.

Konteksti i mësipërm për sa i përket besimit fetar dhe vetëdijes fetare të shqiptarëve formëson perceptimet e njerëzve për tolerancën fetare në Shqipëri; si manifestohet ajo; faktorët që e mundësojnë atë; dhe rreziqet me të cilat ballafaqohet ajo.

Laicizmi dhe mosndërrhyrja e shtetit në besimin fetar të individit konfirmohet nga më shumë se 90 për qind e shqiptarëve. Edhe pse identiteti kombëtar ka si bazë të fuqishme mbështetjen ideologjike të laicizmit të shtetit shqiptar që nga krijimi i tij, shoqëria e sotme shqiptare ende e vlerëson shumë sloganin e njohur të Rilindjes Shqiptare: “Feja e shqiptarit është shqiptaria” (Vaso Pasha, 1880). Është pikërisht në këtë kontekst që mund të vërehet “mungesa e informacionit për fetë si faktori i raportuar më shpesh për tolerancën fetare në Shqipëri”. Ky përfundim gjen mbështetje edhe në faktin se faktori i dytë i raportuar më shpesh që mundëson tolerancën fetare në vend, sipas këtij studimi, është “mbizotërimi i traditave dhe i kulturës kombëtare mbi ato fetare”.

Edhe pse shqiptarët e vlerësojnë shumë rolin e drejtuesve të komuniteteve fetare dhe klerikëve vendorë në nxitjen e tolerancës fetare në vend, instrumentet kyçe që mundësojnë një tolerancë të tillë janë thelbësisht laike dhe lidhen me vlera të tilla si respektimi i lirive individuale dhe mbizotërimi i traditës dhe vetëdijes kombëtare mbi ato fetare. Së bashku, këta tre faktorë raportohen më shpesh nga vetë shqiptarët, faktorë që mundësojnë tolerancën fetare dhe janë pjesë përbërëse e faktorit të katërt më shpesh të raportuar: laicizmit. Faktori i pesë - trashëgimia komuniste e ateizmit – i ndan të intervistuarit e këtij studimi për sa i përket mendimeve të tyre mbi këtë faktor si faktor i mundësues, ku vihen re ndryshime tek pikëpamjet mes brezit të ri dhe atij të vjetër. Kështu, shqiptarët që kanë përjetuar të kaluarën komuniste dhe e kujtojnë atë e konsiderojnë trashëgiminë e ateizmit si një faktor që ka kontribuar në tolerancën fetare në një përqindje shumë më të lartë krahasuar me brezat e rinj. Megjithatë, siç tregohet nga analizat e mëtejshme të ndërmarra nga ky studim (diskutimet në fokus grupe), trashëgimia nuk perceptohet si një faktor që nxit tolerancën fetare, por më shumë si një rrethanë në historinë shqiptare që keqinterpretoi sloganin e Rilindjes shqiptare (feja e shqiptarit është shqiptaria) për të përligjur armiqësinë e regjimit komunist ndaj fesë.

Ekstremizmi fetar, terrorizmi, politizimi i fesë, rreziqet dhe propaganda e jashtme, apo konfliktet e huaja përfaqësojnë kërcënimet më shpesh të raportuara për tolerancën fetare në vend. Kështu, perceptimet e shqiptarëve për kërcënimet e mundshme ndaj tolerancës fetare në Shqipëri janë të lidhura më shumë me panoramën globale sesa me faktorët vendorë apo ato me bazë komuniteti. Në të njëjtën linjë, shqiptarët priren të kenë një mendim më të mirë për tolerancën fetare në nivel shoqërie në Shqipëri sesa në nivel komuniteti ku jetojnë. Pra, në një shkallë nga një (indiferencë e plotë fetare) deri në pesë (e njohin plotësisht dhe e pranojnë besimin fetar të të tjerëve), gati 52 për qind e shqiptarëve e vlerësojnë shoqërinë e tyre si tërësisht ose mesatarisht të ndërgjegjshme dhe tolerante për sa i përket fesë (me katër dhe pesë pikë), krahasuar me 43 për qind kur iu kërkua të vlerësonin komunitetin në të cilin jetojnë. Dallimi mes përqindjes së atyre që e konsiderojnë shoqërinë shqiptare dhe ata që e konsiderojnë komunitetin e tyre si indiferentë për sa i përket fesë është shumë më e vogël.

Shqiptarët nuk janë tërësisht të imunizuar ndaj paragjykimeve për të tjerët, as ndaj diskriminimit ose përjashtimit për shkak të përkatësisë fetare. Ndërkohë që 90 për qind e shqiptarëve ndeshen me zakonet e fajësimit të njerëzve nga besimet e tjera fetare për gjendjen ekonomike, krimin, për mungesën e vendeve të punës dhe për korrupsionin mes vlerave të shoqërisë, rreth 14 për qind fajësojnë njerëzit nga fetë e tjera për pjesën më të madhe të problemeve të kësaj bote. Më pak se 10 për qind e shqiptarëve marrin parasysh besimin fetar kur krijojnë marrëdhënie të ngushta personale (me shokë të ngushtë 4 për qind, dhe lidhje krushqie 9 për qind). Ky studim konstaton se të anketuarit që e konsiderojnë veten si besimtarë praktikantë të rregullt të fesë priren të jenë më pak të hapur për të bërë krushqi me anëtarë të besimeve të tjera fetare.



Ky studim konstaton se bazat e tolerancës fetare në Shqipëri janë thellësisht të rrënjosura në traditat dhe kulturën shoqërore dhe nuk vijnë nga vetëdija, njohuritë apo ushtrimi i riteve fetare.

Mbi 95 për qind e shqiptarëve konfirmojnë se ata ose anëtarë të familjeve të tyre nuk janë diskriminuar apo përjashtuar për shkak të përkatësisë fetare. Rreth 11 për qind thonë se ata kanë qenë dëshmitarë, të paktën një herë, në një rast diskriminimi ose përjashtimi për shkak të fesë në komunitetet e tyre. Shumica e këtij grupi janë gra; jetojnë në zona urbane, dhe kanë përfunduar arsimin e mesëm ose të lartë. Shembujt lidhen kryesisht me diskriminimin dhe përjashtimin e njerëzve që ushtrojnë fenë (sidomos myslimanët), përfshirë këtu akte të tilla si diskriminimi ose përjashtimi në sektorin publik dhe privat; paragjykimet shoqërore dhe përjashtimi; dhe diskriminimi në marrëdhëniet e ngushta (p.sh. refuzim martesë/krushqie për shkak të përkatësisë fetare).

Pavarësisht këtyre qëndrimeve ndaj të tjerëve, të pranishme në pak më shumë se një në dhjetë shqiptarë, janë pikërisht këto dukuri që shumica e shqiptarëve i ngrenë si shembuj të tolerancës fetare. Pra, “martesat e përziera fetare”, “kremtimet e festave fetare të besimeve të tjera” dhe “bashkëjetesa paqësore e shqiptarëve me prejardhje të ndryshme fetare” janë shembujt që shumica e shqiptarëve përmendim më shpesh për të ilustruar tolerancën fetare.

Ky studim konstaton se bazat e tolerancës fetare në Shqipëri janë thellësisht të rrënjosura në traditat dhe kulturën shoqërore dhe nuk vijnë nga vetëdija, njohuritë apo ushtrimi i riteve fetare. Teksa njohin rolin e udhëheqësve fetarë në nxitjen e tolerancës fetare në ditët e sotme si dhe gjatë historisë, shqiptarët u japin rëndësi më të madhe ndarjes ligjore dhe praktike mes shtetit dhe fesë; respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; laicizmit si një tipar të shoqërisë; dhe ndjenjave kombëtare, si faktorë kryesorë që mundësojnë tolerancën fetare. Toleranca fetare si vlerë themelore e shoqërisë shqiptare përbën një element bashkimi për qytetarët me përkatësi të ndryshme fetare në vend.

## II. PARATHËNIE



**M**ENAXHIMI i diversitetit është sfida e kohëve tona. I detë dhe ëndrrat kapërcejnë kufijtë me një të prekur ekran, duke ndikuar në pikëpamjet e njerëzve dhe individëve për të kaluarën dhe pritshmëritë për të ardhmen. Menaxhimi i identiteteve të shumta – etnike, fetare, mes brezave, seksuale, historike, politike – po pranohet përherë e më shumë si normë dhe ka shumë organizata e aplikacione që na lutën t’i përdorim ato identitete në një mënyrë apo në një tjetër.

Shtetet që mund ta menaxhojnë këtë diversitet në forma të atilla që fuqizojnë qytetarët dhe organizatat, respektojnë të drejtat e njeriut dhe ndërtojnë paqe të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse, do të ecin më shpejt nga të gjithë në rrugën drejt Agenda2030.

Në fushën e diversitetit fetar, Shqipëria ofron një rast bindës studimor. Raporti për Zhvillimin e të Drejtave për Shqipërinë për vitin 2016 thotë se “bashkëjetesa fetare përbën arritjen më të rëndësishme që është bërë në jetën politike dhe intelektuale në Shqipëri në njëqind vitet e fundit të ekzistencës së shtetit shqiptar.” Shqipëria njihet gjerësisht për bashkëjetesën paqësore mes feve aktive. Të shtypura gjatë regjimit komunist dhe të ringritura vetëm në fillim të viteve 90, institucionet fetare në Shqipëri kanë shfaqur një ndjenjë të madhe komuniteti dhe respekti të ndërsjellë. Kjo e ka origjinën në vitet e para dhe menjëherë pas pavarësisë së vendit më 1912. Vitin e kaluar, Raportuesi Special i Këshillit të të Drejtave të Njeriut të OKB-së për Liritë Fetare vizitoi Shqipërinë. Në raportin e tij rikonfirmojë toleranca e jashtëzakonshme që mbizotëron në Shqipëri, edhe pse jo pa përmendur disa fusha për përmirësim<sup>1</sup>.

Ndërkohë, intoleranca fetare gjatë mijëvjeçarit të fundit ka pasur lidhje me dhunën, madje në shumë raste me pasoja tragjike në jetë njerëzish. Në botën e sotme, e keqja e madhe është rekrutimi në organizata që angazhohen në ekstremizmin e dhunshëm.

Kështu që, kur lind një rast shpresëdhënës, si rasti i Shqipërisë, me të drejtë na këshillohet që ta studiojmë me kujdes këtë rast. Ndërkohë që studimet e mëparshme në Shqipëri kanë analizuar

1. <http://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=21627&LangID=E>

ekstremizmin e dhunshëm, shkaqet dhe shfaqjet e tij, ky studim i porositur nga UNDP me mbështetje të Qendrës Rajonale në Stamboll, shqyrton dukuritë pozitive të tolerancës.

Bashkëjetesa paqësore fetare e Shqipërisë duhet të përgëzohet me plot të drejtë, por nuk duhet marrë si e mirëqenë. Është e nevojshme të kuptohet përbërja sociale e Shqipërisë dhe si ndërthuren përkatësia dhe praktika fetare në të, nëse Shqipëria do të vazhdojë ende të investojë dhe të përfitojë nga toleranca e saj e mirënjohur.

Dhe me përlësinë që kërkohet në hulumtime të tilla, ndoshta edhe ne të tjerët do të kemi diçka për të mësuar. A mund të kontribuojë kultura e respektit dhe harmonisë fetare në krijimin e një mjedisi që i mbron të rinjtë nga ndjesia e të qenit i huaj në një shoqëri që zhvillohet me shpejtësi? Apo të paktën të imunizohet shoqëria nga armët radikalizuese të aktorëve që kërkojnë të instrumentalizojnë dallimin nga të tjerët?

Shpresojmë që ky vlerësim empirik do të informojë debatin e politikave në mënyrë që përpjekjet për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm të bëhen më të zhdërvjella dhe efektive. Besojmë se ka vend për të ecur përtej programeve të brezit të parë që synojnë fenomenin e rekrutimit. Programet mund të përqendrohen më shumë tek vlerat, tek praktika demokratike, tek rritja e mundësisë që të rinjtë të jenë produktivë në shoqëri gjatë gjithë jetës së tyre (kjo nënkupton shumë më tepër se një vend pune), tek dialogu në komunitet dhe natyrisht tek toleranca mes një sërë identitetesh në zhvillim, përfshirë edhe atë fetar.

Siç e tha edhe Papa Françesku gjatë vizitës së tij në vitin 2014, përvoja e Shqipërisë tregon se bashkëjetesa paqësore dhe frytdhënëse mes personave dhe komuniteteve të besimtarëve të feve të ndryshme nuk është vetëm e dëshirueshme, por edhe e mundur dhe realiste.

Kombet e Bashkuara mbeten të përkushtuara për të mbështetur –dhe për të ecur më tej– drejt një vizioni të tillë të solidaritetit njerëzor.

Brian J. Williams

Koordinator Rezident i Kombeve të Bashkuara dhe Përfaqësues Rezident i UNDP

[#standup4humanrights](#)

# III. METODOLOGJIA

**N**DONËSE toleranca dhe harmonia fetare janë përdorur gjerësisht në diskutimet publike si një vlerë thelbësore e shoqërisë shqiptare, ka shumë pak dëshmi dhe analiza të realitetit apo elementëve të saj, madje edhe në vetë konstruktin ose në përkufizimin e saj aktual. Ndërkohë që disa studime janë përpjekur të analizojnë konceptin nëpërmjet shembujve nga historia shqiptare (p.sh., mbrojtja e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore), për të tjerët ka qenë një çështje pa ndonjë rëndësi të veçantë. Më e rëndësishmja, si në diskutimet publike ashtu edhe në ato akademike përdoren terma dhe përkufizime të ndryshme për ta përshkruar këtë vlerë, siç është harmonia fetare, toleranca ose thjesht bashkëjetesa.

Për t'iu përsiatur shqyrtimit të këtij koncepti, një ekip hulumtues nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) bëri një shqyrtim të literaturës dhe një analizë të përkufizimit të tolerancës fetare. Siç trajtohet edhe më poshtë në seksionin e shqyrtimit të literaturës, ky studim e përdor termin të bazuar nga ana akademike ashtu edhe të përshtatshëm për kontekstin shqiptar.

Për shqyrtimin e tolerancës fetare si koncept dhe praktikë, faktorët që e mundësojnë atë, bazat dhe përmasat e saj në Shqipëri, ekipi hulumtues u konsultua me studime të ndryshme të aplikuara kërkimore së bashku me metodologjitë e tyre me tema të njëjta ose të ngjashme dhe të krahasueshme, të tilla si metodologjia e Indeksit të Kohezionit Social dhe Pajtimi (SCORE),<sup>2</sup> Intoleranca, Paragjykimet dhe Diskriminimi: Raport Evropian (FES 2011)<sup>3</sup>, si dhe raporte të tjera. Përfundimi i kësaj procedure ishte se “për të arritur në evidenca të përshtatshme dhe për të kuptuar tolerancën fetare në Shqipëri është e nevojshme të hartohet një metodologji specifike për kontekstin.”<sup>4</sup>

U hartua një metodologji e posaçme për kontekstin për të bërë një analizë bazë të tolerancës fetare në vend, nëpërmjet evidencave dhe të dhënave përkatëse që na lejojnë të shkojmë përtej një diskutimi për tolerancën fetare ku përdoren shembuj të vjetëruar.

2. Indeksi i Kohezionit Social dhe Pajtimin (Social Cohesion and Reconciliation - SCORE) është u hartua nëpërmjet një partneriteti ndërmjet UNDP-ACT dhe Qendrës për Paqe të Qëndrueshme dhe Zhvillim Demokratik (Centre for Sustainable Peace and Democratic Development - SeeD), me financim nga USAID. Indeksi SCORE është një mjet i hartuar për matjen e kohezionit social dhe pajtimin si dy tregues të paqes në shoqëritë shumetnike në botë. Në sajë të objektivit të Indeksit bëhet i mundur shqyrtimi i marrëdhënieve brenda dhe mes grupeve etnike, fetare dhe grupeve të tjera shoqërore në kontekste ku ka ose ende është në rrezik bashkekzistenca paqësore midis këtyre grupeve. Që nga viti 2013, SCORE është aplikuar në pesë shtete: Qipro, Nepal, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Ukrainë. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni <http://www.scoreforpeace.org/methodology>. Data e shqyrtimit 31 gusht 2017.

3. Beate Küpper, Andreas Zick dhe Andreas Hövermann (2011) raporti i të cilëve ofron të dhëna të plota dhe të krahasueshme për shkallën e paragjykimin dhe diskriminimit kundër grupeve kryesore të synuara në 8 shtete të zgjedhura evropiane, sipas të dhënave të sondazhit të mbledhura nga një projekt kërkimor i Universitetit të Bielefeld-it. Raporti gjendet në adresën <http://library.fes.de/pdf-files/do/07908-20110311.pdf>. Data e shqyrtimit 31 gusht 2017.

4. Edhe pse raportet dhe metodologjitë e konsultuara ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse për fokusin e hulumtimit të tyre në një kontekst të dhënë, procesi i vleftësimit i kryer nga ekipi i IDM-së sugjeron se konteksti shqiptar është shumë i ndryshëm nga konteksti historik, socio-politik dhe ekonomik në të cilin u aplikuan këto studime.

## III.1. Instrumentet e hulumtimit

Gjatë periudhës Prill-Shtator 2017 u realizuan instrumentet dhe procedurat e mëposhtme të hulumtimit:

### 1. SHQYRTIMI I LITERATURËS PËR TOLERANCËN FETARE

Ky shqyrtim kishte qëllim të dyfishtë: së pari për të eksploruar alternative të mundshme hulumtimi dhe metodologjike për analizimin e tolerancës fetare në Shqipëri; dhe, së dyti, të vendoste një përkufizim funksional e të evidentonte supozimet kyçe, elementët kryesorë, bazat, faktorët mundësues dhe kërcënimet e mundshme që lidhen me tolerancën fetare në vend.

### 2. INTERVISTA DHE FOKUS GRUPE ME AKTORË TË INFORMUAR

Diskutime në fokus grupe me disa profesorë universiteti dhe hulumtues që studiojnë marrëdhëniet fetare dhe perceptimet e publikut në Shqipëri për të vërtetuar:

- Qasjen metodologjike
- Një përkufizim të vlefshëm të tolerancës fetare
- Dallimet mes përkufizimit dhe perceptimeve të qytetarëve të zakonshëm (si e përkufizojnë ata dhe çfarë duan të thonë)
- Supozimet kryesore për t'u vërtetuar nëpërmjet një sondazhi publik

Informacioni dhe qasja e vërtetuar u diskutuan në intervista të veçanta me zyrtarët dhe teologët nga bashkësitë fetare në Shqipëri dhe me një përfaqësues të Komitetit Shtetëror të Kulteve.

### 3. PYETËSORI DHE SONDAZHI PUBLIK

Bazuar në gjetjet e hulumtimit cilësor (intervista dhe shqyrtimi i literaturës), u hartua një instrument sondazhi (pyetësori), i cili u testua me 200 të anketuar të një demografie të ndryshme në fillim të muajit korrik 2017. Komentet dhe sugjerimet u mblodhën nga aktorët dhe ekspertët përkatës para dhe pas fazës pilot, duke përfshirë edhe ekipin e ekspertëve të UNDP-së.

Pyetësori u finalizua në 14 korrik dhe, përveç seksionit të demografisë, u përfshinë edhe tre pjesë, ku secila synonte të mblidhte informacion specifik në lidhje me analizën e studimit, si më poshtë:

#### A. Individit dhe hyjnorja/e shenjta

Në këtë seksion synohej shqyrtimi i nivelit të fetarisë së të anketuarve, qëndrimet e tyre ndaj vlerave fetare dhe morale, nëse ndikojnë ato në jetën e të anketuarve dhe si. Në të njëjtën linjë me gjetjet e hulumtimit cilësor, informacioni i mblodhur nga kjo pjesë ishte veçanërisht i rëndësishëm për vlerësimin se si ndikon besimi i një individit tek perceptimet, qëndrimet dhe përvojat e tij ose të saj me tolerancën fetare, të cilat shtjellohen më pas në pjesët e mëtejshme të pyetësorit.

## Instrumentet e Hulumtimit

1. SHOYRTIMI I LITERATURËS  
PËR TOLERANCËN FETARE

2. INTERVISTA DHE FOKUS GRUPE  
ME AKTORË TË INFORMUAR



### B. Perceptime mbi tolerancën fetare në Shqipëri

Në pjesën e dytë të pyetësorit u shtjelluan perceptimet e të anketuarve për tolerancën fetare në Shqipëri, kërcënimet dhe faktorët mundësues dhe qëndrimet në nivel vendor dhe të shoqërisë ndaj bashkëjetesës fetare.

### C. Qëndrimet dhe eksperiencat lidhur me tolerancën fetare

Në pjesën e fundit të pyetësorit u shtjelluan eksperiencat praktike të të anketuarve me tolerancën dhe intolerancën fetare, qëndrimet dhe perceptimet e tyre apo marrëdhëniet me grupet e tjera fetare.

Pas takimit të shkurtër informues të ekipit të sondazhit, më 16 korrik 2017 nisi puna në terren, bazuar në përzgjedhjen e kampionëve të kryer sipas procedurave të rrepta të përshkruara në nën-seksionin tjetër, me qëllim që të sigurohet një përfaqësim i saktë i perceptimeve të shqiptarëve.

Puna në terren u krye në fund të muajit korrik 2017 nga intervistues të trajnuar, në përputhje me procedurat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë. Futja dhe pastrimi i të dhënave u përfundua gjatë javës së parë të muajit gusht. Të dhënat e anketimit u analizuan duke përdorur aplikacionin SPSS. U krye një analizë univariate për të marrë një ide të përgjithshme të kampionit.

Të dhënat paraprake të sondazhit u analizuan për të shqyrtuar supozimet fillestare dhe për të planifikuar fazën e mëtejshme të hulumtimit (shih më poshtë).

U kryen edhe analiza bivariate për të parë dy variable (ndryshore) në të njëjtën kohë si dhe u bënë teste chi-square për të testuar rëndësinë statistikore të rezultateve.<sup>5</sup> Niveli i rëndësisë u caktua në vlerën  $p < 0.05$ .

5. Për një përshkrim të këtyre testeve shih Drake, Brett. dhe Jonson-Reid, Melissa (2007) Social Work Research Methods. From Conceptualization to Dissemination. Boston, MA: Allyn & Bacon.

### 3. PYETËSORI DHE SONDAZHI PUBLIK

### 4. DISKUTIME NË FOKUS GRUPE



#### 4. DISKUTIME NË FOKUS GRUPE

Për t'iu përgjigjur nevojave për një analizë të mëtejshme të të dhënave të sondazhit publik dhe për t'i kuptuar më mirë ato, në fund të gushtit dhe fillimit të shtatorit 2017 u bënë gjithsej gjashtë diskutime në fokus grupe me qytetarë të zakonshëm nga kategori të caktuara demografike. Siç përshkruhet në metodologjinë e fokus grupeve (shih nën-seksionin më poshtë), profilet e zgjedhura për diskutimet ishin si më poshtë:

- a. Fokus grupi 1: të rinj dhe të reja (18–30 vjeç) nga zonat rurale dhe urbane, me nivel të ndryshëm arsimor, status të ndryshëm punësimi, besim fetar dhe karakteristika të tjera demografike të ndryshme;
- b. Fokus grupi 2: femra nga grupmosha e zona të ndryshme, me nivel të ndryshëm arsimor, status të ndryshëm punësimi, besim fetar dhe karakteristika të tjera demografike të ndryshme;
- c. Fokus grupi 3: grup i përzier meshkujsh dhe femrash nga zona urbane dhe nga periferia e qendrave urbane me karakteristika të ndryshme demografike;
- d. Fokus grupi 4: grup i përzier besimtarësh praktikantë myslimanë me karakteristika të ndryshme demografike;
- e. Fokus grupi 5: grup i përzier besimtarësh praktikantë të krishterë me karakteristika të ndryshme demografike;
- f. Fokus grupi 6: grup i përzier meshkujsh dhe femrash nga zona rurale dhe me karakteristika të ndryshme demografike.

Drafti i parë i raportit u përgatit në mes të muajit shtator 2017 dhe u diskutua me ekspertë të zgjedhur nga Shqipëria dhe ekipin e ekspertëve të UNDP-së (shqyrtimi nga kolegët).

## III.2. Sondazhi publik për tolerancës fetare: kampionimi statistikor

Kampionimi statistikor për sondazhin publik u arrit duke ndjekur disa hapa të rëndësishëm në llogaritjen e vlerësimeve statistikore. Kjo është një pikë e rëndësishme, sepse në Shqipëri ende nuk ka informacione statistikore ose administrative të përditësuara rregullisht në lidhje me numrin e banorëve dhe shpërndarjen e tyre në bashkitë e njësitë e ndryshme administrative, ndërkohë që kampionimi statistikor duhet të projektohet duke u bazuar në numrin e banorëve në vend. Shpërndarja e numrit të banorëve vjen vetëm nga Censusi i kryer nga INSTAT, regjistrim që kryhet një herë në dhjetë vjet. Regjistrimi i fundit është ai i vitit 2011<sup>6</sup> dhe aktualisht është i vjetëruar duke pasur parasysh raportet e ndryshme të mediave për një lëvizje dinamike demografike nga Shqipëria.<sup>7</sup>

Studimi merr parasysh shqiptarët që jetojnë aktualisht në Shqipëri. Vështirësia me llogaritjen e vlerësimeve statistikore lidhet edhe me ristrukturimin territorial-administrativ të bashkive në vitin 2015. Për të marrë vlerësimet, ne kemi ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Si informacion bazë u përdor popullata e banorëve dhe shpërndarja e tyre mes njësite të ndryshme të qeverisjes vendore nga Censusi i vitit 2011.
- U mor parasysh edhe popullata sipas regjistrit të gjendjes civile të vitit 2015 (të shtetasve shqiptarë) dhe shpërndarja e tyre në bashki të ndryshme.

Për të përcaktuar pjesën e emigrantëve mes shtetasve shqiptarë përdorëm këto dy burimet më të fundit të informacionit dhe për të vlerësuar numrin e banorëve në çdo njësi bashkiake përcaktuam Koeficientin Sasior të Vendbanimit si më poshtë:

$$W_M = N_{M\_C2011} / N_{M\_CR2015}$$

ku:

$W_M$  është Koeficienti Sasior i Vendbanimit për secilën bashki.

$N_{M\_C2011}$  është numri i banorëve shqiptarë në bashki bazuar në Censusin e vitit 2011.

$N_{M\_CR2015}$  është numri i shtetasve shqiptarë të regjistruar në bashki sipas regjistrit civil të vitit 2015.

$W_M$  është vlerësimi më i mirë i përqindjes së numrit të shtetasve shqiptarë që banojnë në vend, sipas bashkive. Sipas Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011 numri i popullsisë rezidente shqiptare ishte 2,804,751, ndërsa regjistri civil i vitit 2015 e raporton numrin e përgjithshëm të shtetasve shqiptarë në 4,346,121, një raport prej rreth 0.65 dhe tregon emigrimin e madh të popullatës shqiptare. Është e qartë që kampionimi statistikor nuk mund të bazohet në shifrat e regjistrit civil, i cili merret lehtësisht dhe konsiderohet si i saktë. Parametrat statistikorë për  $W_M$ , të llogaritura për të 61 bashkitë, raportohen në Tabelën 1.

6. Për më shumë hollësi lutemi referojuni adresës <http://www.instat.gov.al/en/census.aspx>

7. Gjatë disa viteve të fundit ka pasur një sërë raportesh mediatike dhe zyrtare, veçanërisht nga vendet e BE-së, për rritjen e numrit të shqiptarëve që largohen nga vendi.



Nga 61 bashki që ka vendi u përzgjedhën 40 prej tyre, duke marrë parasysh bashkinë më të madhe dhe duke zëvendësuar disa bashki të vogla me njësi vendore të tjera për të siguruar mbulim sa më të madh gjeografik.

**TABELA 1. VLERËSIMET E PARAMETRAVE  $W_m$  (61 BASHKI)**

Parametri	Vlera
Mesatarja	0.61205
Ndryshorja	0.01733
Minimumi	0.15144
Maksimumi	0.82933

Mesatarja e 61 koeficientëve sasiorë të vendbanimit ishte 0.612, madje edhe më pak se shifra në rang kombëtar prej 0.65, të përmendur më sipër, me minimumin në 0.15 (Bashkia Dropull) dhe maksimumin në 0.83. Duke përdorur shifrën prej 0.65 dhe numrin total të shtetasve nga regjistri civil (2017, 4,430,415) numri i banorëve shqiptarë vlerësohet të jetë 2,859,598.

Për të llogaritur numrin aktual të banorëve sipas bashkive dhe njësive të tyre administrative u përdorën të dhënat nga regjistri civil i vitit 2017, të ponderuar nga Koeficientët Sasiorë të Vendbanimit për secilën bashki. Në veçanti, për të gjitha njësitë administrative u përdor koeficienti sasior i vendbanimit të bashkisë përkatëse si ponderim i llogaritjes së numrit të banorëve, duke supozuar se emigrimi ka një shpërndarje të njëjtë në të gjithë bashkinë.

Nga 61 bashki që ka vendi u përzgjedhën 40 prej tyre, duke marrë parasysh bashkinë më të madhe dhe duke zëvendësuar disa bashki të vogla me njësi vendore të tjera për të siguruar mbulim sa më të madh gjeografik.<sup>8</sup>

Kampioni statistikor përbëhej nga 1,100 të anketuar. Në nivel besueshmërie prej 95%, me popullsi prej 2,859,598, intervali i besimit të llogaritjeve ishte  $\pm 2.95$ . Në nivel besueshmërie prej 99%, me të njëjtën shifër popullsie, intervali i besimit të llogaritjeve ishte  $\pm 3.89$ .

8. Lista e plotë e bashkive të anketuara dhe shpërndarja rural-urban e të anketuarve jepet në Shtojcën IX.2

### III.3. Diskutimet në fokus grupe për gjetjet e sondazhit

Si një nga metodat e mbledhjes së të dhënave që përdoren në hulumtimet cilësore, diskutimet në fokus grupe synojnë "t'u ofrojnë hulumtuesve mjete për mbledhjen e të dhënave që mund të përdoren për të mundësuar një përshkrim të dukurive që po shqyrtohen" (Dollar & Merrigan, 2002). Diskutimet në fokus grupe janë veçanërisht të dobishme kur hulumtuesit kanë si qëllim të shqyrtojnë qëndrimet dhe përvojat individuale subjektive që normalisht nuk mund të përftoheshin me forma të tjera hulumtimi (Krueger & Casey, 2000). Për më tepër, kur përdoren të shoqëruar edhe me sondazhe, ato mund të vërtetojnë gjetjet ose të shkojnë më thellë në shqyrtimin e marrëdhënieve që sugjerohen nga analiza sasiore (Brent et al., 1991). Në këtë kontekst, diskutimet në fokus grupe u përdorën në këtë hulumtim si mjet për të shqyrtuar më në thellësi nuancat personale të opinionëve të pjesëmarrësve në lidhje me aspekte të ndryshme të tolerancës fetare në Shqipëri dhe për të vërtetuar gjetjet e sondazhit publik.

Pas analizimit të rezultateve paraprake të sondazhit, gjatë muajve gusht dhe shtator 2017 u realizuan gjashtë diskutime në fokus grupe (me 6-12 pjesëmarrës në secilin grup). Çdo diskutim zgjati nga 60-90 minuta. Në këto diskutime morën pjesë gjithsej 54 vetë, të cilët u rekrutuan duke përdorur kampoinimin ortek (snowball sampling).

Grupet kishin përbërje homogjene dhe heterogjene. Homogjeniteti, apo të pasurit karakteristika të ngjashme në vektorë të ndryshëm socio-demografikë, u përdor metodologjikisht për të nxitur pjesëmarrjen dhe diskutimin dhe për të kufizuar numrin e fokus grupeve që do të duhej të kryheshin.

Në demografikën e përfaqësuar në fokus grupe (Tabela 2) bënte pjesë një grup me pjesëmarrës nga zonat urbane dhe nga periferia e qendrave urbane, një fokus grup vetëm me femra, një fokus grup me të rinj, një fokus grup me banorë të zonave rurale, dhe dy fokus grupe me besimtarë (një me besimtarë myslimanë dhe një me besimtarë të krishterë). Fokus grupet u krijuan për të mbuluar një sërë çështjesh të tolerancës fetare dhe për të trajtuar pyetje dhe çështje të veçanta që kishin dalë nga rezultatet paraprake të sondazhit.

TABELA 2. PËRBËRJA E FOKUS GRUPEVE

Pjesëmarrësit e fokus grupit	Data, Vendi	Nr. i pjesëmarrësve	Përbërja gjinore	Fokusi gjeografik
Të rinj	30.08.17, Tirana	10	E përzier	Tirana, Vora, Elbasani, Shijaku, Lushnja, Mirdita
Femra	31.08.17, Tirana	9	Vetëm femra	Tirana, Elbasani, Vora, Durrësi
Individë me kujtime të së kaluarës komuniste; zonat urbane	04.09.17, Tirana	10	E përzier	Tirana, Elbasani
Besimtarë myslimanë	07.09.17	8	E përzier	Tirana
Besimtarë të krishterë (katolikë dhe ortodoksë)	07.09.17	11	E përzier	Tirana, Durrësi
Individë me kujtime të së kaluarës komuniste; zonat rurale	08.09.17, Katund i Ri	6	E përzier	Katund i Ri (Durrësi)

Të dhënat u analizuan duke përdorur analizën tematike. Të dhënat nga të gjitha fokus grupet u analizuan për tematikat kryesore, ndërsa të dhënat nga secili grup pjesëmarrës u analizuan veçmas për të përshkruar tendencat që kufizoheshin vetëm në atë grup. Në këtë raport u përfshinë edhe citate të pjesëmarrësve gjatë diskutimeve në fokus grupe (shih Seksionin VI) për të bërë të mundur që të kuptohen dhe përvetësohen më mirë mënyrat në të cilat u shtjelluan dhe u kuptuan perceptimet dhe nocionet e ndryshme nga pjesëmarrësit.<sup>9</sup>

---

9. U përzgjedhën disa citate në të cilat evidentohen pikëpamjet e shprehura nga shumica e pjesëmarrësve.

# IV. ÇFARË ËSHTË TOLERANCA FETARE DHE CILËT JANË FAKTORËT QË E MUNDËSOJNË ATË NË SHQIPËRI?

## SHQYRTIM I LITERATURËS

Shqiptarët krenohen me traditën e tolerancës fetare. Besohet se është karakteristikë kombëtare, në kuptimin që shumica e njerëzve mendojnë se ajo daton që nga koha që s'mbahet mend. Shpjegime të zakonshme për tolerancën fetare janë sugjerimet që shqiptarët vlerësojnë kombin mbi çdo bindje fetare ose pretendimi se shqiptarët kanë qenë gjithmonë indiferentë ndaj çështjeve të fesë. Këto shpjegime janë pjesë e *doxa-s* (besim ose opinion i përhapur në popull), siç e përdor Pierre Bourdieu këtë term, sepse Shqipëria ka një histori të gjatë të tolerancës fetare. Nga një perspektivë afatgjatë, gjatë 200 viteve të fundit, toleranca fetare është pozicionuar në një mjedis të komplikuar kulturor dhe politik, të formuar, ndër të tjerash, nga rrënimi i Perandorisë Osmane dhe lindja e nacionalizmit shqiptar, krijimi i shtetit laik shqiptar, ndryshimet dhe zhvendosjet e sjella nga proceset e modernizimit, imponimi i izolimit dhe ateizmit nga regjimi komunist.

Duke pasur parasysh larminë fetare të shoqërisë shqiptare, ruajtja e kohezionit social dhe e tolerancës dhe harmonisë fetare, edhe në kohë të turbullta, ka qenë një arritje e jashtëzakonshme. Megjithatë, lind pyetja nëse toleranca fetare e dukshme në Shqipëri do të vazhdojë të lulëzojë në një botë të globalizuar, e cila karakterizohet nga rritja e shkëmbimeve dhe ndërveprimeve mes feve, rritja e diversitetit kulturor dhe sfidave të reja të krijuara nga fundamentalizmi fetar dhe terrorizmi. Një çështje tjetër është nëse toleranca fetare është tipar shqiptar apo një model social dhe kulturor që mund të "eksportohet" drejt konteksteve të tjera kombëtare dhe kulturore. Politikanët shqiptarë e kanë pikë të dobët të përdorin tolerancën fetare si markë të kombit, në një kohë kur vendet e tjera po përjetojnë probleme të rënda të shkaktuara nga ekstremizmi fetar, dhuna sektare dhe terrorizmi i frymëzuar nga feja. Një shembull i tillë i markës së kombit ishte marshimi krahar të njëri-tjetrit i katër klerikëve shqiptarë - një për secilën prej feve tradicionale - në demonstratën e solidaritetit që u zhvillua në Paris në janar 2015, pas sulmit terrorist kundër Revistës "Charlie Hebdo". Për të kuptuar më mirë faktorët socialë që ruajnë tolerancën fetare në Shqipëri dhe për ta vlerësuar atë si model për shoqëritë e tjera duhet të analizojmë kuptimin e tolerancës dhe të shtrojmë pyetjen se në cilat kushte sociale, kulturore dhe politike bëhet e mundur toleranca fetare në një shoqëri me besime të ndryshme fetare. Në shqyrtimin e mëposhtëm të literaturës do të përpiqemi t'u japim përgjigje këtyre pyetjeve.

Duke pasur parasysh larminë fetare të shoqërisë shqiptare, ruajtja e kohezionit social dhe e tolerancës dhe harmonisë fetare, edhe në kohë të turbullta, ka qenë një arritje e jashtëzakonshme.

## IV.1. Përkufizimi i tolerancës

Toleranca është një prirja për t'i rezistuar ose për të duruar bindjet dhe praktiket e njerëzve të tjerë me të cilët dikush mund të mos bie dakord, sepse ai ose ajo i konsideron këto bindje apo praktika si të rreme ose të gabuara. Siç e thotë edhe një autor, "toleranca përfshin një qëndrim që është ndërmjetës mes pranimit me gjithë zemër dhe kundërshtimit të shfrenuar" (Scanlon, 1996: 226). Që një individ të jetë tolerant, para së gjithash ai ose ajo duhet të ketë një ide se për çfarë bëhet fjalë në mënyrë që të mos pajtohet me qëndrimet e të tjerëve për të njëjtën çështje, me qëllim që të tregojë një qëndrim tolerant ndaj tyre. Një individ fetar e di se rruga e vërtetë drejt shpëtimit i përket fesë ose kultit të tij dhe ata që besojnë në fetë dhe kultet e tjera gabohen dhe janë mashtruar, por që gjithsesi zgjedh të tolerojë besimet e njerëzve të tjerë. Pra, toleranca nuk është sinonim me mungesën e paragjyqimeve. Shpesh supozohet se një person pa paragjyqime është tolerant, ndërsa ata që paragjykojnë janë jotolerantë. Por kjo nuk është e thënë të jetë gjithmonë e vërtetë, sepse një person i paragjykuar mund të jetë tolerant kur ai ose ajo ka vullnetin të lejojë shprehjen e atyre gjërave ndaj të cilave ai ose ajo paragjykohet (Eisenstein, 2008: 18-19). Toleranca nuk mund të barazohet as me indiferencën. Të jesh tolerant ndaj pikëpamjeve apo veprimeve të një tjetri është të kujdesesh për ta dhe për pasojat e tyre. Një person që është indiferent ndaj fesë në përgjithësi nuk është shembull i mirë i një njeriu tolerant: njerëzit tolerantë janë ata besimtarë dhe ateistë që nuk bien dakord me natyrën e Zotit dhe fesë por që, gjithsesi, pranojnë shfaqjen publike në forma të ndryshme të besimit fetar në shoqërinë e tyre.

Pse toleranca? Toleranca nuk është dorëheqje dhe mosndërhyrje përballë një situatë që njeriu nuk mund të bëjë asgjë. Përkundrazi, "tolerimi është diçka që duhet ta bëjmë për arsyet e duhura ... dikush toleron atë që ai/ajo (beson se) duhet" (Cohen, 2004: 72-73). Me fjalë të tjera, nuk duhet të ndërhyjmë në besimet, botëkuptimet apo veprimet e të tjerëve për shkak të një parimi.

Toleranca presupozohet të jetë virtyt publik apo qëndrim moral në shoqëritë me larmi kulturash dhe kompleksesh, sepse do të thotë të pranosh se përkatësia e përbashkët në shoqëri është më e vlefshme se mosmarrëveshjet dhe konfliktet që mund të lindin për natyrën dhe drejtimin e shoqërisë. Toleranca është pranimi i faktit se anëtarët e tjerë, pavarësisht ndryshimeve, kanë të drejtë të kontribuojnë në përcaktimin e shoqërisë sonë. Toleranca ndaj pikëpamjeve dhe opinionëve të njerëzve, përfshirë këtu edhe identifikimet fetare, është punë e vështirë dhe me rrezik, sepse përfshin mundësinë që botëkuptimet dhe opinionet me të cilat mund të mos jesh dakord të qarkullojnë lirshëm në shoqëri dhe madje të dominojnë në të, por gjithsesi ia vlen të rrezikosh për tolerancën për aq kohë sa ajo prodhon më shumë vlerë sesa një shoqëri alternative e antagonizmave dhe grindjeve ku rrezikohen liritë e individëve dhe komuniteteve. Përhapja e tolerancës në një shtet demokratik kërkon që minoriteteve ose atyre që mbajnë anën e “gabuar” të dallimit nuk duhet t’u mohohen të drejtat ligjore dhe politike, të vazhdojnë të përfitojnë nga të mirat publike që u ofrohen të gjithë anëtarëve të shoqërisë dhe kërkon që shteti nuk i jep përparësi një grupi të caktuar ndaj një grupi tjetër në shpërndarjen e përfitimeve (Scanlon, 1996: 231). Toleranca fetare përbën pikënisjen për dialogun ndërfaqet dhe kjo e fundit forcon kulturën e tolerancës në shoqëri.

Në Perëndim virtyti i tolerancës lidhet me liberalizmin dhe toleranca fetare ishte një nga rrënjët historike të liberalizmit. Ndërkohë, liberalët e kanë zgjeruar parimin e tolerancës fetare drejt çështjeve të tjera të debatueshme mbi kuptimin dhe qëllimin e jetës njerëzore. Në këtë mënyrë, tradita perëndimore e tolerancës fetare në qendër të saj ka idenë e lirisë individuale të ndërgjegjes. Imponimi i fesë së dikujt tek të tjerët apo kufizimi i të drejtave të individit për të zgjedhur se kë të adhurojë shihen si shkelje e të drejtave themelore të njeriut. Gjithsesi, ka pasur tradita të tjera të tolerancës fetare që bazohen në idenë se çdo bashkësi fetare duhet të jetë autonome në çështjet e doktrinës dhe organizimit të brendshëm të saj. Një shembull është “sistemi i milletit” i Perandorisë Osmane, sipas të cilit myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë njiheshin si njësi vetëqeverisëse, duke formuar një “federatë teokracish”. Në këtë model, komuniteteve të besimtarëve u sigurohej tolerancë, por besimtarët si individë nuk gëzonin të drejta jashtë bashkësisë së tyre. Çdo komunitet fetar, ndërkohë që toleron komunitetet e tjera që banojnë në të njëjtën hapësirë gjeografike dhe sociale, mund të kufizojë lirinë e ndërgjegjes tek anëtarët e vet (Kymlicka, 1995: 155-158). Prandaj, duhet të theksojmë se, pavarësisht nga rrënjët historike të tolerancës fetare tek shqiptarët, ky zakon i çmuar i zemrës është ndërthurur tashmë me kuptimin liberal dhe individualist të tolerancës fetare që është zhvilluar edhe në Perëndim. Teksa shqiptarët po integrohen në kulturën demokratike dhe normat e Perëndimit, tradita e tyre e tolerancës fetare duhet të bëhet një kulturë e tolerancës e përqendruar në zgjedhjet që bëjnë qytetarët si individë në sfera të tjera të jetës dhe jo vetëm në çështjet fetare.

Në mënyrë ideale, në një shoqëri demokratike toleranca duhet të motivohet jo vetëm nga solidariteti etnik, por edhe nga respektimi i të drejtave të njeriut dhe shteti ligjor, prandaj në këtë studim preferojmë termin “tolerancë fetare” ndaj asaj të “harmonisë fetare”. Kjo e fundit mund të lidhet më shumë me fetë dhe filozofitë historike të jetës në Azinë Lindore (variancionet e budizmit, konfucianizmit, taoizmit etj.). Në qendër të harmonisë fetare qëndron parimi i kolektivizmit, në krahasim me individualizmin që evidentohet në Perëndim (Clobert et al., 2014,

Situata në përgjithësi e tolerancës fetare në Shqipëri ka mbetur e qëndrueshme, sepse drejtuesit fetarë u kanë bërë thirrje besimtarëve të tyre të qëndrojnë larg konflikteve dhe kanë bërë apel për mirëkuptim dhe dialog të ndërsjellë.

Tan, 2008). Harmonia fetare lidhet edhe me regjimet autoritare dhe gjysmë autoritare në Azinë Lindore dhe me marrëveshjet komunitare midis shtetit dhe bashkësive fetare, ndërkohë që tendenca kryesore politike e vendeve post-komuniste të Ballkanit ka qenë drejt liberalizimit dhe mbrojtjes ligjore të të drejtave të njeriut.

Në demokracitë bashkëkohore mund të dallojmë tolerancën sociale dhe politike. Toleranca politike është kur qytetarët mbrojnë të drejtat e grupeve të bashkëqytetarëve të tjerë për të marrë pjesë plotësisht në jetën politike shoqërore dhe ekonomike, edhe në rastet kur nuk bien dakord për botëkuptimet apo qëllimet që kanë. Një mjet i përbashkët për matjen e tolerancës politike është përdorimi i pyetjeve të, p.sh., nëse grupi më i papëlqyeshëm duhet të lejohet të organizojë demonstrata publike. Toleranca sociale i referohet pranimi si të barabartë i grupeve të ndryshme kulturore. Një mënyrë e zakonshme për të matur këtë është nëpërmjet “pyetjes së fqinjëve”: njerëzit pyeten nëse do të kundërshtojnë që të kenë si fqinj njerëz me përkatësi të ndryshme racore, fetare, etnike, apo orientimi seksual etj. (Widmalm & Oskarsson, 2008: 14-17 ). Kur përshtatet me sferën dhe identitetet fetare, toleranca politike del në pah kur qytetarët pranojnë se të gjithë anëtarët e një komuniteti politik, pavarësisht besimit që ata deklarojnë në publik, gëzojnë të njëjtat të drejta politike dhe se feja nuk duhet të lidhet me rekrutimin në administratën publike. Mund të argumentohet se për tolerancën politike dhe fetare janë parakushte shteti laik dhe një ligj publik laik. Edhe pse kultura tolerante politike ndikon në tolerancën fetare në shoqëri, nga ana tjetër është e qartë se toleranca politike është më e fortë kur mbështetet nga toleranca dhe pranimi i larmisë fetare në mjedise të ndryshme shoqërore, qofshin ato vendore apo kombëtare.

Duhet të kemi parasysh se, për fat të keq, vetëm toleranca nuk është garanci ndaj “konkurrencës” mes institucioneve dhe komuniteteve fetare që kanë të njëjtën vendndodhje. Robert Hayden së bashku me disa bashkëpunëtorë kanë shpikur termin tolerancën antagonistike për të përshkruar

komunitetet fetare që janë tolerante dhe jetojnë në paqe për breza me radhë, por që gjithsesi e përcaktojnë veten si komunitete të ndara me interesa konkurruese. Është e dukshme se në këto situata toleranca fetare është më pranë rezistencës ndaj feve të tjera. Kur kriset status quo-ja afatgjate shoqërore dhe politike, apo kur faktorë të jashtëm ndërhyjnë për të krijuar një koniunkturë që interpretohet si me përfitim për një nga bashkësitë fetare, atëherë konkurrenca e hapur, apo edhe dhuna, mund t'i japin fund tolerancës. Ndonëse nuk lidhet në mënyrë të natyrshme me dhunën, feja mund të jetë kufiri që përcakton një grup ndaj grupeve të tjera.

Një rast i tolerancës antagoniste është ajo e Bosnjës në shekullin e kaluar. Për shekuj me radhë, fetë e ndryshme në këtë vend kishin një hapësirë të përbashkët fizike dhe sociale. Megjithatë, komunitetet fetare u bënë antagoniste në një kohë kur shenjuesit e fesë - ritet, veshjet, vendet e adhurimit - gradualisht u bënë shenjues të përkatësisë etnike dhe kombësisë. Si rrjedhojë, në kohë konflikti etnik, palët ndërluftuese e konsiderojnë të ligjshme të sulmojnë vendet dhe simbolet fetare të kundërshtarit (Hayden et al., 2016). A mund të përdorim termin 'tolerancë antagoniste' për të përshkruar marrëdhëniet mes bashkësive fetare në Shqipëri? Ka pasur raste të fërkimeve ndërfitare në Shqipërinë postkomuniste, përfshirë këtu, për shembull, debatin për vendosjen e kryqeve të mëdhenj në majë të maleve dhe kodrave në disa zona të vendit, ose për çështjen e restaurimit të kishës-xhami në Kalanë e Rozafës në Shkodër. Në shembuj të tillë ka pasur konkurrencë mes besimtarëve duke pretenduar ekskluzivitet mbi një territor apo ndërtesë të caktuar që tradicionalisht është ndarë me pjesëtarë të bashkësive të tjera fetare. Pavarësisht këtyre fërkimeve në nivel vendor, situata më përgjithësi e tolerancës fetare në vend ka mbetur e qëndrueshme, sepse udhëheqësit fetarë u kanë bërë thirrje besimtarëve të qëndrojnë larg konfliktetve dhe kanë bërë apel për mirëkuptim dhe dialog të ndërsjellë.

## IV.2. Faktorët që mbështesin tolerancën fetare

Faktori më i rëndësishëm që mbështet tolerancën fetare në Shqipëri argumentohet se është kultura e përbashkët që bashkon myslimanët, të krishterët dhe jobesimtarët. Përderisa fetë tradicionale konsiderohen si pjesë e kulturës së përbashkët, ato nuk shihen si pengesa të pakapërcyeshme për mirëkuptim të ndërsjellë dhe bashkëpunim mes dasive fetare. Sfidat që i vihen tolerancës fetare nga tendencat fundamentaliste në fe është pikërisht ndarja mes fesë dhe kulturës. Sipas Olivier Roy (2010), brenda feve të mëdha botërore ka lëvizje të reja që synojnë ta shkëpusin fenë nga rrënjët kulturore dhe ta formatojnë atë si "fe të pastër" dhe pastaj të konvertojnë njerëzit, si në kulturën e tyre origjinale apo edhe në kulturat e huaja. Fundamentalizmi është një formë e dekulturizuar (çrrënjësje e kulturës) dhe e deterritorializuar (mospërkatësi me territorin) e fesë që i përshtatet globalizimit. Për fundamentalistët, bashkësia e vetme e denjë është ajo e besimit; si jo-besimtarët ashtu edhe besimtarët "tradicionale" konsiderohen të barabartë me paganët, të cilët kanë nevojë të konvertohen. Trajtimi i barabartë (accomodationism) është mishërimi i fesë në një kulturë që është e përbashkët si për besimtarët ashtu edhe për jo-besimtarët. Siç argumenton Roi:



Shtypja brutale e fesë në shoqëri, gjatë periudhës ateiste nga 1967 deri në fund të viteve 1980, nënkuptonte që shumica e brezit të ri që u rrit në atë kohë të mos kishte kontakt me fenë publikisht dhe as të krijonte lidhje të fortë me simbolet dhe ritet fetare.

Dekulturimi (çkulturimi) i fesë ... e shndërron hendekun mes besimtarit dhe jo-besimtarit në pengesë, duke qenë se tani ata nuk kanë të përbashkët asnjë praktikë fetare apo vlerë. Pra, të gjitha hapësirat ndërmjetëse të besimtarëve që nuk praktikojnë, ndjekësve nominalë, dhe jo-besimtarëve me kulturë fetarë po zhduken. Në sytë e besimtarëve, indiferentët, të ftohtët ose ata që nuk kanë lindur ende i përkasin gjithsesi botës laike - madje edhe pagane. Në anën tjetër, për jo-besimtarin, besimtari shfaqet si i papërshtatshëm, madje edhe fanatik. Dekulturimi është humbja e shprehjes shoqërore të fesë (po aty: 8).

Është e qartë se versionet e trajtimit të barabartë të fesë janë në përputhje me tolerancën fetare, ndërkohë që besimtarët fundamentalistë e kanë shumë më të vështirë të gjejnë pika të përbashkëta me persona të tjerë fetarë dhe laikë. Sidoqoftë, gjeneratat e mëvonshme të fundamentalistëve dhe të përkrahësve të rilindur gjejnë një strehë të re tek kultura mbizotëruese që i rrethon. Në një studim për debatin islamik në Shqipërinë bashkëkohore, Cecile Endresen (2015) evidentoi se Komuniteti Mysliman Shqiptar (KMSH), organizata kryesore islamike në vend, paraqet versionin e trajtimit të barabartë të besimit. KMSH e përshkruan veten si nxitës të një islami vendor, të moderuar, modern dhe evropian që kombinon kodin më të lartë moral me vlerat patriotike. Ai vlerëson shumë tolerancën dhe larminë fetare në vend. Nga ana tjetër, sipas Endresen, një organizatë tjetër - Lidhja e Hoxhallarëve - ka për qëllim rivendosjen e vlerave islame tek individë nëpërmjet respektimit të rreptë të riteve dhe sjelljes së bazuar në besim. Edhe pse e pranojnë larminë fetare të Shqipërisë, predikuesit e kësaj lidhjeje i kushtojnë më pak vëmendje feve të tjera dhe merren më tepër me praktikën "e pasakta" të degëve dhe sekteve të tjera islame që kanë devijuar nga islami "i vërtetë". Por ka tregues, sipas autorit, se Lidhja e Hoxhallarëve po mban një qëndrim më të lirshëm ndaj dallimeve fetare dhe po i përshtatet kulturës mbizotëruese shqiptare.

Një tjetër faktor që kontribuon në tolerancën fetare është laicizmi. Në shtetet moderne laicizëm do të thotë që ligjet, qeverisja, shkenca, arsimit, etika, etj., janë të shkëputura nga feja. Kjo e fundit mbetet e rëndësishme si burim i vetë-identitetit dhe moralit, por bëhet më pak i rëndësishëm në sferën publike, duke qenë se për njerëzit ka gjithnjë e më shumë zgjedhje jo-fetare. Në një shoqëri laike ka një larmi pozicionesh që gjenden mes ateistëve dhe besimtarëve, për shembull, mund të jesh besimtar në Zot pa u identifikuar me asnjë fe, ndërsa dikush tjetër mund të ketë lidhje e afritet kulturor me një fe të caktuar pa qenë e thënë të respektojë ritet e kësaj feje. Individualizimi dhe privatizimi i përvojës fetare do të thotë se feja nuk është një vektor i rëndësishëm në punët publike dhe në marrëdhëniet shoqërore; ajo bëhet e "padukshme" dhe shumë njerëz janë thjesht indiferentë ndaj fesë në jetën e përditshme. Të dhënat e sondazhit tregojnë se qytetarët e sotëm të Shqipërisë ndjekin një drejtim dhe zgjedhin sjelljen sesa fenë: vetëm 5 për qind ndjekin shërbime fetare çdo javë, 50 për qind ndjekin ceremonitë fetare vetëm në momentet kyçe të jetës, si lindje, martesë ose mort, ndërkohë që shumica mbështet rregullimet laike që e kufizojnë fenë brenda sferës private (Universiteti i Oslos, 2013). Kjo gjë konfirmohet në fakt nga ky studim, i cili nxjerr në pah një shifër më të madhe (14%) për ata që ndjekin rregullisht ritet fetare, por që mbeten pakicë krahasuar me të tjerët që nuk marrin pjesë. Ndonëse qëndrimi më i lirshëm ndaj fesë, apo edhe indiferencë ndaj saj, nuk është e barabartë me tolerancën, ai e lehtëson atë, sepse besimtarët kujtohen për shumë mënyra të besimit ose mosbesimit fetar dhe mësojnë të respektojnë zgjedhjet e të tjerëve.

Mes laicizmit politik dhe atij social mund të nxirret një dallim. I pari i referohet institucioneve publike dhe fushës politike në përgjithësi, ndërsa i dyti ka të bëjë me çështje që lidhen me vlerat dhe qëndrimet. Laicizmi politik është zyrtar, ndërsa ai shoqëror është jozyrtar dhe pjesë e jetës së përditshme (Turner, 2010: 651-653). Përvoja e laicizmit politik në Evropën Perëndimore nuk është ajo e një muri ndarës mes kishës dhe shtetit, por në rindërtimin e vazhdueshëm të një tolerance të dyanshme. Pjesa më e madhe e shteteve demokratike kanë negociuar lirinë e fesë nga ndërhyrja e shtetit, duke u lejuar bashkësitë fetare jo thjesht lirinë e adhurimit, por edhe lirinë për t'u organizuar në shoqëri civile dhe shoqëri politike (Stepan, 2000). Laicizmi ka qenë komponent i rëndësishëm i kulturës politike në Shqipëri që nga themelimi i shtetit në vitin 1912, por atij iu ushtrua një ndikim i fortë nga periudha ateiste që vazhdoi nga viti 1967 deri në fund të viteve 1980. Shtypja brutale e fesë në shoqëri nënkuptonte që shumica e brezit të ri që u rrit në atë kohë të mos kishte kontakt me fenë publikisht dhe as të krijonte lidhje të fortë me simbolet dhe ritet fetare. Edhe pse disa mund të ankohen për këtë padije fetare, ajo krijoi një themel të fortë për laicizmin në sferën publike dhe në politikë që nga rivendosja e lirisë së fesë në Shqipëri. Mjafton të shohim shpeshësinë e martesave dhe krushqive ndërfitare për të vlerësuar depërtimin e thellë të laicizmit në jetën shoqërore të shqiptarëve të ditëve të sotme. Dallimi mes komponentëve politikë dhe socialë të laicizmit do të thotë që dukshmëria më e madhe publike e fesë në sferën publike nuk do të thotë domosdoshmërisht një besim më i madh në sferën sociale. Madje mund të jetë edhe antietike, siç në shembullin e Shkodrës, ku nga mirëkuptimi i përbashkët i qytetarëve në të gjithë grupet fetare si njerëz "të qetë" kontribuohet në tolerancën dhe zbutjen kundër konkurrencës në paraqitjen në publik të institucioneve fetare (Tosiç, 2015).

Nacionalizmi shqiptar është një tjetër faktor politik dhe moral që ka kontribuar në tolerancën fetare. Që nga fillimi i tij në gjysmën e dytë të shekullit XIX, debati për nacionalizmin shqiptar i ka vënë theksin përkatësisë etnike dhe gjuhës si themele të kombit dhe unitetit shqiptar. Ai është përpjekur ta vendosë kombin në qendër të një feje civile, nën të cilën do të bashkohen edhe besimtarët myslimanë dhe ata të krishterë. Kjo mund të vërehet në një nga motot e famshme të Rilindjes kombëtare: “Feja e shqiptarit është shqiptaria” nga Vaso Pasha (Sulstarova, 2017). Identiteti kombëtar dhe nacionalizmi kanë qenë mbështetja ideologjike e laicizmit të shtetit shqiptar që nga viti 1912. Sot, feja civile e nacionalizmit është bërë pjesë e imagjinatës kolektive të shqiptarëve. Në një studim interesant të kryer me disa klerikë nga secili prej besimeve tradicionale në vend doli në pah se ata në thelb kishin të njëjtat mendime rreth kombit dhe mendonin se toleranca fetare ishte e vlefshme si nga pikëpamja kombëtare ashtu edhe ajo fetare. Të gjithë shprehën mendimin se toleranca fetare ishte një shenjë kombëtare e shqiptarëve, “ata e kanë në gjak atë”. Për ta, shqiptari ideal ishte në të njëjtën kohë atdhetar, besimtar dhe mbrojtës i tolerancës fetare. Ata ishin dakord me larminë fetare në vend dhe gjykonin se kërcënimet ndaj harmonisë fetare në Shqipëri shkakttoheshin nga faktorë të jashtëm jo-shqiptarë. Për secilën bashkësi fetare problemi nuk qëndronte tek komunitetet e tjera, sepse i besonin këto komunitete si shqiptarë, por tek lidhjet e komuniteteve të tjera me rrjetet e huaja fetare, sepse nga këto lidhje mund t’u hapej rruga ndikimeve të dëmshme që vinin nga jashtë (Endresen, 2010). Në Shqipëri është i përhapur perceptimi se identiteti kombëtar ka ndikim pozitiv tek toleranca fetare dhe kjo u confirmua edhe në këtë sondazh, ku mbi 83 për qind e kampionit përfaqësues ishin dakord me thënien se “ndjenjat kombëtare ushqejnë tolerancën fetare”.

# V. SONDAZHI PUBLIK

## V.1. Përshkrimi i kampionit


Gjatë gjysmës së dytë të muajit korrik 2017 u realizua një sondazh i opinionit publik ku u përfshi një kampion përfaqësues kombëtar prej 1,100 të anketuar. Siç u shpjegua në metodologji, kampioni u shpërnda në 40 bashki, duke përjashtuar 21 për shkak të faktit se kampioni i tyre përfaqësues kishte më pak se dhjetë të anketuar secili. Tre bashki ku kampioni përfaqësues ishte më i vogël se dhjetë të anketuar u lanë qëllimisht jashtë këtij rregulli. Këto bashki ishin: Finiqi, Konispoli dhe Skrapari, me qëllim përfitim të pikëpamjeve të bashkive të dominuara nga minoriteti grek (Finiqi dhe Konispoli) ose komuniteti fetar bektashian (Skrapari).<sup>10</sup>



10. Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011



Shumica e të intervistuarve, 58.5 për qind, vinin nga zonat urbane dhe 41.5 për qind nga zonat rurale (Figura 1), me një raport pak më të lartë se ai i Censurit të vitit 2011 (53.5%: 46.5% përkatësisht).<sup>11</sup> Në kampionin e sondazhit kemi një përfaqësim pothuajse të barabartë gjinor (49.5% meshkuj: 50.5% gra, Figura 2) në intervista.

**FIGURA 1. PËRBËRJA URBAN-RURAL (%)**





11. Diferenca pasqyron valët e migrimit të brendshëm dhe të jashtëm në 6-7 vitet e fundit që nga Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011. Për më shumë informacion shih metodën e kampionimit në seksionin e Metodologjisë.

FIGURA 2. PËRFAQËSIMI GJINOR (%)




Mosha mesatare e të anketuarve ishte 39.7 vjeç dhe përfaqësimi i grupmohave ishte 21.4 për qind, 18-25 vjeç; 26.8 për qind, 26-35 vjeç; 16.8 për qind, 36-45 vjeç; 15.9 për qind, 46-55 vjeç; 11.4 për qind, 56-65 vjeç; dhe 7.7 për qind, më shumë se 65 vjeç (Figura 3).

FIGURA 3. PËRFAQËSIMI SIPAS GRUPMOSHËS (%)




Duke pasur parasysh dominimin e një popullsie urbane dhe relativisht të re (deri në 45 vjeç), kampioni i këtij studimi shfaqte një nivel arsimor relativisht të lartë (Figura 4): 38.6 për qind kishin përfunduar arsimin e mesëm, ndërsa 34.4 për qind kishin përfunduar studimet universitare dhe 7.9 për qind, studime pasuniversitare. Niveli më i lartë arsimor i përfunduar nga më pak se një e pestën e të anketuarve ishte arsimi fillor (17.8%) dhe pa arsim fare (1.3%).

**FIGURA 4. NIVELI ARSIMOR (%)**



Më shumë se gjysma e të anketuarve deklaruan se ishin të punësuar, me 36 për qind të papunë (Figura 5). Shumica (28.3%) e të anketuarve ishin të punësuar në sektorin privat, 13.1 për qind në sektorin publik dhe 11.5 për qind ishin të vetëpunësuar. Pothuajse një e katërta (24.3%) nuk ishin të punësuar në këtë moment dhe 11.7 për qind deklaruan se kurrë nuk kishin qenë të punësuar. Të intervistuarit e tjerë deklaruan se ishin studentë (2.4%) ose në pension (8.8%).


**FIGURA 5. GJENDJA E PUNËSIMIT (%)**






Natyrisht që statusi i punësimit do të reflektohej tek të ardhurat mujore të të anketuarve, me 31.4 për qind që deklarorin se nuk kishin të ardhura mujore personale dhe 17 për qind deri në 20,000 lekë (rreth 175 dollarë) në muaj. Rreth 4.8 për qind kishin të ardhura mujore nga 60,000-100,000 lekë (525-870 USD), ndërsa më pak se 2 për qind kishin të ardhura mbi 100,000 lekë (Figura 6), me 26,5 për qind që marrin nga 20,001-40,000 lekë dhe 18,4 për qind nga 40,001 -60,000 Lekë.

**FIGURA 6. TË ARDHURAT PERSONALE (ALL; %)**



Nga të anketuarit, 87 për qind deklarorin se i përkisnin të njëjtës fe si familja e tyre. Përbërja fetare e kampionit të studimit tregohet në Figurën 7. Më shumë se 50 për qind ishin myslimanë, më pak se katërbëdhjetë për qind ishin katolikë, trembëdhjetë për qind ishin ortodoksë, me pak më shumë se një e pesta e grupeve të tjera (bektashi, protestantë, të tjera).


**FIGURA 7. PËRKATËSIA FETARE (%)**



Më pak se 10 për qind e kampionit të studimit refuzuan të përgjigjeshin pyetjes nëse ata e konsideronin veten si besimtarë praktikantë të fesë. Nga ata që u përgjigjën, 62.7 për qind deklaruan se nuk ishin besimtarë praktikantë, ndërsa 37.3 për qind deklarojnë se praktikonin fenë (Figura 8).

Përqindja e të anketuarve që deklaruan se ishin besimtarë praktikantë të fesë duket relativisht e lartë kur krahasohet me gjetjet për nivelin e njohurive mbi fenë ose me shpeshhtësinë me të cilën praktikonin ritet fetare (shih më poshtë), të cilat nuk pasqyrojnë sjelljet e një person tipik besimtar që praktikon besimin e tij. Demografia e këtij grupi të intervistuarish është interesante. Shumica ishin gra (53.1%), vinin nga zonat urbane (60.4%) dhe ishin të moshës deri në 45 vjeç (57%), me dy variablat e fundit të ngjashëm me demografinë e përgjithshme të kampionit.

FIGURA 8. USHTRIMI I FESË (%)



Në tabelat e mëposhtme raportohet niveli i arsimit (Tabela 3), gjendja e punësimit (Tabela 4) dhe të ardhurat mujore (Tabela 5) e 37.3% e të intervistuarve që deklaruan se ishin besimtarë praktikantë të rregullt të fesë.

**TABELA 3 NIVELI ARSIMOR I TË INTERVISTUARVE BESIMTARË PRAKTIKANTË TË RREGULLT TË FESË**

Niveli më i lartë arsimor i përfunduar	%
Pa arsim	1.3
Arsim 8/9 vjeçar	21.6
Arsim i mesëm	43.4
Arsim i lartë	25.9
Arsim pasuniversitar	7.8
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0</b>


**TABELA 4 STATUSI I PUNËSIMIT I TË INTERVISTUARVE BESIMTARË PRAKTIKANTË TË RREGULLT TË FESË**

Statusi i punësimit	%
Jo, nuk kam qenë ndonjëherë	13.2
Jo për momentin	22.4
Po, i/e punësuar në sektorin privat	25.3
Po, i/e punësuar në sektorin publik	12.1
Po, i/e vetëpunësuar	14.3
Student	0.5
Pensionist	12.1
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0</b>

**TABELA 5 TË ARDHURAT MUJORE TË TË INTERVISTUARVE BESIMTARË PRAKTIKANTË TË RREGULLT TË FESË**


Të ardhurat (neto) personale (Lekë)	%
Pa të ardhura personale	29.1
Deri në 20,000	22.6
20,001–40,000	26.3
40,001–60,000	16.6
60,001–100,000	3.7
>100,000	1.7
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0</b>

Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë mbaruar arsimin e mesëm, dhe një pjesë rreth ¼ kanë diplomë universitare. Megjithatë, 78 për qind e të anketuarve ose nuk kanë të ardhura personale mujore ose këto të ardhura nuk e kalojnë shifrën e 40,000 lekë në muaj.



Në sondazh u analizuan edhe perceptimet e të anketuarve për mjedisin e tyre të jashtëm më të afërt dhe si mendojnë ata se perceptohen nga miqtë ose kolegët e tyre të punës kur bëhet fjalë për praktikimin e fesë. Në total gjitha, 82.4 për qind e kampionit të sondazhit ranë dakord të përgjigjen në pyetjen "A mendoni se identifikoheni si besimtar praktikant nga rrethi juaj shoqëror ose i punës?" Siç tregohet edhe në Figurën 9, 28 për qind e të intervistuarve besojnë se rrethi shoqëror ose i punës i identifikon ata si besimtarë praktikantë.

**FIGURA 9 IDENTIFIKIMI SI BESIMTARË PRAKTIKANTË NGA RRETHI SHOQËROR DHE I PUNËS (%)**



Nga ata të intervistuar që e konsideronin veten si besimtarë që praktikojnë fenë në mënyrë aktive (37.3% e kampionit), rreth 80 për qind besonin se mjedisi i tyre i afërt i identifikon ata si praktikues fetar, ndërkohë që 20 për qind nuk besonin kështu. Ndërkohë, një tjetër 1.2 për qind e të anketuarve që nuk e praktikojnë fenë në mënyrë aktive besonin se rrethi shoqëror ose i punës i konsideronte si besimtarë praktikantë (Tabela 6).

**TABELA 6 KRAHASIM PËRGJIGJESH: A E KONSIDERONI VETEN NJË BESIMTAR PRAKTIKANT TË FESË SUAJ? ME "A MENDONI SE IDENTIFIKOHENI SI BESIMTAR PRAKTIKANT NGA RRETHI JUAJ SHOQËROR OSE I PUNËS?"**

			A mendoni se identifikoheni si besimtar praktikant nga rrethi juaj shoqëror ose i punës?		Gjithsej
			Po	Jo	
A e konsideroni veten një besimtar praktikant të fesë suaj?	Po	Numër	242	61	303
		%	79.9	20.1	100.0
	Jo	Numër	7	557	564
		%	1.2	98.8	100.0
Gjithsej	Numër	249	618	867	
	%	28.7	71.3	100.0	

Një nga gjetjet nga shqyrtimi i literaturës dhe procesi i hartimit të instrumentit të studimit ishte se shqiptarët kanë një nivel përgjithësisht të ulët informacioni ose njohurish për fetë e ndryshme. Për të vërtetuar këtë gjetje, në sondazh u analizua niveli i njohurive të të intervistuarve nëpërmjet deklaratave të tyre mbi pesë komunitetet kryesore fetare në Shqipëri: mysliman, ortodoks, katolik, bektashian dhe protestant. Në Tabelën 7 raportohen rezultatet e sondazhit për këtë pyetje.

Me përjashtim të komunitetit mysliman, më shumë se gjysma e pjesëmarrësve në sondazh deklaruan se kanë pak ose aspak njohuri për fenë e komunitetit ortodoks (54%), atij katolik (55%), bektashi (60%) dhe protestant (78%), ndërsa më shumë se një e treta (36.4%) deklaruan se kanë njohuri të moderuara ose të shumta për fenë islame. Duke pasur parasysh mbizotërimin e bashkësisë myslimane në Shqipëri këto gjetje janë të kuptueshme.

**TABELA 7 PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE TË NDRYSHME PËR PYETJEN "SA NJOHURI MENDONI SE KENI RRETH FESË SË KOMUNITETEVE FETARE SI MË POSHTË?"**

	Aspak njohuri	Pak	Deri diku	Të mjaftueshme	Njohuri shumë të mira	Gjithsej
Myslimane	8.8	26.5	28.3	25.7	10.7	100
Ortodokse	21.3	32.7	23.7	17.5	4.9	100
Katolike	20.7	35.5	23.0	15.9	4.9	100
Bektashi	31.3	28.9	23.5	12.9	3.4	100
Protestante	49.0	28.2	15.5	5.5	1.7	100

## V.2. Gjetjet e sondazhit

Instrumenti i sondazhit (Shtojca IX.1) u nda në tre pjesë kryesore, si më poshtë:

- A. Individit dhe hyjnorja/e shenjta
- B. Perceptime mbi tolerancën fetare në Shqipëri
- C. Qëndrimet dhe eksperiencat lidhur me tolerancën fetare


Siç u shpjegua edhe në pjesën e Metodologjisë, pyetësi u hartua për të vërtetuar dhe shqyrtuar supozime të ndryshme të identifikuar si kryesore për të kuptuar bashkëjetesën fetare në Shqipëri. Në pjesën e mëposhtme të këtij raporti analizohen gjetjet për secilën nga tre pjesët kryesore të instrumentit të sondazhit.

### V.2.1. INDIVIDIT DHE E SHENJTA

Kjo pjesë e pyetësit kishte për qëllim të shqyrtonte nivelin e besimit të të intervistuarve, qëndrimet e tyre ndaj vlerave fetare dhe morale dhe nëse ato ndikonin në jetën e tyre, dhe nëse po në ç'mënyrë. Përveç identifikimit të demografisë së komuniteteve, ky informacion na ndihmon të kuptojmë më mirë perceptimet, qëndrimet dhe përvojat e pjesëmarrësve në sondazh në lidhje me tolerancën fetare, të shtjelluara në seksionet e mëvonshme.

Në këtë sondazh të intervistuarit u pyetën sa ishin dakord ose jo me një sërë deklaratash për të kuptuar nëse feja ndikon në jetën e tyre dhe sa.

FIGURA 10. SA DAKORD JANË ME DEKLARATAT PËR NDIKIMIN E FESË NË JETËN E TYRE



Jeta e përditshme e shumicës së shqiptarëve është përgjithësisht shekullare. Figura 10 tregon se më shumë se gjysma e të anketuarve deklaruan se feja nuk ndikon plotësisht ose nuk formëson mënyrën e jetesës: vetëm 26.3 për qind deklaruan se feja përfshin të gjitha aspektet e jetës së tyre, ndërsa gati 60 për qind nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord me deklaratën. Ndërkohë, 54.1 për qind e të anketuarve deklaruan se pikëpamjet fetare nuk ndikojnë në aktivitetet e tyre të përditshme. Kur vjen puna për të mos qenë i kufizuar nga feja, kjo përqindje arrin 71 për qind, ndërsa 65.6 për qind e popullatës së anketuar konstatojnë se ka shumë gjëra

të tjera më të rëndësishme në jetë. Megjithëse feja nuk ndikon në jetën e të anketuarve, shumica e tyre (pothuajse 70%) kanë deklaruar se “nuk ka shumë rëndësi se çfarë besoj, për aq kohë sa bëj një jetë të moralshme. Një grup relativisht i vogël i të anketuarve (gati 13%) ishin dakord ose ishin plotësisht dakord me deklaratën “Besimi im fetar shpesh kufizon veprimet e mia” në krahasim me 37.3 për qind të të intervistuarve që deklaruan se janë besimtarë praktikantë të rregullt (shih më sipër).

Nga pesë deklaratat, dy të parat ishin statistikiisht të rëndësishme ( $p < 0.05$ ) në dy lloje grupesh demografike: grupmosha dhe zona e vendbanimit (rural-urban). Për deklaratën e parë “Besimi im fetar përfshin çdo aspekt të jetës sime” të anketuarit më të rinj se 55 vjeç prireshin më shumë që të mos ishin dakord ose aspak dakord se të intervistuarit e moshës mbi 55 vjeç (Tabela 8).

**TABELA 8 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN “BESIMI IM FETAR PËRFSHIN ÇDO ASPEKT TË JETËS SIME”, SIPAS GRUPMOSHAVE**

			GRUPMOSHA (VJEÇ)						GJITHSEJ
			18–25	26–35	36–45	46–55	56–65	> 65	
Besimi im fetar përfshin çdo aspekt të jetës sime	Aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	142	182	109	111	58	37	639
		%	62.3	63.6	60.6	64.5	47.5	44.0	59.6
	Asnjë	numri	34	33	32	21	19	12	151
		%	14.9	11.5	17.8	12.2	15.6	14.3	14.1
	Kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	52	71	39	40	45	35	282
		%	22.8	24.8	21.7	23.3	36.9	41.7	26.3
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>228</b>	<b>286</b>	<b>180</b>	<b>172</b>	<b>122</b>	<b>84</b>	<b>1,072</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>


Ndërkohë, diferencat statistikiisht të rëndësishme u evidentuan mes anketuarve ruralë dhe urbanë në lidhje me deklaratën e dytë “Edhe pse jam besimtar, nuk lejoj që pikëpamjet fetare të ndikojnë në aktivitetet e mia të përditshme” ku të anketuarit nga zonat rurale prireshin më shumë të ishin kryesisht dakord ose plotësisht dakord me deklaratën se sa të intervistuarit nga zonat urbane (Tabela 9).

**TABELA 9 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN EDHE PSE JAM BESIMTAR, NUK LEJOJ QË PIKËPAMJET FETARE TË NDIKOJNË NË AKTIVITETET E MIA TË PËRDITSHME, BY VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Edhe pse jam besimtar, nuk lejoj që pikëpamjet fetare të ndikojnë në aktivitetet e mia të përditshme.	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	89	148	237
		%	20.4	24.0	22.5
	Neutral	numri	88	158	246
		%	20.2	25.6	23.4
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	259	311	570
		%	59.4	50.4	54.1
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>436</b>	<b>617</b>	<b>1,053</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Përqindje relativisht të mëdha të të intervistuarve liberalë ose tolerantë u konfirmuan në shumë prej grupeve të mëposhtme të deklaratave të paraqitura në Figurën 11, me përjashtim të njërës, ku të anketuarit nuk ishin dakord me deklaratën “Lutja/Falja mund të jetë e vlefshme vetëm nëse i lutesh/falesh Emrit të duhur Hyjnor”. Shumica (30%) ishin asnjans, që është edhe përqindja më e lartë e të anketuarve të cilët “as nuk ishin dakord por as nuk kundërshtonin” në krahasim deklaratat e tjera. Të anketuarit prireshin të mos pajtoheshin me mendimet që mbështesnin epërsinë e një feje të caktuar, si në thëniet e mëposhtme “Vetëm një fe është e vërtetë; fetë e tjera janë false”, ose “Disa fe janë më afër të vërtetës sesa të tjera”.

**FIGURA 11 SA DAKORD JANË ME DEKLARATAT PËR BESIMIN E TË ANKETUARVE NË FENË E TYRE**



Po ashtu, pjesëmarrësit në sondazh ishin me shumicë dakord me thëniet e mëposhtme ku pranohen apo theksohen vlerat pozitive, si më poshtë:

- Në thelb të gjitha fetë të mësojnë të njëjtat vlera të shenjta (61.2% plotësisht dakord ose kryesisht dakord)
- Shumë nga fetë kryesore kanë mësim të njëjta morale; Ju mund të jeni një person i mirë pavarësisht fesë që keni pranuar (72.5% plotësisht dakord ose kryesisht dakord).

Diferenca statistikisht të rëndësishme u vunë re edhe mes grupeve të ndryshme demografike për tre nga shtatë deklaratat që kishin të bënin me këtë çështje, me diferenca që evidentohen sipas grupmoshave dhe vendbanimit.

Në deklaratën e parë, “Lutja/Falja mund të jetë e vlefshme vetëm nëse i lutesh/falesh Emrit të duhur Hyjnor” u evidentuan dallime statistikisht të rëndësishme tek kategoritë e të anketuarve nga grupmosha të ndryshme. Siç raportohet në Tabelën 10, të anketuarit e grupmoshës 36-45 vjeç kishin një përqindje më të ulët të përgjigjeve “plotësisht dakord apo kryesisht dakord”



(27.6%) dhe përqindjen më të lartë (37.1%) të përgjigjeve asnjëse. Përveç kësaj, të intervistuarit më të mëdhenj se 46 vjeç kishin një përqindje më të lartë të përgjigjeve “plotësisht dakord apo kryesisht dakord” sesa të anketuarit më të rinj në moshë.

**TABELA 10 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN LUTJA/FALJA MUND TË JETË E VLEFSHME VETËM NËSE I LUTESH/FALESH EMRIT TË DUHUR HYJNOR, SIPAS GRUPMOSHAVE**

			Grupmosha (vjeç)						Gjithsej
			18–25	26–35	36–45	46–55	56–65	> 65	
Lutja/Falja mund të jetë e vlefshme vetëm nëse i lutesh/falesh Emrit të duhur Hyjnor	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	65	92	60	52	33	27	329
		%	29.4	33.9	35.3	31.5	27.3	32.5	31.9
	Asnjëse	numri	74	84	63	42	30	16	309
		%	33.5	31.0	37.1	25.5	24.8	19.3	30.0
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	82	95	47	71	58	40	393
		%	37.1	35.1	27.6	43.0	47.9	48.2	38.1
	<b>Gjithsej</b>	<b>numri</b>	<b>221</b>	<b>271</b>	<b>170</b>	<b>165</b>	<b>121</b>	<b>83</b>	<b>1,031</b>
		<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

Dallimet statistikisht të rëndësishme u vunë re edhe tek të intervistuarit nga zonat urbane dhe rurale në lidhje me dy deklaratat. Së pari, 76.5 për qind e të gjithë të anketuarve ishin kryesisht dakord ose plotësisht dakord me deklaratën “Shumë nga fetë kryesore kanë mësim të njëjta morale; Ju mund të jeni një person i mirë pavarësisht fesë që keni pranuar”. Përqindja e të anketuarve nga zonat urbane ishte më pak se 70 për qind, ku ky grup kishte një përqindje më të lartë të të anketuarve që nuk ishin dakord ose aspak dakord me këtë deklaratë sesa të intervistuarit nga rurale (Tabela 11).

**TABELA 11 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN SHUMË NGA FETË KRYESORE KANË MËSIM TË NJËJTA MORALE; JU MUND TË JENI NJË PERSON I MIRË PAVARËSISHT FESË QË KENI PRANUAR, SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Shumë nga fetë kryesore kanë mësim të njëjta morale;	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	35	77	112
		%	8.0	12.4	10.6
	Asnjëse	numri	68	111	179
		%	15.5	17.8	16.9
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	335	434	769
		%	76.5	69.8	72.5
<b>Gjithsej</b>	<b>numri</b>	<b>438</b>	<b>622</b>	<b>1,060</b>	
	<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	

Së dyti, deklarata “Nëse je i sjellshëm dhe i dashur, do jesh pranë shpëtimit, pavarësisht fesë që beson/praktikon” nxirrte në pah përsëri diferencat mes të intervistuarve nga zonat rurale dhe urbane. Edhe pse shumica e të anketuarve nga të dyja zonat ishin dakord ose plotësisht dakord me deklaratën, ata nga zonat rurale e bënë këtë në një përqindje më të lartë sesa të anketuarit që vinin nga zonat urbane. Përveç kësaj, edhe dallimi mes përqindjeve “nuk jam aspak dakord ose kryesisht jo-dakord” mes dy grupeve (Tabela 12) ishte i madh.


**TABELA 12 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN NËSE JE I SJELLSHËM DHE I DASHUR, DO JESH PRANË SHPËTIMIT, PAVARËSISHT FESË QË BESON/PRAKTIKON, SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Nëse je i sjellshëm dhe i dashur, do jesh pranë shpëtimit, pavarësisht fesë që beson/ praktikon.	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	43	95	138
		%	9.9	15.5	13.2
	Asnjë	numri	69	120	189
		%	15.9	19.5	18.1
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	321	399	720
		%	74.1	65.0	68.8
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>433</b>	<b>614</b>	<b>1,047</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Në këtë sondazh u konfirmua një grup të anketuarish besimtarë liberalë duke pasur parasysh përqindjen relativisht të lartë të atyre që ishin dakord se “Të kesh besim është shumë e rëndësishme, por se çfarë besimi konkretisht, është më pak e rëndësishme” (63.7%) dhe rreth 69 për qind e atyre që besojnë se “Nëse je i sjellshëm dhe i dashur, do jesh pranë shpëtimit, pavarësisht fesë që beson/praktikon”.

Kur u pyetën në një nivel personal rreth ekskluzivitetit të besimit ose Perëndisë, një përqindje më e lartë e të anketuarve ishin kryesisht dakord ose plotësisht dakord me deklaratën se “Zoti (Besimi) im është Zoti (Besimi) i vetëm i vërtetë”, 39.2 për qind, më shumë se 18.7% e të anketuarve që ishin kryesisht dakord ose plotësisht dakord me deklaratën se “Vetëm një fe është e vërtetë; fetë e tjera janë false” (Figura 11). Megjithatë, siç tregon Figura 12, shumica e të anketuarve në përgjithësi konfirmojnë se besimi fetar nuk ka të bëjë fare me ritualet fetare, por më tepër me besimin në Zot.

**FIGURA 12 NIVELI I MIRATIMIT ME DEKLARATAT PËR BESIMIN FETAR TË TË INTERVISTUARVE**



Kishte dallime të dukshme mes grupmohave dhe vendbanimit në përgjigjet ndaj deklaratës së parë se “Zoti (Besimi) im është Zoti (Besimi) i vetëm i vërtetë”. Më shumë të anketuar të moshës mbi 45 vjeç ishin plotësisht ose kryesisht dakord me këtë deklaratë në krahasim me të anketuarit më të rinj në moshë, edhe pse kjo nuk do të thotë se të intervistuarit më të rinj prireshin të mos ishin dakord ose kryesisht jo-dakord sesa të tjerët: diferenca është se ata të grupmohës 18-45 vjeç prireshin të ishin më asnjanes (Tabela 13).

**TABELA 13 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN ZOTI (BESIMI) IM ËSHTË ZOTI (BESIMI) I VETËM I VËRTETË, SIPAS GRUPMOSHAVE**

			Grupmosha (vjeç)						Gjithsej
			18–25	26–35	36–45	46–55	56–65	> 65	
Zoti (Besimi) im është Zoti (Besimi) i vetëm i vërtetë	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	70	99	59	54	38	20	340
		%	31.8	36.9	35.1	34.2	32.8	25.0	33.7
	Asnjanes	numri	80	74	46	34	21	19	274
		%	36.4	27.6	27.4	21.5	18.1	23.8	27.1
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	70	95	63	70	57	41	396
		%	31.8	35.4	37.5	44.3	49.1	51.3	39.2
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>220</b>	<b>268</b>	<b>168</b>	<b>158</b>	<b>116</b>	<b>80</b>	<b>1,010</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Dallime vihen re edhe kur krahasohen përgjigjet mes të intervistuarve nga zonat urbane dhe ato rurale (Tabela 14), ku 46.4 për qind e atyre nga zonat rurale janë kryesisht ose plotësisht dakord me deklaratën. Në fakt, përgjigjet e të intervistuarve nga zonat urbane ndahen pothuajse në mënyrë të barabartë mes atyre që nuk janë aspak dakord ose kryesisht jo-dakord (34.8%), me ata që janë kryesisht ose plotësisht dakord (34.1%), apo me ata që janë asnjanes (31.1%).

**TABELA 14 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN ZOTI (BESIMI) IM ËSHTË ZOTI (BESIMI) I VETËM I VËRTETË, SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Zoti (Besimi) im është Zoti (Besimi) i vetëm i vërtetë	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	134	206	340
		%	32.1	34.8	33.7
	Asnjanes	numri	90	184	274
		%	21.5	31.1	27.1
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	194	202	396
		%	46.4	34.1	39.2
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>418</b>	<b>592</b>	<b>1,010</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Analiza e përgjigjeve për deklaratën e dytë “Praktikimi i fesë nuk ka të bëjë fare me ritualet fetare, por më tepër me besimin në Zot” tregon dallime të konsiderueshme tek qëndrimet e të anketuarve nga zonat rurale dhe urbane. Edhe pse përqindjet e ngjashme të të anketuarve të zonave urbane dhe rurale ishin kryesisht ose plotësisht dakord me deklaratën, dallimet janë të


dukshme në përqindjen e atyre që nuk ishin dakord ose kryesisht jo dakord apo edhe asnjëherë. Siç raportohet edhe në Tabelën 15, 15 për qind e të anketuarve nga zonat rurale nuk ishin aspak dakord ose kryesisht jo-dakord me deklaratën, krahasuar me përqindjen (10.8) e të anketuarve urbanë. Ndërkohë, pothuajse një e katërta e të anketuarve urbanë ishin asnjëherë, ndërsa përqindja mes të anketuarve nga zonat rurale ishte 17.7 për qind.

**TABELA 15 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN PRAKTIKIMI I FESË NUK KA TË BËJË FARE ME RITUALET FETARE, POR MË TEPËR ME BESIMIN NË Zot, SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Praktikimi i fesë nuk ka të bëjë fare me ritualet fetare, por më tepër me besimin në Zot	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	66	67	133
		%	15.0	10.8	12.6
	Neutral	numri	78	150	228
		%	17.7	24.2	21.5
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	296	402	698
		%	67.3	64.9	65.9
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>440</b>	<b>619</b>	<b>1,059</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Në sondazh të intervistuarve iu bënë pyetje të ndryshme në lidhje me faktin nëse e praktikojnë fenë e tyre dhe ritet fetare si dhe sa shpesh. Në Figurën 13 tregohet se 14.5 për qind e të anketuarve deklaruan se ata luten/falen rregullisht (çdo ditë / javë), 19.7 për qind në festa fetare përgjatë gjithë vitit, ndërsa 20.2 për qind nuk luten/falen asnjëherë dhe pjesa e mbetur luten/falen vetëm me raste, në ngjarje të veçanta fetare, 28.7% ose vetëm me raste, në kohë krize personale/familjare 16.9%.

**FIGURA 13 SA SHPESH LUTENI/FALENI? (%)**



Në pyetjen tjetër në pyetësor jepeshin një sërë opsionesh që të anketuarit të evidentonin deklaratën që i përshkruan më mirë ata personalisht. Rezultatet raportohen në Tabelën 16. “Unë

besoj në Zot dhe i praktikoj rregullisht ritet e fesë sime” përshkruante pjesën më të madhe të të intervistuarve (42.3%), ndërkohë që një pjesë tjetër prej 26.8% e përshkruanin veten si besimtar që “besoj në Zot por nuk i praktikoj ritet e fesë sime”. Vetëm 9.6% e të anketuarve e përshkruanin veten si besimtarë që besojnë në Zot dhe që i praktikojnë të gjitha ritet fetare, edhe pse një tjetër pjesë prej 16.9% deklaruan se ata praktikonin shumicën e riteve të fesë së tyre, ndërkohë që 3.6% e përshkruanin veten si njerëz që nuk besonin në Zot (Tabela 16).

**TABELA 16 CILA NGA DEKLARATAT E MËPOSHTME JU PËRSHKRUAN MË MIRË JU PERSONALISHT?**

	Përqindja
Unë besoj në Zot dhe i praktikoj rregullisht të gjitha ritet e fesë sime	9.6
Unë besoj në Zot dhe praktikoj rregullisht shumicën e riteve të fesë sime	16.9
Unë besoj në Zot dhe praktikoj me raste ritet e fesë sime	42.3
Unë besoj në Zot por nuk i praktikoj ritet e fesë sime	26.8
Unë nuk besoj në Zot	3.6
Tjetër	0.8

Mes të intervistuarve nga zonat rurale dhe urbane u vunë re dallime statistiki të konsiderueshme në lidhje me pyetjen “Cila nga deklaratat e mëposhtme ju përshkruan më mirë ju personalisht?” Në Tabelën 17 raportohet se rreth 30 për qind e të intervistuarve nga zonat rurale deklarorin se i praktikonin të gjitha ose shumicën e riteve fetare të fesë së tyre, ndërsa më pak se një e katërta e të intervistuarve nga zonat urbane deklarorin një gjë të tillë.

**TABELA 17 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR PYETJEN CILA NGA DEKLARATAT E MËPOSHTME JU PËRSHKRUAN MË MIRË JU PERSONALISHT? SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**


		Rural	Urban	Total
Unë besoj në Zot dhe i praktikoj rregullisht të gjitha ritet e fesë sime	numri	59	45	104
	%	13.1	7.1	9.6
Unë besoj në Zot dhe praktikoj rregullisht shumicën e riteve të fesë sime	numri	74	110	184
	%	16.4	17.3	16.9
Unë besoj në Zot dhe praktikoj me raste ritet e fesë sime	numri	183	277	460
	%	40.6	43.5	42.3
Unë besoj në Zot por nuk i praktikoj ritet e fesë sime	numri	121	171	292
	%	26.8	26.8	26.8
Unë nuk besoj në Zot	numri	11	28	39
	%	2.4	4.4	3.6
Tjetër	numri	3	6	9
	%	0.7	0.9	0.8
<b>Gjithsej</b>	<b>numri</b>	<b>451</b>	<b>637</b>	<b>1,088</b>
	<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Gjetjet e dy pyetjeve të fundit, (Figura 13—Sa shpesh luteni/faleni?—dhe Tabelat 16 dhe 17—Cila nga deklaratat e mëposhtme ju përshkruan më mirë ju personalisht?), si dhe një sërë gjetjesh të këtij sondazhi (p.sh., përqindja e të anketuarve që thonë se “besimi i tyre fetar u kufizon

veprimet” apo që “luten/falen rregullisht), sugjeron se edhe pse një pjesë e konsiderueshme (37.3%) deklaroi se praktikoi rregullisht besimin e tyre fetar, numri i atyre që luten/falen dhe praktikojnë rregullisht ritet fetare është në nivel shumë më të vogël.


Qasja individuale e besimtarëve të ndryshëm dallon mes atyre që luten/falen rregullisht dhe atyre që luten/falen në festat fetare. Vetëm gjysma e atyre që thanë se luten/falen çdo ditë apo javë deklaroi se “i praktikojnë të gjitha ritet fetare” (Figura 14).

**FIGURA 14 NIVELI I BESIMIT DHE SHPESHTËSIA E LUTJES/FALJES SË TË ANKETUARVE**




Shumica e besimtarëve praktikantë që luten/falen rregullisht (çdo ditë apo javë) apo në festat fetare gjatë një viti besojnë se “Nuk ka shumë rëndësi se çfarë besoj, për aq kohë sa bëj një jetë të moralshme” (Figura 15).

**FIGURA 15 PËRGJIGJET PËR DEKLARATËN NUK KA SHUMË RËNDËSI SE ÇFARË BESOJ, PËR AQ KOHË SA BËJ NJË JETË TË MORALSHME MES ATYRE QË LUTEN/FALEN RREGULLISHT DHE ATYRE QË LUTEN/FALEN ME RASTE**



Së fundi, analiza e përgjigjeve ndaj deklaratave që lidhen me shpeshësinë e lutjes/faljes na jep një pamje më të qartë të perceptimeve dhe qëndrimeve të individëve ndaj Hyjtores/Së shenjtës. Shumica dërrmuese e atyre që praktikojnë të gjitha ritet fetare priren të jenë kryesisht ose plotësisht dakord (82.7%) me deklaratën "Lutja/Falja mund të jetë e vlefshme vetëm nëse i lutesh / falesh Emrit të duhur Hyjnor". Kjo përqindje është më e ulët tek grupet që praktikojnë pak ose aspak ritet fetare (Figura 16).

**FIGURA 16 PËRGJIGJET NDAJ DEKLARATËS LUTJA/FALJA MUND TË JETË E VLEFISHME VETËM NËSE I LUTESH / FALESH EMRIT TË DUHUR HYJNOR MES NIVELEVE TË NDRYSHME TË PRAKTIKIMIT TË RITEVE FETARE**




### V.2.2. PERCEPTIMET PËR TOLERANCËN FETARE

Në pjesën e dytë të pyetësorit u shqyrtuan perceptimet e të anketuarve për tolerancën fetare në Shqipëri, rreziqet dhe faktorët mundësues si dhe qëndrimet vendore dhe të shoqërisë ndaj bashkëjetesës fetare. Për të analizuar mjedisin e supozimeve të përhapura për tolerancën fetare, të anketuarve iu bënë pyetje nëse janë dakord dhe në ç'masë janë dakord me një numër deklaratash që përshkruajnë faktorë ose variabël të ndryshëm lidhur me tolerancën fetare.

Ashtu si edhe pritej, pjesa më e madhe (>60%) e të intervistuarve ishin kryesisht ose plotësisht dakord me deklaratën që lidhet me këtë çështje. (Figura 17). Shumica dërrmuese besojnë se "Toleranca fetare është një vlerë themelore në Shqipëri" (92.3%) dhe se "Në Shqipëri shteti nuk i ndërhyt individit në besimin e vet fetar" (91.9%), ndërkohë që afro 80% janë kryesisht ose plotësisht dakord me rëndësinë e disa faktorëve të tolerancës fetare, si:

- Ndjenjat kombëtare ushqejnë tolerancën fetare në Shqipëri (83.3%).
- Laicizmi ka forcuar tolerancën fetare në Shqipëri (83.1%).
- Drejtuesit e komuniteteve fetare luajnë një rol thelbësor në nxitjen e tolerancës fetare në vend (80.6%).
- Kombësia e njëjtë është ajo që e bën të mundur tolerancën fetare në Shqipëri (80.3%).

FIGURA 17 PËRGJIGJET NDAJ PYETJEVE NË LIDHJE ME NIVELIN E TOLERANCËS FETARE



Deklaratat e mëposhtme morën mbështetjen e mbi 70 përqind të të intervistuarve:

- Toleranca fetare është më e fortë në nivel vendor ku ka komunitete të përziera; 79.7 për qind janë kryesisht ose plotësisht dakord.
- Përfaqësimi i drejtë i komuniteteve fetare në administratën shtetërore është i rëndësishëm për tolerancën fetare në vend; 78 për qind janë kryesisht ose plotësisht dakord.
- Toleranca fetare në Shqipëri i detyrohet faktit që shqiptarët në përgjithësi nuk janë shumë fetarë; 76.3 për qind janë kryesisht ose plotësisht dakord.
- Klerikët fetarë në nivel vendor ushqejnë vlerat e tolerancës fetare tek besimtarët; 74.4 për qind janë kryesisht ose plotësisht dakord.
- Mungesa e informacionit për fetë e tjera i bën njerëzit të jenë më tolerantë ndaj tyre; 70.3 për qind janë kryesisht ose plotësisht dakord.

Mbi 60% e të anketuarve ishin kryesisht ose plotësisht dakord me deklaratat e tjera. Megjithatë, për një numër të caktuar deklaratash rreth 14-18% e të intervistuarve ishin asnjnës:

- Simbolet dhe ritet fetare nuk duhet të lejohen në administratën publike ose në shkollë (14.7%).



- Politikat komuniste kundrejt fesë (ndalimi i fesë) në periudhën 1967-1990 kanë kontribuar në tolerancën fetare në Shqipëri (15.2%).
- Toleranca fetare është më e fortë në nivel vendor ku ka komunitete të përziera (15.4%).
- Mungesa e informacionit për fetë e tjera i bën njerëzit të jenë më tolerantë ndaj tyre (16.5%).
- Klerikët fetarë në nivel vendor ushqejnë vlerat e tolerancës fetare tek besimtarët (17.9%).

Pavarësisht nivelit të lartë të miratimit, rreth 20% e pjesëmarrësve në sondazh nuk ishin aspak dakord ose kryesisht jo-dakord me tre deklaratat e mëposhtme:

- Komunitetet fetare duhet të marrin financime nga buxheti i shtetit për të realizuar aktivitetet e tyre (21.8%).
- Simbolet dhe ritet fetare nuk duhet të lejohen në administratën publike ose në shkollë (20.5%).
- Politikat komuniste kundrejt fesë (ndalimi i fesë) në periudhën 1967-1990 kanë kontribuar në tolerancën fetare në Shqipëri (17.1%).

Katër nga katërmbëdhjetë deklaratat lidhur me këtë çështje nxjerrin në pah dallime statistikisht të rëndësishme mes grupeve demografike. Është interesante të evidentohet se dallimet kryesore janë mes të anketuarve nga zonat urbane dhe ato rurale. Zonat urbane kishin një përqindje më të lartë (Tabela 18) të të anketuarve që ishin kryesisht ose plotësisht dakord me deklaratën "Sekularizmi (ndarja e shtetit nga feja) ka forcuar tolerancën fetare në Shqipëri" (85.8%) sesa ato nga zonat rurale (79.2%). Megjithatë, dallimi mes komuniteteve rurale dhe urbane për sa i përket mosmiratimit ose mosmiratimit të vendosur ishte i vogël, në 2.4 për qind, ndërkohë që të anketuarit në zonat rurale ishin më asnjans sesa atë të zonave urbane (13.1% dhe 8.9% respektivisht).

**TABELA 18 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN SEKULARIZMI (NDARJA E SHTETIT NGA FEJA) KA FORCUAR TOLERANCËN FETARE NË SHQIPËRI, SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Sekularizmi (ndarja e shtetit nga feja) ka forcuar tolerancën fetare në Shqipëri	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	34	33	67
		%	7.7	5.3	6.3
	Asnjans	numri	58	55	113
		%	13.1	8.9	10.7
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	350	531	881
		%	79.2	85.8	83.0
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>442</b>	<b>619</b>	<b>1,061</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Dallimet mes pjesëmarrësve nga zonat urbane dhe rurale janë më të theksuara për sa i përket deklaratës "Toleranca fetare në Shqipëri i detyrohet faktit që shqiptarët në përgjithësi nuk janë shumë fetarë". Ndërkohë që të anketuarit nga zonat urbane prireshin të ishin kryesisht ose plotësisht dakord (79.4%) me këtë deklaratë, më pak të intervistuar nga zonat urbane ishin dakord (71.9%) dhe ku vihej re një përqindje më e lartë të përgjigjeve asnjans apo "aspak dakord ose kryesisht jo-dakord" (Tabela 19).

**TABELA 19 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN TOLERANCA FETARE NË SHQIPËRI I DETYROHET FAKTIT QË SHQIPTARËT NË PËRGJITHËSI NUK JANË SHUMË FETARË, SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Toleranca fetare në Shqipëri i detyrohet faktit që shqiptarët në përgjithësi nuk janë shumë fetarë	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	54	56	110
		%	12.2	8.9	10.3
	Asnjë	numri	70	74	144
		%	15.8	11.7	13.4
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	318	500	818
		%	71.9	79.4	76.3
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>442</b>	<b>630</b>	<b>1,072</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>


Diferencat mes të anketuarve urbanë dhe ruralë vihen re edhe tek përgjigjet ndaj deklaratës “Politikat komuniste kundrejt fesë (ndalimi i fesë) në periudhën 1967-1990 kanë kontribuar në tolerancën fetare në Shqipëri”. Megjithatë, diferencat janë për përqindjet e atyre që nuk janë aspak ose kryesisht jo-dakord me deklaratën (20.3% nga zonat rurale dhe 14.9% nga zonat urbane), siç raportohet në Tabelën 20.

**TABELA 20 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN POLITIKAT KOMUNISTE KUNDREJT FESË (NDALIMI I FESË) NË PERIUdhËN 1967-1990 KANË KONTRIBUAR NË TOLERANCËN FETARE NË SHQIPËRI SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Politikat komuniste kundrejt fesë (ndalimi i fesë) në periudhën 1967-1990 kanë kontribuar në tolerancën fetare në Shqipëri	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	85	89	174
		%	20.3	14.9	17.1
	Asnjë	numri	54	101	155
		%	12.9	16.9	15.2
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	279	409	688
		%	66.7	68.3	67.6
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>418</b>	<b>599</b>	<b>1,017</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Për të provuar nëse ka dallime mes anketuarve që kanë jetuar nën regjimin komunist dhe që kujtojnë atë mënyrë jetese dhe atyre që nuk e kanë pasur një përvojë të tillë u kryen analiza demografike të tjera. Analiza tregon se të anketuarit e moshës mbi 45 vjeç prirën të jenë kryesisht ose plotësisht dakord me këtë deklaratë, ndërkohë që një përqindje më e lartë e 18-30 vjeçarëve prirën ta kundërshtojnë ose të mos jenë aspak dakord me deklaratën (Figura 18).

**FIGURA 18 PËRGJIGJET PËR DEKLARATËN POLITIKAT KOMUNISTE KUNDREJT FESË (NDALIMI I FESË) NË PERIUdhËN 1967-1990 KANË KONTRIBUAR NË TOLERANCËN FETARE NË SHQIPËRI**



Deklarata e fundit "Mungesa e informacionit për fetë e tjera i bën njerëzit të jenë më tolerantë ndaj tyre" evidentoi dallime mes të anketuarve nga zonat urbane dhe rurale. Ata nga zonat urbane prireshin të ishin më shumë dakord dhe ta kundërshtonin më pak këtë deklaratë në krahasim me të intervistuarit nga zonat rurale, ndërkohë që përqindja e përgjigjeve asnjanëse ishte e ngjashme në të dy grupet demokratike (Tabela 21).

**TABELA 21 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN MUNGESA E INFORMACIONIT PËR FETË E TJERA I BËN NJERËZIT TË JENË MË TOLERANTË NDAJ TYRE, SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Mungesa e informacionit për fetë e tjera i bën njerëzit të jenë më tolerantë ndaj tyre.	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	74	66	140
		%	16.7	10.6	13.2
	Asnjanës	numri	72	103	175
		%	16.3	16.6	16.5
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	296	451	747
		%	67.0	72.7	70.3
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>442</b>	<b>620</b>	<b>1,062</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>


Për të vlerësuar më tej rëndësinë e faktorëve dhe rrethanave të ndryshme për tolerancën fetare në Shqipëri, në pyetësor u bë një pyetje me fund të hapur: "Cili është faktori më i rëndësishëm që mundëson tolerancën fetare në Shqipëri? Pesë përgjigjet të raportuara më shpesh (970 nga 1,100) ishin si më poshtë:

1. Indiferenca fetare ose mungesa e njohurive për fetë, 304 vetë
2. Kultura vendore (kombëtare) dhe dominimi i traditave kombëtare ndaj atyre fetare, 254 vetë
3. Respekti i ndërsjellë dhe respektim për liritë individuale, 99 vetë
4. Sekularizmi, 72 vetë
5. Periudha komuniste, 68 vetë.

Edhe pse faktorët e sipërpërmendur tregojnë se mungesa e njohurive për fetë ose indiferenca fetare në përgjithësi është një tipar dominues i publikut shqiptar, të anketuarit ende priren ta vlerësojnë lartë shoqërinë në përgjithësi ose komunitetin në të cilin jetojnë kur pyeten për nivelin e ndërgjegjësimit fetar.

Në Figurën 19 jepen perceptimet për tolerancën fetare në Shqipëri nëpërmjet përgjigjeve ndaj pyetjes “Ku do e rendisnit komunitetin ku jetoni, në një shkallë nga 1 (indiferencë e plotë fetare) deri në 5 (njohje e plotë dhe pranim i besimit fetar të tjetrit)?”


**FIGURA 19 PËRGJIGJET PËR PYETJEN KU DO E RENDISNIT KOMUNITETIN KU JETONI, NË NJË SHKALLË NGA 1 (INDIFERENCË E PLOTË FETARE) DERI NË 5 (NJOHJE E PLOTË DHE PRANIM I BESIMIT FETAR TË TJETRIT)? (%)**



Më pak se 15% e të anketuarve prireshin ta karakterizonin shoqërinë shqiptare (14.7%) ose komunitetin e tyre (9%) si me “njohje të plotë & pranim të besimit fetar të tjetrit”. Interesante është se kishte një opinion më të mirë për shoqërisë shqiptare sesa për njerëzit në mjedisin e tyre të ngushtë.

Edhe pse kampioni në përgjithësi përbëhej nga të intervistuar nga zonat urbane (58.5%), pjesa më e madhe e të anketuarve që i dhanë komunitetit të tyre 4 apo 5 pikë vinin nga zonat rurale, ndërkohë që një përqindje më e madhe e të anketuarve nga zonat urbane e konsideronin komunitetin e tyre si me indiferencë të plotë fetare (pikët 1 ose 2; Figura 20).

**FIGURA 20 PËRGJIGJET PËR PYETJEN KU DO E RENDISNI KOMUNITETIN KU JETONI, NË NJË SHKALLË NGA 1 (INDIFERENCË E PLOTË FETARE) DERI NË 5 (NJOHJE E PLOTË DHE PRANIM I BESIMIT FETAR TË TJETRIT)? SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**



Së fundi, pjesëmarrësit e sondazhit iu përgjigjën edhe pyetjes se cili ishte kërcënimi më i madh ndaj tolerancës fetare në Shqipëri. Në total kësaj pyetjeje iu përgjigjën 838 pjesëmarrës dhe tre kërcënimet më të raportuara më shpesh ishin si më poshtë:

- Terrorizmi, ekstremizmi fetar dhe nxitja e urrejtjes fetare, 324 vetë
- Politizimi i fesë (diskriminimi fetar nga shteti apo ndërhyrja e fesë në çështjet shtetërore), 70 vetë
- Kërcënimet dhe propaganda e jashtme apo konfliktet jashtë vendit, 41 vetë.

Me interes është fakti se 106 të intervistuar mendonin se nuk ka kërcënime për tolerancën fetare në Shqipëri, ndërkohë që 52 të tjerë thanë se nuk dinin t'i përgjigjeshin kësaj pyetjeje.

### V.2.3. QËNDRIMET DHE EKSPERIENCAT LIDHUR ME TOLERANCËN FETARE

Në pjesën e fundit të pyetësorit u shtjelluan përvojat me intolerancën fetare si dhe qëndrimet dhe perceptimet e mëtejshme apo marrëdhëniet me grupet e tjera fetare. Në sondazh iu kërkua të anketuarve të flisnin për përvojat e tyre me diskriminimin ose përjashtimin me bazë fetare. Në Tabelën 22 jepen gjetjet për këtë çështje.

**TABELA 22 PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE TË NDRYSHME PËR PYETJEN SA SHPESH I KENI PËRJETUAR NGJARJET E MËPOSHTME?**


	Kurrë	Rrallë, me raste	Shpesh	Rregullisht	Gjithsej
Unë personalisht jam diskriminuar / përjashtuar për shkak të përkatësisë fetare.	95.3	3.8	0.6	0.3	100
Një anëtar i familjes sime është diskriminuar /përjashtuar personalisht për shkak të përkatësisë fetare.	96.7	2.8	0.4	0.2	100
Kam qenë dëshmitar i diskriminimit / përjashtimit me bazë fetare të njerëzve të tjerë në komunitetin ku jetoj	89.3	8.5	1.6	0.6	100

Më shumë se 95 për qind e të anketuarve deklaruan se ata personalisht (95.3%) ose anëtarë të familjes së tyre (96.7%) nuk janë diskriminuar ose përjashtuar si rezultat i përkatësisë së tyre fetare. Ndërkohë, përkatësisht 3.8 për qind dhe 2.8 për qind raportuan se raste të tilla kanë ndodhur por vetëm rrallë, dhe më pak se një për qind kanë raportuar që diskriminimi ose përjashtimi me bazë fetare ka ndodhur rregullisht ose shpesh.

Shifrat janë paksa të ndryshme për ata që kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit ose përjashtimit me bazë fetare të njerëzve të tjerë në komunitetet e tyre, ku 2.2 për qind deklaruan se kanë qenë dëshmitarë të rasteve të tilla rregullisht ose shpesh dhe një tjetër grup prej 8.5 për qind që pohuan se rrallëherë kanë parë raste të tilla. Plot 89.3 për qind deklaruan se nuk kanë qenë kurrë dëshmitarë të rasteve të diskriminimit ose përjashtimit me bazë fetare.

Grupi i të intervistuarve, që kanë parë (rrallë, shpesh ose rregullisht) diskriminim ose përjashtim me bazë fetare të njerëzve të tjerë në komunitetin ku jetojnë, ka karakteristika interesante demografike: 55 për qind vinin nga zonat urbane dhe gati 53 për qind ishin gra. Në Figurën 21 evidentohet grafikisht se shumica e këtij grupi të anketuarish (51.7%) kanë diplomë universitare ose pasuniversitare.

**FIGURA 21 NIVELI MË I LARTË I ARSIMIT I PËRFUNDUAR NGA ATA QË KANË QENË DËSHMITARË TË DISKRIMINIMIT OSE PËRJASHTIMIT ME BAZË FETARE TË NJERËZVE TË TJERË NË KOMUNITETIN KU JETOJNË (%)**



Të anketuarve iu kërkua të përshkruanin shkurtimisht raste të diskriminimit ose përjashtimit me bazë fetare, të cilat i kanë përjetuar ose për të cilat kanë qenë dëshmitarë. Gjithsej 129 të anketuar kanë ofruar shembuj të tillë, ku shumica u referohej myslimanëve (Tabela 23).

**TABELA 23 LLOJE TË DISKRIMINIMIT OSE PËRNASHTIMIT ME BAZË FETARE QË KANË PËRJETUAR OSE PARË TË INTERVISTUARIT**

	Nr. i të intervistuarve
Diskriminimi ose përjashtimi nga institucionet publike ose private:	59
Përjashtimi social ose përjashtimi në shkolla ose refuzimi i punësimit në institucionet publike ose private të grave që mbajnë shami koke ose burra me mjekra ose persona të feve të tjera	59
Diskriminimi ose përjashtimi nga shoqëria:	20
Besimtarët praktikantë që ushtrojnë fenë e tyre, veçanërisht myslimanët ose dëshmitarët e Jehovait perceptohen ndryshe	31
Diskriminimi ose përjashtimi në marrëdhënie të ngushta	6
Refuzim martesë/krushqie për shkak të përkatësisë së ndryshme fetare dhe diferencim social me bazë fetare	20
Paragjykim nga përfaqësues fetarë	13
Të tjera	6

Diskriminimi i grupeve të ndryshme fetare ose i grupeve të tjera në shoqëri shpesh nxitet nga paragjykimet dhe stereotipet negative. Prandaj, në sondazh u analizuan stereotipat apo paragjykimet e mundshme ndaj anëtarëve të të pesë komuniteteve kryesore fetare në Shqipëri: mysliman, ortodoks, katolik, protestant dhe bektashian. Të anketuarve iu bë pyetja “Në komunitetin ku jetoni, si do t’i vlerësonit anëtarët e grupeve të tjera fetare përsa i përket cilësive të mëposhtme” në lidhje me cilësitë e mëposhtme: punëtorë, miqësorë, inteligjente, të dhunshme ose përtacë. Mes 60 dhe 79 për qind e të anketuarve deklaruan se feja nuk është përcaktuese për vlerësimin e individëve në lidhje me këto vlera ose cilësi. Megjithatë, teksa përballen me stereotipa negative, të anketuarit deklaruan se janë më të hapur për pranimin e cilësive pozitive (Tabela 24).

**TABELA 24 NIVELI I VLERËSIMIT TË VLERAVE TË NDRYSHME NË KOMUNITETET E NDRYSHME FETARE, NËPËRMJET PËRGJIGJEVE PËR PYETJEN NË KOMUNITETIN KU JETONI, SI DO T’I VLERËSONIT ANËTARËT E GRUPEVE TË TJERA FETARE PËRSA I PËRKET CILËSIVE TË MËPOSHTME?**

		Aspak dakord	Jo dakord	Asnjëherë	Dakord	Plotësisht dakord	Feja nuk është përcaktor	Gjithsej
a. Punëtorë	a. Myslimane	0.5	2.2	7.8	9.2	14.6	65.7	100
	b. Ortodokse	0.2	3.1	7.1	10.0	12.3	67.3	100
	c. Katolike	0.0	2.0	7.9	10.3	12.2	67.6	100
	d. Bektashi	0.0	3.4	8.6	8.7	10.3	69.1	100
	e. Protestante	0.7	1.8	7.2	4.7	9.6	76.0	100
b. Miqësorë	a. Myslimane	0.3	1.3	7.4	9.1	21.3	60.6	100
	b. Ortodokse	0.0	2.0	4.5	10.1	21.1	62.2	100
	c. Katolike	0.1	1.7	4.1	10.1	21.7	62.3	100
	d. Bektashi	0.6	1.1	4.3	9.6	19.1	65.3	100
	e. Protestante	1.2	1.8	4.9	7.8	14.3	70.0	100

c. Inteligjentë	a. Myslimane	0.6	1.0	7.5	7.1	12.8	71.0	100
	b. Ortodokse	0.1	0.7	6.3	8.1	12.4	72.4	100
	c. Katolike	0.5	0.3	6.1	8.9	12.0	72.2	100
	d. Bektashi	0.4	0.5	8.5	6.8	9.6	74.2	100
	e. Protestante	1.3	1.1	4.3	5.4	9.0	78.9	100
d. Të dhunshëm	a. Myslimane	17.3	6.4	5.5	1.9	3.6	65.4	100
	b. Ortodokse	20.5	5.3	4.2	1.7	0.7	67.6	100
	c. Katolike	21.4	6.3	3.0	1.2	0.9	67.2	100
	d. Bektashi	19.5	6.2	3.4	0.3	0.7	69.9	100
	e. Protestante	16.1	4.9	3.6	0.3	0.7	74.3	100
e. Përtacë	a. Myslimane	12.9	7.4	5.6	2.2	1.9	70.2	100
	b. Ortodokse	12.0	8.5	5.2	2.2	0.9	71.2	100
	c. Katolike	12.4	8.6	5.3	2.1	0.9	70.7	100
	d. Bektashi	11.6	6.9	4.8	3.1	1.2	72.4	100
	e. Protestante	11.9	5.9	4.1	0.5	0.6	76.9	100

Pjesëmarrësve në sondazh iu bë edhe pyetja “Në komunitetin ku jetoni, përgjithësisht si ndiheni kur mendoni për anëtarëve të grupeve të tjera fetare?” Rreth gjysma e të anketuarve mendonin se feja nuk është përcaktor (Tabela 25). Shumica e të anketuarve të tjerë nuk ishin aspak dakord se ata do të ndiheshin të frikësuar apo të stresuar kur mendonin për anëtarë të grupeve të tjera fetare, ndërsa gati 39 deri 42 për qind thanë se do të ndiheshin të qetë.

**TABELA 25 PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE TË NDRYSHME PËR PYETJEN NË KOMUNITETIN KU JETONI, PËRGJITHËSISHT SI NDIHENI KUR MENDONI PËR ANËTARËVE TË GRUPEVE TË TJERA FETARE?**


		Aspak dakord	Jo dakord	Asnjansës	Dakord	Plotësisht dakord	Feja nuk është përcaktor	Gjithsej
a) I/E frikësuar	a. Myslimane	47.1	5.8	1.3	0.4	1.5	43.9	100
	b. Ortodokse	52.1	2.2	0.7	0.2	0.3	44.6	100
	c. Katolike	51.9	1.8	0.8	0.0	0.7	44.9	100
	d. Bektashi	50.7	2.0	0.9	0.1	0.7	45.7	100
	e. Protestante	48.1	3.4	1.1	0.2	0.9	46.3	100
b) I/E qetë	a. Myslimane	1.9	2.8	5.0	5.6	36.3	48.3	100
	b. Ortodokse	2.0	0.5	6.4	3.8	38.5	48.9	100
	c. Katolike	2.1	0.5	5.7	4.7	37.5	49.4	100
	d. Bektashi	2.0	1.9	6.1	3.3	36.5	50.3	100
	e. Protestante	2.7	1.2	5.4	4.0	35.1	51.6	100
c) I/E stresuar	a. Myslimane	37.5	5.0	1.1	1.1	2.4	52.9	100
	b. Ortodokse	41.1	2.4	1.2	0.8	1.9	52.6	100
	c. Katolike	40.0	3.2	1.2	0.9	2.1	52.6	100
	d. Bektashi	38.6	2.6	1.8	0.9	2.4	53.8	100
	e. Protestante	36.9	2.9	1.9	1.3	2.6	54.4	100

Në pyetjen tjetër në sondazh pjesëmarrësit u pyetën sa gjasa ka që të pranonin një person të një besimit tjetër fetar në një sërë pozicionesh apo situatash, si shef, lider politik apo kolegj pune.



Figura 22 tregon sa gjasa kanë të intervistuarit ta pranojnë një anëtar të një grupi tjetër fetar në pozicione të ndryshme. Edhe pse përqindja e të anketuarve që ka shumë gjasa t'i pranojë ata në një sërë pozicionesh është e lartë (> 70%), përqindja zbritet në 66.5 për qind për pranimin si krushk, me nëntë për qind duke thënë se do të ishte krejtësisht e pamundur ose e pamundur. Sidoqoftë, përqindja që mendonte se ishte e mundur ose shumë e mundur ishte 89.5 për qind (edhe pse ende më pak se për pozicione të tjera: 91-95%).

**FIGURA 22 SA GJASA KA QË JU TË PRANONI NJË PERSON TË NJË BESIMIT TJETËR (NGA JU) FETAR NË POZICIONET E MËPOSHTME?**




Ndonëse rreth 3/4 (70.6%) e të anketuarve thanë se ka gjasa që të pranonin anëtarët e grupeve të tjera fetare si shokë të ngushtë, për dy opsionet e fundit (shokë të ngushtë dhe krushqi), përqindja e atyre që kishin gjasa ose shumë gjasa të pranonin anëtarë të grupeve të tjera fetare ra nën 90 për qind.

Këto të dhëna tregojnë se disa të intervistuar marrin parasysh përkatësinë fetare kur bëhet fjalë për lidhjet e ngushta personale, por nuk mendojnë se është një faktor i rëndësishëm në lidhje me pozicione të tilla si udhëheqës politik, kryetar bashkie, polic, mësues ose dikush në marrëdhëniet e tyre të drejtpërdrejta të punës (shef apo koleg).


Në analizë u shqyrtua edhe nëse besimi fetar luan një rol në pranimin nga të intervistuarit i njerëzve të feve të tjera si shokë të ngushtë apo krushq. Një dallim me rëndësi statistikor u vu re për këta të fundit, me ata që e konsiderojnë veten si besimtarë praktikantë të rregullt që prirën të jenë më pak të hapur për pranimin e anëtarëve të grupeve të tjera fetare (Figura 23).

**FIGURA 23 SA GJASA KA QË JU TË PRANONI NJË PERSON TË NJË BESIMIT TJETËR (NGA JU) FETAR SI KRUSHK, SIPAS BESIMIT FETAR**




Kjo tendencë është më pak e pranishme kur bëhet fjalë për pranimin e njerëzve nga grupet e tjera fetare si shokë të ngushtë, me dallime më pak të rëndësishme mes atyre që e konsiderojnë veten si besimtarë praktikantë të rregullt dhe atyre që nuk e konsiderojnë veten si të tillë (Figura 24).

**FIGURA 24 SA GJASA KA QË JU TË PRANONI NJË PERSON TË NJË BESIMIT TJETËR (NGA JU) FETAR SI SHOK TË NGUSHTË, SIPAS BESIMIT FETAR**



Në fund të këtij seksioni, pjesëmarrësve në sondazh iu bë pyetja nëse ata fajësonin njerëzit e feve të tjera për dukuri të ndryshme negative (Figura 25). Në përgjithësi, pjesëmarrësit nuk i konfirmuan qëndrimet negative si të tyre, edhe pse 14% ishin kryesisht ose plotësisht dakord me deklaratën "Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për shumë prej trazirave në botë".

**FIGURA 25 SHKALLA NË TË CILËN TË INTERVISTUARIT FAJËSOJNË FETË E TJERA PËR PROBLEME TË NDRYSHME SOCIALE**



U vunë re dallime të konsiderueshme mes grupeve të ndryshme demografikë (femra-meshkuj, rural-urban, grupmosha të ndryshme) në lidhje me katër nga pesë deklaratat që tregohen në Figurën 25.

Përgjigjet ndaj deklaratës së parë “Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për shumë prej trazirave në botë” ndryshojnë sipas grupmoshave (Tabela 26), ku ata 36-45 vjeç kishin përqindjen më të lartë (84%) të atyre që nuk ishin aspak dakord ose jo-dakord, dhe përqindja më e ulët tek të anketuarit mbi 65 vjeç. Kjo grup moshë e fundit ishte kryesisht ose plotësisht dakord në një përqindje dukshëm më të lartë se sa grupmoshat e tjera.

**TABELA 26 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN UNË FAJËSOJ NJERËZIT E FEVE TË TJERA PËR SHUMË PREJ TRAZIRAVE NË BOTË, SIPAS GRUPMOSHAVE**

			Age group (years)						Total
			18–25	26–35	36–45	46–55	56–65	> 65	
I blame people of other religions for much of the trouble in this world	Strongly disagree or disagree	count	180	230	152	133	88	54	837
		%	78.3	79.6	84.0	77.8	73.3	65.1	77.9
	Asnjëherë	count	15	23	13	16	8	12	87
		%	6.5	8.0	7.2	9.4	6.7	14.5	8.1
	Strongly agree or agree	count	35	36	16	22	24	17	150
		%	15.2	12.5	8.8	12.9	20.0	20.5	14.0
Total	count	230	289	181	171	120	83	1,074	
	%	100	100	100	100	100	100	100	

Përgjigjet për deklaratën e dytë –“Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për ekonominë e dobët në vend” – ndryshonin sipas gjinisë dhe vendbanimit. Edhe pse të vogla, diferencat në përqindjen e të anketuarve që ishin kryesisht ose plotësisht dakord me deklaratën janë me rëndësi statistikore. Si në Tabelën 27 evidentohen më shumë të anketuar meshkuj që mbështetnin këtë deklaratë (3.8%) sesa femrat (1.3%).

**TABELA 27 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN UNË FAJËSOJ NJERËZIT E FEVE TË TJERA PËR EKONOMINË E DOBËT NË VEND, SIPAS GJINISË**

			Gjinia		Gjithsej	
			Meshkuj	Femra		
Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për ekonominë e dobët në vend	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	479	499	978	
		%	90.5	92.8	91.7	
	Asnjanës	numri	30	32	62	
		%	5.7	5.9	5.8	
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	20	7	27	
		%	3.8	1.3	2.5	
	<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>529</b>	<b>538</b>	<b>1,067</b>
			<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Sic raportohet edhe në Tabelën 28, më shumë të intervistuar nga zonat rurale (3.9) ishin kryesisht ose plotësisht dakord me deklaratën sesa ata që vijnë nga zonat urbane (1.6%).

**TABELA 28 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN UNË FAJËSOJ NJERËZIT E FEVE TË TJERA PËR EKONOMINË E DOBËT NË VEND, SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej	
Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për ekonominë e dobët në vend	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	401	577	978	
		%	91.1	92.0	91.7	
	Asnjanës	numri	22	40	62	
		%	5.0	6.4	5.8	
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	17	10	27	
		%	3.9	1.6	2.5	
	<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>440</b>	<b>627</b>	<b>1,067</b>
			<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Edhe vendbanimi dhe gjinia kanë efekt në përgjigjet për deklaratën "Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për nivelin e lartë të kriminalitetit në vend". Më shumë të intervistuar nga zonat urbane nuk ishin aspak dakord apo jo-dakord me deklaratën sesa të anketuarit që vijnë nga zonat rurale që ishin kryesisht ose plotësisht dakord (Tabela 29).

**TABELA 29 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN UNË FAJËSOJ NJERËZIT E FEVE TË TJERA PËR NIVELIN E LARTË TË KRIMINALITETIT NË VEND, SIPAS VENDBANIMIT (RURAL-URBAN)**

			Rural	Urban	Gjithsej
Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për nivelin e lartë të kriminalitetit në vend	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	413	600	1,013
		%	91.8	94.2	93.2
	Neutral	numri	24	31	55
		%	5.3	4.9	5.1
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	13	6	19
		%	2.9	0.9	1.7
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>450</b>	<b>637</b>	<b>1,087</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Ndërkohë, një numër më i madh të intervistuarish meshkuj ishin kryesisht ose plotësisht dakord dhe një numër më i vogël nuk ishin aspak dakord ose jo-dakord me këtë deklaratë krahasuar me të intervistuarit femra (Tabela 30).

**TABELA 30 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN UNË FAJËSOJ NJERËZIT E FEVE TË TJERA PËR NIVELIN E LARTË TË KRIMINALITETIT NË VEND, SIPAS GJINISË**

			Gjinia		Gjithsej
			Meshkuj	Femra	
Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për nivelin e lartë të kriminalitetit në vend	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	498	515	1,013
		%	92.2	94.1	93.2
	Asnjëherë	numri	27	28	55
		%	5.0	5.1	5.1
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	15	4	19
		%	2.8	0.7	1.7
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>540</b>	<b>547</b>	<b>1,087</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Së fundi, kishte dallime mes grupmoshave për sa i përket deklaratës “Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për korruptimin e vlerave të shoqërisë sonë”. Të anketuarit e moshës 26-35 vjeç dhe ata më të vjetër se 56 vjeç kishin një përqindje më të lartë të personave që ishin kryesisht ose plotësisht dakord me këtë deklaratë sesa grupmoshat e tjera. Ata të moshës 18-25 vjeç kishin përqindjen më të lartë të përgjigjeve asnjëherë, ndërsa përqindja më e ulët që nuk ishte aspak dakord ose jo-dakord u evidentua tek grupmosha e 56-65 vjeçarëve, me nivelin më të lartë tek grupmosha 46-55 vjeç (Tabela 31).

**TABELA 31 NUMRI DHE PËRQINDJA E PËRGJIGJEVE POZITIVE DHE NEGATIVE PËR DEKLARATËN UNË FAJËSOJ NJERËZIT E FEVE TË TJERA PËR KORRUPTIMIN E VLERAVE TË SHOQËRISË SONË, SIPAS GRUPMOSHAVE**

			Grupmosha (vjeç)						Gjithsej
			18–25	26–35	36–45	46–55	56–65	>65	
Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për korruptimin e vlerave të shoqërisë sonë	aspak dakord ose kryesisht jo-dakord	numri	199	251	163	153	104	74	944
		%	85.8	85.7	88.1	90.0	83.2	88.1	86.7
	Asnjë	numri	23	20	17	9	5	5	79
		%	9.9	6.8	9.2	5.3	4.0	6.0	7.3
	kryesisht dakord ose plotësisht dakord	numri	10	22	5	8	16	5	66
		%	4.3	7.5	2.7	4.7	12.8	6.0	6.1
<b>Gjithsej</b>		<b>numri</b>	<b>232</b>	<b>293</b>	<b>185</b>	<b>170</b>	<b>125</b>	<b>84</b>	<b>1,089</b>
		<b>%</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>

Në pjesën e fundit të sondazhit, të anketuarve iu kërkua të përshkruanin shembuj të tolerancës fetare në komunitetin e tyre dhe përvojën e tyre personale me tolerancën fetare.

Nga totali prej 1,100 pjesëmarrësish në sondazh, 773 dhanë shembuj të tolerancës fetare në komunitetin e tyre, shumica (690) prej të cilave iu referua martesave të përziera fetare, kremtimit të festave fetare të grupeve të tjera fetare dhe bashkëjetesës dhe tolerancës mes qytetarëve. Njëzet e tre të intervistuar iu referuan mungesës së diskriminimit në institucionet shtetërore dhe sekularizmit ose marrëdhënieve ndërmjet institucioneve të ndryshme fetare. Një grup tjetër prej 55 të anketuarish deklaruan se jetojnë në komunitete fetare homogjene dhe nuk kishin pasur shembuj të tillë, ndërsa pesë të anketuar deklaruan “Nuk ka tolerancë fetare në Shqipëri”.

Kur u pyetën për përvojat personale me tolerancën fetare, 578 të anketuar iu përgjigjën situatave të raportuara në Tabelën 32, në të cilën jepet edhe numri i përgjigjeve ndaj këtyre situatave.

**TABELA 32 NUMRI I PËRGJIGJEVE PËR SITUATAT E NDRYSHME QË KANË PËRJETUAR TË INTERVISTUARIT**

Përvoja personale me tolerancën fetare	Nr. i të intervistuarve
Individë të grupeve të tjera fetare janë pjesë e rrethit time shoqëror (në punë, shkollë, lagje)	264
Martesa apo lidhje krushtiqe me individë të besimeve të tjera fetare	196
Kremtimi i festave fetare të grupeve të tjera fetare (me familje apo shokë)	100
Feja nuk është përcaktor / e rëndësishme / i respektoj të gjitha fetë njësoj	9
T'i vësh fëmijëve emra të feve të tjera	3
Ndryshova fe dhe nuk kam pasur pasoja negative	1
Nuk kemi pasur kurrë konflikte pavarësisht besimeve të ndryshme fetare	1
Nuk kemi diskriminuar asnjë në bazë të përkatësisë fetare	1
Ndonjëherë njerëzit janë më pak të hapur kur flas për fenë time dhe ndonjëherë duan të dinë më shumë. Kjo e fundit është tolerancë.	1
Unë, duke jetuar në një komunitet me shumicë katolike	1
Familja ime dhe besimi im fetar	1



# VI. DISKUTIMET NË FOKUS GRUPE PËR GJETJET E SONDAZHIT

RAPORTI U PËRGATIT NGA ALEKA PAPA

PËR t'iu përgjigjur nevojave për një analizë të mëtejshme të të dhënave të sondazhit publik dhe për t'i kuptuar më mirë ato, në fund të gushtit dhe fillimit të shtatorit 2017 u organizuan gjithsej gjashtë diskutime në fokus grupe me qytetarë të zakonshëm nga kategori të caktuara demografike. (Lutemi referojuni metodologjisë për më shumë hollësi për kampionin dhe përbërjen demografike të fokus grupeve.) Më poshtë jepet një përshkrimi i zgjeruar i gjetjeve kryesore të diskutimeve në fokus grupe, të organizuara sipas çështjeve tematike që u shtjelluan në to.

## A. Individit dhe e shenjta

Në këtë pjesë u shqyrtuan qëndrimet e pjesëmarrësve të fokus grupeve ndaj vlerave fetare dhe morale dhe si ndikojnë ato në jetën e tyre. Pjesëmarrësit u pyetën në lidhje me nivelin e tyre të besimit dhe nivelin e perceptuar të besimit nga anëtarë të familjes dhe rrethi i tyre i ngushtë, ndërveprimi dhe ndikimi i tyre në vlerat e tyre morale dhe etike. Demografia e larmishme e pjesëmarrësve të fokus grupit dhe qasjet e tyre të ndryshme ndaj fesë (besimtarë dhe jo-besimtarë) ndihmojnë të analizohen dhe kuptohen më mirë gjetjet e seksionit "Individi dhe Hyjnorja/e shenjta".

### PËR JO-BESIMTARËT: SHPIRTËRORJA E INDIVIDËVE ME KUJTIME TË SË SHKUARËS KOMUNISTE KRAHASUAR ME ATË TË TË RINJVE ME MË SHUMË INTERES NË FE

Tek të gjitha diskutimet në fokus grupe, kur u pyetën për "Individin dhe Hyjnore/të shenjtën", pjesëmarrësit që kishin kujtime të së shkuarës komuniste dhe që ishin besimtarë jo-praktikantë (pa marrë parasysh gjininë, vendbanimin ose fenë e familjes) treguan se ishin më shumë të lidhur me shpirtëroren se sa me një Zot të caktuar. Ndër vërejtje më tipike ishin "Unë besoj se ka një Zot për të gjithë, të krishterë ose myslimanë [duke iu referuar fesë së familjes së tyre]" dhe "Ne të gjithë kemi të njëjtin Zot". Një grua që jeton në fshat tha "Unë kam edhe Kuranin edhe Biblën në shtëpi. Ndihej e lehtësuar kur shkoj në kishë dhe ndez një qiri, edhe pse jam myslimane." Për këtë grup njerëzish, morali nuk mund të barazohet me fenë; të bësh një jetë morale dhe etike lidhet në fund të fundit me karakterin e një personi (pavarësisht udhëzimeve fetare).





**“Të krishtere apo myslimanë, të gjithë kemi të njëjtin Zot.”**

*Pjesëmarrës i DFG (grua, rreth të 50, banore e zonave rurale)*

Duke pasur parasysh këtë kuadër, pjesëmarrësit e rinj në moshë<sup>12</sup> duket se kishin një lidhje shpirtërore më të larmishme apo fluide, duke pohuar se kishin ndërruar fe ose të paktën qenë të ekspozuar ndaj më shumë se një feje gjatë jetës së tyre. Një i ri, një ish mysliman praktikues (tani thjesht një besimtar jo-praktikant), vuri në dukje se “mund ta ndryshoj fenë që kam tani që të nesërmen”. Sidoqoftë, edhe për këtë grup, morali ekziston pavarësisht nga feja. Çuditërisht, edhe për besimtarët praktikantë, feja mund të luajë një rol mbështetës duke përforcuar natyrën njerëzore drejt një jete morale ose etike. Por baza e fundit qëndron në karakterin e vetë personit.



**“Kur isha fëmijë isha mysliman. Më vonë u bëra protestant. Tani nuk besoj në ndonjë fe të veçantë”**

*Pjesëmarrës i DFG (i ri, banor i zonave urbane)*

Këto gjetje nga fokus grupet konfirmojnë gjetjet e sondazhit. Për shembull, të dhënat e sondazhit treguan se afro 70 për qind<sup>13</sup> e të anketuarve pranonin se nuk kishte shumë rëndësi se çfarë besonin për sa kohë që ata bënin një jetë me moral. Çuditërisht, kjo gjetje vllente edhe për besimtarët praktikantë; pjesa më e madhe e besimtarëve fetarë që deklaruan se luteshin/faleshin rregullisht ose me rastet e festave fetare besonin gjithashtu se morali ekzistonte edhe jashtë fesë, gjetje e vërtetuar edhe nga diskutimet në fokus grupe.

#### **Për besimtarët praktikantë: Ekzistojnë dallime në çështje të besimit mes brezave**

Nga diskutimet në fokus grupe, mes prindërve praktikantë dhe jo-praktikantë dolën në pah dallime në stilin e prindërimit në lidhje me ndikimin tek besimi fetar i fëmijëve. Për shembull, kur prindërit ishin praktikantë të një feje të caktuar, ata tentonin të transmetonin fenë tek fëmijët e tyre dhe e konsideronin si problem apo sfidë faktin nëse fëmijët e tyre nuk do të praktikonin atë fe.

12. 18–35 vjeç

13. Përqindjet janë rumbullakosur. Lutemi referojuni pjesës së Sondazhit Publik për më shumë hollësi për të dhënat e sondazhit të cituara në këtë pjesë të raportit

Një grua myslimane që jetonte në një zonë rurale tregonte një histori ku kishte marrë fëmijën e saj në xhami që nga klasa e parë dhe tani që fëmija është 18 vjeç dhe mysliman praktikant, ajo ndihej shumë krenare dhe madje “e sigurt si prind”. Nga ana tjetër, disa të rinj nga familje besimtare në zonat rurale flisnin për udhëzimet që merrnin nga prindërit e tyre dhe dekurajimin për t’u shoqëruar me shokë që kishin përkatësi të tjera fetare. Në një rast, një i ri tregoi një histori ku prindërit e tij e dëgjuan duke folur për Kryqin e Kuq (teksta po merrte mësim për drejtimin e automjetit) dhe menjëherë i kapi paniku dhe e pyetën nëse ishte përfshirë ose shoqëruar me ndonjë të krishterë.

**“Po të kisha dëgjuar familjen, nuk do i flisja asnjë personi me përkatësi tjetër fetare.”**



*Pjesëmarrës i DFG (i ri, mysliman praktikant, banor i zonave rurale)*

Në krahun tjetër të spektrit, prindërit që vetë nuk ishin praktikantë prireshin t’i përshkruanin fëmijët e tyre si më fetarë dhe të ndikuar veçanërisht nga rrethi shoqëror për të praktikuar fenë. Po ashtu, prindërit jo-praktikantë që banonin në zonat urbane pranuan gjatë diskutimeve se nuk do të preferonin që fëmijët e tyre të bëheshin besimtarë praktikantë. Një prind vajti aq larg sa e quajti besimin fetar si verbëri. Ai theksoi se nëse djali i tij mernte kohë nga puna dhe shkonte për t’u falur... do ta quaja verbim fetar. Ata e konsideronin praktikimin e fesë si ndërhyrje e mundshme në jetën e tyre të përditshme apo reduktim të mundësive për punë.

**“Vajza ime donte të vinte burkë (perçe), por nuk e lashë unë.”**



*Pjesëmarrës i DFG (grua, e punësuar, jo-praktikante, banore e zonave urbane)*

Një grua që jeton në një zonë rurale, e ve me pesë fëmijë (përfshirë këtu edhe të miturit), pohoi se kushtet e vështira ekonomike të familjes i kanë orientuar fëmijët e saj drejt fesë, pavarësisht faktit se ajo vetë nuk ishte person fetar. Duke pasur parasysh kushtet e saj të pafavorshme ekonomike dhe ndihmën e pamjaftueshme shtetërore, një shoqe i rekomandoi të kontaktonte dhe të kërkonte ndihmë nga një fondacion arab, ku tani merr ushqime dhe veshje çdo tre muaj, ndërsa fëmijët e saj marrin mësim të gjuhës arabe dhe kanë tashmë orientim fetar.

**“Shteti nuk më siguron ushqime dhe strehë; kurse ato [duke iu referuar fondacioneve fetare] po.”**



*Pjesëmarrës i DFG (grua, jo-praktikante, banor i zonave rurale)*

## B. Perceptime për tolerancën fetare

Në këtë pjesë u shtjelluan perceptimet e pjesëmarrësve të fokus grupeve për tolerancën fetare në Shqipëri, rreziqet dhe faktorët mundësues si dhe qëndrimet në nivel vendor dhe ato të shoqërisë ndaj bashkëjetesës fetare. Pjesëmarrësve iu kërkua të përkufizonin tolerancën fetare dhe të rendisnin faktorët themelorë që kishin ndikuar në harmoninë fetare në Shqipëri si dhe faktorët e mundshëm të rrezikut, nëse ka.

### **Çfarë ka në Shqipëri: tolerancë, bashkëjetesë, harmoni apo indiferencë fetare?**

Tek të gjitha diskutimet në fokus grupe, pjesëmarrësit me karakteristika të ndryshme demografike bazoheshin në koncepte të ndryshme për të përmbledhur apo portretizuar atë që karakterizon Shqipërinë për sa i përket fesë. Për shembull, për disa pjesëmarrës koncepti i tolerancës nuk përmblihte kuptimin e vërtetë të fenomenit, duke qenë se tolerancë do të thotë të tolerosh opinione apo sjellje, të cilat nuk të pëlqejnë ose me të cilat nuk je dakord. Për ta, do të ishte më mirë të portretizohej si harmoni fetare. Po ashtu, disa pjesëmarrës nuk bënë dot dallimin midis koncepteve të bashkëjetesës dhe tolerancës. Për ta, bashkëjetesa dhe toleranca ishin e njëjta gjë.



**“Shqipëria është mëmëdheu i tolerancës fetare”**

*Pjesëmarrës i DFG (mashkull, i punësuar, besimtar ortodoks, banor i zonave urbane)*

Pavarësisht argumenteve për përkufizimin e fenomenit nga pikëpamja konceptuale, shumica e pjesëmarrësve do të pranonin fillimisht se harmonia fetare në një farë mënyre ishte një tipar i shoqërisë shqiptare. Megjithatë, pjesëmarrësit nga zonat rurale vunë re se ka shumë punë për të bërë në drejtim të arritjes së harmonisë fetare në krahasim me atë që etiketohet zakonisht. Këto gjetje u vërtetuan edhe nga të dhënat e sondazhit, të cilat nxjerrin në pah se të anketuarit priren të kenë një mendim më shpresëdhënës të harmonisë fetare në shoqërinë shqiptare në nivelin makro në krahasim me mjedisin e tyre të ngushtë: më pak se 15 për qind e të anketuarve të këtij sondazhi e karakterizonin shoqërinë shqiptare si pranuese e plotë e besimeve fetare të të tjerëve, ndërkohë që një përqindje edhe më e vogël (9%) e mendonin këtë për komunitetin ku jetonin. Pjesëmarrësit besimtarë, nga ana tjetër, e përkufizonin tolerancën fetare si lirinë për të përmbushur detyrimet fetare, të cilat ata i perceptojnë të mos jenë plotësisht të garantuara (sidomos në lidhje me besimtarët myslimanë).

Gjithsesi, disa të rinj pjesëmarrës mendonin se për rastin e Shqipërisë, kjo nuk duhet të kornizohej si tolerancë apo harmoni fetare, por më tepër si “mosnjohje e feve të ndryshme” apo si “analfabetizëm fetar”. Ky argument pritet të përkojë edhe me të dhënat e sondazhit, të cilat nxorën në pah se rreth 7 nga 10 të anketuar besonin se mungesa e informacion për fetë e tjera i bën njerëzit më tolerantë.

### **TOLERANCA FETARE ËSHTË MË E FORTË TEK KOMUNITETET E PËRZIERA FETARE**

Në të gjitha diskutimet në fokus grupe, pjesëmarrësit pranuan se perceptimi i tolerancës fetare ishte padyshim më i fortë në komunitetet e përziera fetare, duke pasur parasysh trashëgiminë e bashkëjetesës dhe shoqërimin së bashku. Kjo konfirmohet edhe nga gjetjet e sondazhit publik, i cili tregon se rreth 80 për qind e të anketuarve besonin se toleranca fetare ishte më e fortë në komunitetet e përziera fetare.

Më pas, pjesëmarrësit në fokus grupe u pyetën dhe iu kërkua të shtjellonin faktorët kryesorë që kanë mundësuar dhe vazhdojnë të mundësojnë tolerancën fetare në Shqipëri. Më poshtë diskutohen motivet që u cituan më shpesh nga pjesëmarrësit.

### **NDJENJAT KOMBËTARE PERCEPTOHEN SI MUNDËSUESI KRYESOR I HARMONISË FETARE TEK JO-BESIMTARËT**

Shumë pjesëmarrës të rinj në moshë mendonin se kombësia e përbashkët ishte faktori kryesor që mundësonte tolerancën fetare në Shqipëri. Një pjesëmarrës me shpejtësi pranoi se gjatë gjithë historisë shqiptarët nuk e kanë lidhur kombin me asnjë fe të caktuar dhe se kjo ka sjellë harmoninë fetare në vend. Pjesëmarrës të tjerë e lidhën këtë dukuri përsëri në trashëgiminë historike të Shqipërisë, duke e krahasuar këtë, për shembull, me rastin e disa vendeve fqinje ku feja ortodokse u bë sinonim me përkatësinë kombëtare përkatëse. Për më tepër, kjo gjetje përkon edhe me të dhënat e sondazhit që tregon se rreth 83 për qind e të anketuarve ishin dakord se ndjenjat kombëtare ushqejnë tolerancën fetare, ndërsa 80 për qind e perceptojnë se kombësia e njëjtë është ajo që mundëson tolerancën fetare në Shqipëri.



*“Ne nuk kemi asnjë fe kombëtare.”*

*Pjesëmarrës i DFG (mashkull, besimtar i krishterë, banor i zonave urbane)*

Po ashtu, disa pjesëmarrës që kanë jetuar në të kaluarën komuniste të vendit shpesh përmendnin idenë e nacionalistëve shqiptarë të shekullit të 19-të “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, ndaj dhe diskutimi i tyre u përqendrua kryesisht në vërtetësinë e kësaj thënieje për rastin e Shqipërisë dhe pasojat e saj mbi tolerancën fetare në vend. Pjesëmarrës të tjerë u prirën të mbështesin mendimin se trashëgimia komuniste e ateizmit nuk perceptohet si faktor që nxit tolerancën fetare, por më tepër si një rrethanë në historinë shqiptare që keqinterpretoi thënien e rilindësve shqiptarë.

### **ROLI I SEKULARIZMIT TEK TOLERANCA FETARE SIPAS BESIMTARËVE DHE JOBESIMTARËVE**

Tek diskutimet në fokus grupe, pjesëmarrësit jobesimtarë në përgjithësi pranonin rolin pozitiv që ka luajtur sekularizmi në forcimin e tolerancës fetare në vend, duke mbështetur në këtë mënyrë të dhënat e sondazhit që tregonin se 83% e të anketuarve mendonin se sekularizmi kishte forcuar tolerancën fetare. Megjithatë, disa besimtarë praktikantë vunë në dyshim faktin nëse Shqipëria ishte vërtet shtet laik: “Shteti ka abuzuar vazhdimisht me sekularizmin, për interesat e veta.”

## HENDEKU NË PERCEPTIMET PËR ROLIN E DREJTUESVE TË KOMUNITETEVE FETARE

### PËRKUNDËR ROLIT TË KLERIKËVE VENDORË FETARË

Pothuajse në të gjitha diskutimet në fokus grupe, përfshirë edhe grupet me besimtarë dhe jobesimtarë, pranohej se drejtuesit e komuniteteve fetare (në nivel kombëtar) kishin luajtur një rol të rëndësishëm në mundësimin dhe nxitjen e tolerancës fetare në vend.

*“Drejtuesit e komuniteteve fetare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në drejtim të tolerancës fetare në Shqipëri”*



*Pjesëmarrës i DFG (mashkull, besimtar, banor i zonave urbane)*

Gjithsesi, për sa i përket ndikimit dhe rolit të klerikëve fetarë vendorë ka pasur një mospërputhje në perceptimet e besimtarëve dhe jobesimtarëve. Për shembull, jo-besimtarët (veçanërisht ata që banojnë në zonat rurale) zakonisht i perceptojnë klerikët vendorë si të besueshëm dhe që promovojnë tolerancën, ndryshe nga pjesëmarrësit jo-fetarë që herë pas here shfaqeshin të pasigurt në lidhje me aktivitetin dhe rolin e tyre në komunitet. Disa thanë se individë pa arsim të përshtatshëm fetar tentonin të impononin ideologjinë e tyre në xhamitë në zonat e tyre. Sidoqoftë, kjo perceptim u krijua kryesisht nga raportimet në media dhe jo nga informacione të drejtpërdrejta nga komuniteti mysliman.

Për sa i përket besimtarëve praktikantë, pjesëmarrësit nga komuniteti mysliman treguan më shumë afritet me klerikët e tyre në krahasim me pjesëmarrësit nga komunitetet e krishtera. Nga të dhënat agregate të sondazhit, rreth 81% e të anketuarve pranonin se drejtuesit e komuniteteve fetare luajnë në rol të rëndësishëm në rritjen e tolerancës fetare krahasuar me 74% që mendonin se ky rol u përkiste klerikëve fetarë të nivelit vendor.

### TRASHËGIMIA KOMUNISTE DHE ROLI I SAJ NË TOLERANCËN FETARE

Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e diskutimeve në fokus grupe pranuan, edhe pse në nivele të ndryshme, rolin e trashëgimisë komuniste në këtë drejtim. Disa nga kanalet më të cituara ishin rënia e besimit fetar tek popullsia si rezultat i ateizmit të detyruar dhe nxitja e bashkëjetesës për shkak të kushteve të dobëta ekonomike, duke e bërë përkatësinë fetare të parëndësishme. Për shembull, individë që kanë jetuar në të kaluarën komuniste e identifikuan rritjen e tyre (pasi në shumicën e rasteve ata u rritën kryesisht në familje jofetare dhe më së shumti kishin kremtuar festat fetare fshehurazi) si një faktor për mungesën e besimit fetar, gjë që në fund kishte ushqyer tolerancën fetare. Megjithatë, të rinjtë - pa kujtesë ose përvojë të drejtpërdrejtë të së kaluarës komuniste - nuk ishin shumë të sigurt për rolin specifik të trashëgimisë komuniste në këtë drejtim. Edhe të dhënat e sondazhit evidentuan se të rinjtë prireshin të binin dakord në një numër më të vogël se të tjerët për rolin e periudhës komuniste në tolerancën fetare që kemi sot.

**NIVELI I FETARISË DHE TOLERANCA E PERCEPTUAR FETARE: E BASHKËLIDHUR  
POZITIVISHT PËR BESIMTARËT PRAKTIKANTË POR ME LIDHJE TË PAQARTË PËR  
BESIMTARËT JO-PRAKTIKANTË**

Pjesëmarrësit jo-praktikantë ishin në përgjithësi të mendimit se “Nëse do të kishte më shumë besimtarë praktikantë në Shqipëri, vendi nuk do të kishte këtë nivel tolerancë”, duke ia atribuuar indiferencën fetare tolerancës fetare. Kjo vijë logjike pritet të mbështetet edhe nga të dhënat e sondazhit, ku rreth 76 për qind e të anketuarve e ulën stekën e tolerancës fetare në Shqipëri tek mendimi se shqiptarët nuk janë shumë fetarë.

*“Nëse do të kishte më shumë besimtarë praktikantë në Shqipëri, vendi nuk do të kishte këtë nivel tolerancë”*



*Pjesëmarrës i DFG (femër, shtëpiake, banore i zonave urbane)*

Përkundër kësaj pikëpamjeje të jopraktikantëve, diskutimi i besimtarëve praktikantë myslimanë dhe të krishterë erdhi rrotull logjikës se besimi fetar dhe toleranca kanë, në fakt, një bashkëlidhje pozitive: se individët fetarë janë më tolerantë me besimin fetar të njerëzve të tjerë.

*“Nëse nuk respekton fenë e njerëzve të tjerë, atëherë nuk njeh fenë tënde.”*



*Pjesëmarrës i DFG (grua, e punësuar, besimtare praktikante, banore e zonave urbane)*

**PËR BESIMTARËT PRAKTIKANTË, TOLERANCA ËSHTË THELBËSORE PËR FENË E TYRE**

Tek diskutimet në fokus grupe, besimtarët praktikantë e mendonin fenë e tyre si nxitësin kryesor të harmonisë fetare në vend. Megjithatë, ata pohuan se e pranojnë besimin e njëri-tjetrit, pavarësisht se të gjithë duan që të tjerët të konvertohen në fenë e tyre. Për shembull, pothuajse të gjithë myslimanët praktikantë i atribuonin tolerancën fetare në Shqipëri si të ardhur nga komuniteti mysliman, sepse për ta është “shumica ajo që dikton rregullat”. Në përputhje me këtë pikëpamje, edhe besimtarët praktikantë të krishterë mendonin se ata vetë “janë shumë tolerantë”.

**PJESËMARRËSIT E FOKUS GRUPEVE U PYETËN EDHE PËR KËRCËNIMET E MUNDSHME QË MUND TË VËNË NË RREZIK TOLERANCËN FETARE NË SHQIPËRI.**

Kërcënimet e mundshme ndaj tolerancës fetare variojnë nga politika tek ekstremizmi i dhunshëm. Megjithatë, ato mendohet se janë të pakonsiderueshme.

Së pari, tek të gjitha diskutimet në fokus grupe, pjesëmarrësit duket se ishin përgjithësisht optimistë për aftësinë e ringritjes së tolerancës fetare në Shqipëri dhe i konsideronin rreziqet ndaj tolerancës si të largëta. Gjithsesi, disa nga kërcënimet të përmendura më shpesh ndaj tolerancës fetare përmbledhen si më poshtë.

Të perceptuar si një nga motivet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, kushtet e dobëta ekonomike u identifikuan tek të gjitha fokus grupet si një kërcënim i mundshëm për tolerancën fetare. Kjo konfirmohet edhe nga gjetjet e sondazhit, ku shumica e të anketuarve e kanë vënë ekstremizmin fetar si një nga kërcënimet kryesore të tolerancës fetare. U dhanë shembuj të individëve me ekonomi të dobët, përfshirë këtu edhe të mitur, që rekrutoheshin në një fe të caktuar nëpërmjet stimujve monetarë. "Sigurisht që kjo do të ndodhë; se për ta nuk ka punë ku të fitojnë të ardhura" ishte një përgjigje nga një banor i zonës urbane. Ky rekrutim në fe u perceptua përgjithësisht si pararendës i radikalizimit.

Për sa i përket çështjes së radikalizimit dhe ekstremizmit fetar, besimtarët myslimanë dukej se ishin shqetësuar me veprimtarinë e ISIS-it në vende të ndryshme të botës, gjë që dëmtonte shumë imazhin e myslimanit të zakonshëm. Një grua nga një zonë rurale dha shembullin e njërit prej të njohurve të saj, i cilët gjatë një udhëtimi me autobus, u ofendua me fjalë nga një i krishterë (që kishte të varur në qafë një kryq) i cili bërtiti në drejtimin e tij. Këta myslimanët ... vrasin edhe vëllezërit e tyre ...

***"Urrejtja nuk është problem i fesë [nuk shkaktohet nga feja]; përkundrazi është problem i individëve"***



*Pjesëmarrës i DFG (mashkull, i punësuar, besimtar praktikant, banor i zonave urbane)*

Tek grupet e besimtarëve praktikantë, roli i politikës dhe i politikanëve dhe axhenda e tyre e fshehtë u identifikuan si kërcënim i mundshëm ndaj tolerancës fetare. Pjesëmarrësit nga fokus grupi i besimtarëve praktikantë të krishterë theksuan rëndësinë e ruajtjes së ekuilibrit në marrëdhëniet e shtetit me të gjitha fetë në vend për sa i përket paprekshmërisë së ndërtesave fetare ose ndryshe do të kishte fërkime dhe intolerancë. Besimtarët praktikantë të krishterë duket se ishin më të kujdesshëm në këtë çështje, duke pasur parasysh rastet në këto vitet e fundit ku autoritetet shtetërore dhe komuniteti fetar ortodoks u vunë në qendër të debatit publik pas prishjes në vitin 2015 të Kishës Ortodokse Greke të Shën Thanasit përkundër kundërshtive të ashpra të të krishterëve ortodoksë.

Nga diskutimet me besimtarët praktikantë doli se bashkësitë fetare nuk ishin dakord me qëndrimin e qeverisë lidhur me çështjen e tejzgjatur të kthimit të pronave të komuniteteve fetare në vend. Besimtarët myslimanë shprehën shqetësimin se Komunitetit Mysliman të Shqipërisë nuk i ishin kthyer ende pronat. Megjithatë, pjesëmarrësit e krishterë ishin të mendimit se shteti mbante një qëndrim më pozitiv ndaj pronave të bashkësisë myslimane.

Për më tepër, pjesëmarrësit në fokus grupet e besimtarëve praktikantë ishin të mendimit se nuk ka asnjë përfaqësim politik të përshtatshëm të komuniteteve fetare në Shqipëri dhe nëse ata do ta kishin këtë përfaqësim, politika në Shqipëri do të ishte më e mirë. Kjo gjë u theksua si problem nga komuniteti katolik dhe ai mysliman, në kontrast me komunitetin ortodoks. Si shembull u soll diskutimi për ndryshimet ligjore në Kodin e Familjes, për të cilat komunitetet fetare nuk u ftuan për të marrë pjesë pavarësisht pikëpamjeve të tyre për këtë çështje të rëndësishme.

*“Nëse nga komunitetet fetare do të kishte përfaqësim politik, politika në Shqipëri do të ishte më e mirë.”*



*Pjesëmarrës i DFG (mashkull, i punësuar, besimtar praktikant i krishterë, banor i zonave urbane)*

Pjesëmarrësit nga komuniteti i besimtarëve praktikantë myslimanë evidentuan rolin negativ të mediave në raportimin për këtë çështje. Sipas mendimit të tyre, mediat kishin tendencën të shfaqnin lajme kryesore të zhveshura nga çdo ndjeshmëri fetare, ndërkohë që bashkësitë myslimane ia atribuon në mënyrë introspektive mungesën e perceptuar të organizimit të mirë apo koheziv të komunitetit shtrembërimeve të mesazheve të transmetuara për publikun dhe që në fund u kthye në kërcënim për tolerancën.

*“ Një kërcënim i mundshëm vjen nga vetë ne ... nga që nuk jemi të mirë-organizuar”*



*Pjesëmarrës i DFG (mashkull, i punësuar, besimtar praktikant, banor i zonave urbane)*

Në përgjithësi, pjesëmarrësit ranë dakord që, kur besimtarët praktikantë nuk e kuptojnë siç duhet fenë, kjo nxit intolerancën.

## C. Qëndrimet dhe eksperiencat me tolerancën fetare

Në pjesën e fundit të pyetësorit u shtjelluan përvojat praktike dhe personale me tolerancën fetare si dhe qëndrimet dhe perceptimet e besimtarëve praktikantë me grupet e tjera fetare. Pjesëmarrësve iu kërkua të jepnin përvojat e tyre personale me tolerancën fetare ose shembuj nga pjesëtarë të familjes apo rrethit të tyre të ngushtë, përfshirë këtu qëndrimin e tyre për martesat ndërfitare dhe përvojat personale apo ballafaqimi me paragjykimin ose diskriminimin me bazë fetare.

### **SIPAS JO-PRAKTIKANTËVE, A KUFIZOHET TOLERANCA VETËM TEK URIMET DHE FESTIMET SË BASHKU TË FESTAVE FETARE?**

Kur iu kërkua të përkthenin nivelin e perceptuar të tolerancës në Shqipëri me shembuj nga jeta e përditshme, shembujt tipikë të ngritur nga individët që kishin përvojë me të kaluarën komuniste ishin shkëmbimi i urimeve dhe vizitave gjatë festave fetare. Shembujt e martesave të përziera u përmendën shpesh, ku disa pjesëmarrës ishin vetë pjesë e krushqive mes familjeve me përkatësi të ndryshme fetare.

*“Jam komshi me një grek; gjithmonë më merr në telefon për të më uruar ‘Gëzuar Bajramin’...kjo është harmoni fetare”*



*Pjesëmarrës i DFG (mashkull, i punësuar, jo-praktikant, banor i zonave urbane)*



Një pjesëmarrëse nga fokus grupi i grave përmendi familjen e saj si shembull i tolerancës fetare: vajza e saj shkon rregullisht në kishë, kurse djali është besimtar i devotshëm mysliman. Një e re dha shembullin e tolerancës fetare kur shoqe të saj me përkatësi tjetër fetare e shoqëronin gjatë kohës së faljes në universitet.

*“Në shtëpi kam harmoni fetare; vajza shkon në kishë, kurse djali është besimtar i devotshëm mysliman.”*



*Pjesëmarrës i DFG (femër, e punësuar, jo-praktikante, banore e zonave urbane)*

Megjithatë, kur u pyetën për socializimin e tyre ose për marrëdhëniet me besimtarë praktikantë në shërbimin civil apo në institucionet arsimore, pjesëmarrësit kundërshtojnë veten në lidhje me nivelin e tolerancës që do të tregonin. Për shembull, kur shoqëroheshin me besimtarë praktikantë, pjesëmarrësit jofetarë i konsideronin si tepër imponues në përçimin e fjalës së Perëndisë dhe i konsideronin si jotolerantë ndaj jo-praktikantëve dhe stilit të tyre të jetesës. Pjesëmarrësit e grupeve të përziera nuk do të tregoheshin tolerantë nëse femra besimtare praktikante myslimane do të jepnin mësim në shkollën e lagjes ose do t'u shërbente atyre në administratën publike vendore. Po ashtu, të dhënat e sondazhit treguan se vetëm rreth 9 për qind e të anketuarve besonin se përfaqësimi i bashkësive fetare në administratën shtetërore është me rëndësi për tolerancën fetare në vend. Për më tepër, pjesëmarrësit ishin të mendimit se kur të diskutoheshin për tolerancën, kjo gjë duhej të lidhej vetëm me pjesën besimtare praktikante të popullsisë.

*“Nëse mësuesja do të shkonte e mbuluar me burkë në klasë, fëmijët do të tmerroheshin.”*



*Pjesëmarrës i DFG (femër, e punësuar, jo-praktikante, banore e zonave urbane)*

Duke pasur parasysh se sondazhi konstaton se popullsia në përgjithësi prirret të ketë nivel të ulët informacioni ose mungesë njohurish për fetë, pjesëmarrësit e fokus grupeve u pyetën nëse ata e konsideronin si të nevojshme mundësinë e përfshirjes së edukimit fetar në programin shkollor. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e grupeve të fokusit ranë dakord që arsimimi i përgjithshëm fetar ishte i rëndësishëm, edhe pse kishin dyshime për mënyrën se si mund të zbatoheshin kjo gjë, duke përfshirë edhe çështjet se cilët mësues dhe me çfarë përkatësie fetare do të ishin përgjegjës për mësimin e lëndës. Besimtarët praktikantë të krishterë ortodoksë ishte më ngurrues për këtë çështje, duke e konsideruar atë si shkoputje nga besimi. Kështu, mes besimtarëve është ende e paqartë se si do të zbatoheshin një projekt i tillë pilot. Besimtarët praktikantë mendojnë se drejtuesit e të gjitha bashkësive fetare në Shqipëri duhet të konsultohen në lidhje me programin mësimor, në mënyrë që të ruajnë një ekuilibër të informacionit dhe për arsye transparence. Një mësues që është besimtar praktikant i një feje mund ta ketë të vështirë të jetë objektiv gjatë mësimdhënies.

## **GJASAT PËR TË PRANUAR SI KRUSHK NJË PERSON TË NJË FEJE TJETËR VARET NGA NIVELI I BESIMIT TË ATIJ PERSONI**

Edhe pse pjesëmarrësit në fokus grupin e të rinjve nuk e konsideronin përkatësinë fetare të një personi si faktor përcaktues të mundësisë për shoqëri apo bashkëshort, disa të rinj deklaruan se prindërit e tyre ishin përgjithësisht kundër martesave të përziera apo ndërfitare (pavarësisht se sa e ushtrojnë besimin e tyre fetar). Ky konstatim përkon me gjetjet e sondazhit, ku 83 për qind e të anketuarve thanë se kishte gjasa që ata të pranonin besimtarë të feve të tjera si shok të ngushtë, por kjo përqindje ulej në 66 për qind kur bëhej fjalë për krushqi.

*“Gjëja e fundit që vë re tek një njeri është bindja e tij fetare”*



*Pjesëmarrës i DFG (i ri, i punësuar, banor i zonave urbane)*

*“Një nga shoqet e mia vishet e mbuluar dhe unë as që e kam problem këtë gjë.”*



*Pjesëmarrës i DFG (femër, i punësuar, jo-praktikant, banor i zonave urbane)*

Për më tepër, në përputhje me shqetësimet e shprehura nga të rinjtë, kur kjo pyetje iu bë fokus grupit të përzier, prindërit e mbështetën këtë konstatim, duke thënë se nuk do ta dëshironin një gjë të tillë, por që do të ishin të detyruar ta pranonin. Gjithsesi, ata ishin kundër pranimit të besimtarëve në lidhje martesë dhe ishin edhe më të vendosur në rastin e femrave që ishin të mbuluara.

Të anketuarit që ishin pjesë e martesave të përziera ishin më tolerantë, edhe pse besimtarët praktikantë ishin të bindur në besimin e tyre kundër martesave të përziera.

*“Nuk do ta uroja për fëmijët e mi (martesën ndërfitare), por do ta pranoja nëse do të ndodhte”*



*Pjesëmarrës i DFG (mashkull, i punësuar, banor i zonave urbane)*

## VAJZAT DHE GRATË BESIMTARE PRAKTIKANTE TË FESË MYSLIMANE KISHIN MË SHUMË

### GJASA TË PËRJETONIN PARAGJYKIME DHE MË PAS DISKRIMINIM SESA FEMRAT

#### BESIMTARE TË FEVE TË TJERA

Duke pasur parasysh deklaratat e mësipërme për shembuj të diskriminimit, në shembujt më të përmendur ishin vajzat dhe gratë myslimane që veshin burkë, të cilat nga ana e tyre deklaruan se anashkaloheshin kur aplikonin për një vend pune ose pushoheshin nga puna, sepse nuk respektonin kodin e veshjes në punë, duke i çuar drejt grackës së përjashtimit. Femra të tilla përjashtoheshin nga rrethi i tyre shoqëror si rezultat i ndryshimit të stilit të jetesës, dhe përjashtoheshin edhe nga tregu i punës duke shkaktuar kështu edhe më shumë përjashtim. Disa shembuj të tillë u raportuan edhe nga të intervistuarit e sondazhit.

*“Kur vura burkën, mbeta e papunë”*



*Pjesëmarrës i DFG (e re, e papunë, banore e zonave urbane)*

Një pjesëmarrëse besimtare praktikante myslimane kujton se krushqit refuzuan me këmbëngulje që ta pranonin si nuse kur morën vesh se djali i tyre do të martohej me një myslimane të mbuluar (edhe pse ata vetë ishin të besimit mysliman), ndonëse më vonë u detyruan ta pranonin.

# VII. PËRFUNDIME

Edhe pse gjatë dy dekadave të fundit, toleranca fetare është promovuar si tipar i rëndësishëm i traditës dhe mikpritjes shqiptare, janë bërë shumë pak përpjekje për të kuptuar këtë vlerë, themelet mbi të cilat mbështetet ajo, faktorët që e mbështesin, sfidat ndaj tolerancës fetare dhe masat që duhen marrë për ta ruajtur dhe avancuar atë. Ky studim ofron një shqyrtim bazë të tolerancës aktuale fetare në Shqipëri, perceptimet dhe përvojat e qytetarëve me këtë vlerë, faktorët e saj mundësues dhe tiparet kryesore, me qëllim nxitjen e veprimeve e analizave të mëtejshme dhe debatit publik mbi këtë tipar të rëndësishëm të kulturës shqiptare .

Studimi konstaton se toleranca fetare vlerësohet dhe mbështetet gjerësisht nga qytetarët shqiptarë. Megjithatë, qytetarët prirën ta vlerësojnë tolerancën fetare më shumë si një vlerë qytetare ose morale dhe traditë kombëtare sesa si një praktikë shoqërore që mbështetet në njohjen e feve të ndryshme dhe pranimin e dallimeve fetare.

Më shumë se gjysma e shqiptarëve kanë pak ose aspak njohuri për fetë e ndryshme në Shqipëri, me përjashtim të Islamit, rreth të cilës 36 për qind e të anketuarve deklaruan se kishin njohuri mesatare ose të gjera. Në fakt, një nivel i tillë i ulët i njohurive fetare u konsiderua si një faktor i mundshëm për tolerancën fetare nga një shumicë dërmuese e të anketuarve dhe pjesëmarrësve në diskutimet fokus grupe.

## **Besimi fetar i shqiptarëve dhe ndërgjegjja fetare**

Edhe pse 37 për qind e shqiptarëve e konsideronin veten si besimtarë praktikantë të rregullt të fesë dhe 28 për qind pretendonin se shokët dhe kolegët e tyre i identifikonin si besimtarë praktikantë të fesë, studimi konstatoi se përqindja e shqiptarëve që praktikojnë rregullisht fenë dhe udhëhiqen në jetën e tyre të përditshme nga normat dhe ritet fetare është shumë më e vogël.

Ndërkohë që të anketuarit nga zonat rurale prirën të jenë më tradicionalë për aspekte të caktuara të fesë dhe praktikave të tyre, pjesa më e madhe e shqiptarëve bëjnë një jetë jofetare, ku më pak se dhjetë për qind e përkrahajnë veten si njerëz që besojnë në Zot dhe praktikojnë të gjitha ritet fetare dhe më pak se 17 për qind praktikojnë pjesën më të madhe të riteve fetare. Rreth 13 për qind e shqiptarëve deklaruan se besimi i tyre ndonjëherë i kufizon veprimet e tyre.

Një nivel i tillë i ulët i ushtrimit të fesë tek shqiptarët është i mundshëm, sepse shumica e të anketuarve në këtë sondazh mendonin se praktikimi i fesë ka të bëjë me besimin tek Zoti sesa tek respektimi i riteve fetare. Rreth shtatë në dhjetë shqiptarë besojnë se ka shumë gjëra më

## Më shumë se 90 për qind e shqiptarëve e konsiderojnë tolerancën fetare si një vlerë themelore dhe konfirmojnë se shteti nuk ndërhyt në besimin fetar të individit.

të rëndësishme në jetë sesa feja dhe se nuk ka shumë rëndësi se çfarë besojnë, për aq kohë sa bëjnë një jetë të moralshme, duke konfirmuar prioritetin e vlerave qytetare dhe morale mbi fenë. Qëndrime të tilla janë të pranishme tek të anketuarit në këtë sondazh të cilët e përshkruanin veten si njerëz që praktikojnë fenë.

Nga ana tjetër, shqiptarët kanë tendencën të refuzojnë mendimet që mbështesin epërsinë e një besimi të veçantë, si: Vetëm një fe është e vërtetë; fetë e tjera janë false, ose Disa fe janë me afër të vërtetës se disa të tjera. Përkundrazi, ata mbështesin pikëpamje më liberale rreth fesë dhe piren të përqendrohen më shumë në elementët e përbashkët të feve të ndryshme, siç janë në thelb të gjitha fetë të mësojnë të njëjtat vlera të shenjta.

Megjithatë, ka pasur disa dallime statistike të rëndësishme në perceptimet dhe qëndrimet ndaj fesë dhe hyjnore mes të intervistuarve nga zonat urbane dhe atyre nga zonat rurale, nga grupmoshat e ndryshme dhe nga ata që praktikojnë fenë e nga ata që nuk besojnë. Ruajtja e tradicionales është deri diku e kuptueshme për brezat e vjetër, por edhe për të anketuarit nga zonat rurale, të cilët mbeten kompakt si komunitet, të paprekur nga emigracioni. Të anketuarit nga zonat rurale prireshin në përgjithësi të ishin më konservatorë rreth qëndrimeve të caktuara: p.sh. ata shprehën mbështetje më të madhe për deklarata të tilla si Zoti (Besimi) im është Zoti (Besimi) i vetëm i vërtetë dhe piren të mos pajtohen me deklarata të tilla si Praktikimi i fesë nuk ka të bëjë fare me ritualet, por më tepër me besimin në Zot. Ndërkohë, të intervistuarit e moshës mbi 45 vjeç priren të mbështesin deklarata të tilla si Lutja/Falja mund të jetë e vlefshme vetëm nëse i lutesh / falesh Emrit të duhur Hyjnor.

Të anketuarit nga zonat rurale kanë më shumë gjasa të praktikojnë të gjitha ose shumicën e riteve fetare. Praktikimi i riteve fetare ndryshonte mes atyre që luteshin/faleshin rregullisht dhe atyre që luteshin në festat fetare gjatë një viti normal. Vetëm gjysma e të anketuarve që thanë se luteshin/faleshin rregullisht - çdo ditë ose çdo javë - thanë se praktikonin rregullisht të gjitha ritet fetare.

Shumica e besimtarëve fetarë që falen/luten rregullisht ose që respektojnë festat fetare besojnë se Nuk ka shumë rëndësi se çfarë besoj, për aq kohë sa bëj një jetë të moralshme. Shumica dërrmuese (82.7%) e atyre që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare ishin kryesisht ose plotësisht dakord me deklaratën Lutja/Falja mund të jetë e vlefshme vetëm nëse i lutesh / falesh Emrit të duhur Hyjnor. Kjo përqindje ishte më e vogël tek grupet që i praktikojnë ritet fetare më pak ose aspak fare.

## Perceptimet e shqiptarëve për tolerancën fetare

Më shumë se 90 për qind e shqiptarëve e konsiderojnë tolerancën fetare si një vlerë themelore dhe konfirmojnë se shteti nuk ndërhy në besimin fetar të individit. Po ashtu, ata besojnë se ndjenjat kombëtare, sekularizmi dhe udhëheqësit e bashkësive fetare luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe forcimin e tolerancës fetare.

Ndonëse në një përqindje pak më të vogël, shumica e shqiptarëve i konsiderojnë kombësinë e njëjtë, mungesën e informacionit për fenë dhe mungesën e besimit fetar tek shqiptarët në përgjithësi si elementë që mundësojnë tolerancën fetare në Shqipëri. Në fakt, pesë faktorët kryesorë që mundësojnë tolerancën fetare në Shqipëri janë evidentuar të mëposhtmet:

- Indiferenca fetare ose mungesa e njohurive për fetë
- Kultura vendore (kombëtare) dhe dominimi i traditave kombëtare ndaj atyre fetare
- Respekti i ndërsjellë dhe respektim për liritë individuale
- Sekularizmi
- Ateizmi i trashëguar nga periudha komuniste

Gjithsesi, ka pasur dallime mes grupeve të ndryshme të të intervistuarve për sa i përket faktorëve që mundësojnë tolerancën fetare. Ata nga zonat urbane ishin më skeptikë në lidhje me rolin e sekularizmit apo supozimit se shqiptarët në përgjithësi nuk janë shumë fetarë. Nga ana tjetër, ata nga zonat rurale priren të mos jenë aspak dakord ose kryesisht jo-dakord më shumë sesa të intervistuarit nga zonat urbane me deklaratën se *Politikat komuniste kundrejt fesë (ndalimi i fesë) në periudhën 1967-1990 kanë kontribuar në tolerancën fetare në Shqipëri.*

Ky studim evidentoi se ekzistojnë dallime mes të intervistuarve që kishin jetuar në sistemin komunist dhe atyre që nuk kishin jetuar apo nuk kishin kujtime të ndalimit të fesë në atë periudhë për sa i përket perceptimeve për rolin e të shkuarës komuniste në tolerancën aktuale fetare. Shqiptarët e moshës mbi 45 vjeç, që përfaqësojnë ata që kanë përjetuar dhe kanë kujtime të të kaluarës komuniste, prireshin të ishin kryesisht ose plotësisht dakord me këtë deklaratë krahasuar me të anketuarit e moshës 18-30 vjeç që nuk kanë kujtime apo përvoja të drejtpërdrejta me të kaluarën komuniste. Megjithatë, siç u tregua edhe nga analizat e fokus grupeve, trashëgimia komuniste nuk perceptohet si faktor që nxit tolerancën fetare, por më shumë si një rrethanë në historinë shqiptare që keqinterpretoi sloganin e Rilindjes shqiptare (feja e shqiptarit është shqiptaria) për të përligjur armiqësinë e regjimit komunist ndaj fesë.

Edhe pse shumica e shqiptarëve e shohin jo-fetarinë dhe mungesën e informacionit për fetë si faktor që mundëson tolerancën fetare, të intervistuarit e sondazhit dhe pjesëmarrësit e fokus grupeve që janë besimtarë praktikantë nuk e shohin besimin fetar dhe tolerancën si përjashtuese të njëra tjetrës. Në fakt, të dy kategoritë e të anketuarve kanë një qëndrim të përbashkët kur thonë se vlerat qytetare dhe morale mbështesin tolerancën fetare.

Shqiptarët kanë një opinion më të mirë për tolerancën fetare në shoqërinë shqiptare në përgjithësi sesa për tolerancën fetare në mjedisin e tyre të afërt. Rreth 52 për qind e shqiptarëve

e vlerësonin shoqërinë e tyre si mesatarisht të ndërgjegjshme dhe tolerante për sa i përket fesë. Ky opinion ishte veçanërisht i përhapur tek të intervistuarit që banojnë në zonat rurale, ku 43 për qind kishin të njëjtin mendim për komunitetin në të cilin jetojnë. Megjithatë, të anketuarit nga zonat urbane prireshin ta konsideronin komunitetin e tyre si indiferentë ndaj fesë.

Rreth 10 për qind e të anketuarve mendojnë se nuk ka kërcënime serioze për tolerancën fetare në Shqipëri. Tre kërcënimet kryesore më të mundshme për tolerancën fetare janë si më poshtë:

- Terrorizmi, ekstremizmi fetar dhe nxitja e urrejtjes fetare
- Politizimi i fesë (diskriminimi fetar nga shteti apo ndërhyrja e fesë në çështjet shtetërore)
- Kërcënimet dhe propaganda e jashtme apo konfliktet jashtë

Edhe pse toleranca fetare konsiderohet si element kyç në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm me bazë fetare, ideologjia ekstremiste fetare minon seriozisht përpjekjet si për konsolidimin e tolerancës fetare ashtu edhe për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

## Eksperiencat e shqiptarëve me tolerancën fetare

Shqiptarët e ilustrojnë tolerancën fetare me shembuj të tillë si martesat fetare të përziera, kremtimin e festave fetare të grupeve të tjera dhe bashkëjetesën paqësore për shekuj me radhë mes shqiptarëve me përkatësi të ndryshme fetare si dhe me mungesën e konflikteve fetare. Roli i sekularizmit dhe mosdiskriminimit me bazë fetare nga ana e shteti vlerësohet dhe ngrihet si shembull i tolerancës fetare në vend. Në këtë studim, përvojat personale të të anketuarve me tolerancën fetare përgjithësisht bien dakord me shembujt e mësipërm, ku disa të anketuar në këtë sondazh dhanë shembuj të tjerë personalë që lidhen me tolerancën fetare.

*“Ndonjëherë njerëzit janë më pak të hapur kur flas për fenë time dhe ndonjëherë duan të dinë më shumë. Kjo është tolerancë!”*



*I intervistuar mysliman, banor në një komunitet me shumicë katolike*

Shqiptarët prirën ta shpërfillin përkatësinë fetare kur bëhet fjalë për cilësi të tilla si punëtor, miqësor, inteligjent, i dhunshme ose përtac. Shumica e të anketuarve deklaruan se feja nuk është përcaktuese për karakterizimin e njerëzve në lidhje me këto cilësi. Kjo u deklarua edhe nga shumica e të intervistuarve kur u pyetën nëse ata do të ndiheshin të kërcënuar ose të stresuar kur mendonin për anëtarët e grupeve të tjera fetare.

Edhe pse mbi 95 për qind e të anketuarve deklaruan se ata personalisht, ose anëtarë të familjeve të tyre, nuk ishin diskriminuar ose përjashtuar për shkak të përkatësisë fetare, rreth 11 për qind thanë se ata kanë qenë dëshmitarë në të paktën një rast të tillë në komunitetet ku jetojnë. Pjesa më e madhe e këtij grupi ishin gra, të intervistuar nga zonat urbane dhe që kishin përfunduar

arsimin universitar ose pasuniversitar, gjë që tregon nivelin e ndërgjegjësimit fetar dhe formave të tjera të diskriminimit dhe përjashtimit tek shqiptarët.

Pjesëmarrësit në këtë sondazh dhanë shembuj të ndryshëm të diskriminimit, kryesisht në lidhje me diskriminimin dhe përjashtimin të njerëzve që praktikojnë fenë (sidomos myslimanët), siç janë diskriminimi ose përjashtimi nga sektori publik dhe ai privat (p.sh. përjashtimi nga shkolla ose refuzimi i punësimit nga institucionet dhe kompanitë private), paragjykimet dhe përjashtimi shoqëror dhe diskriminimi në marrëdhënie të ngushta (p.sh. refuzim martesash e krushqish për shkak të përkatësisë fetare), ndër të tjera.

Rreth 4-9 për qind e shqiptarëve e marrin parasysh përkatësinë fetare kur bëhet fjalë për marrëdhënie më të ngushta personale. Megjithëse shumica e të anketuarve (> 90%) ishin shumë të hapur për pranimin e anëtarëve të grupeve të tjera fetare në poste pune, qeverisjeje dhe mjedisi politik (p.sh. kryetar bashkie, drejtues politik, mësues, bashkëpunëtor ose shef/mbikëqyrës) disa të intervistuar ishin më pak të hapur kur bëhej fjalë për pranimin e tyre si të afërm për shkak të krushqisë ose si shokë të ngushtë. Kështu, 89.5 për qind e të anketuarve deklaruan se kishte gjasa ose shumë gjasa që të pranonin anëtarë të feve të tjera si shokë të ngushtë dhe 83.4 për qind si krushq. Ky studim konstaton se të anketuarit që e konsiderojnë veten si besimtarë praktikantë të rregullt të fesë përen të jenë më pak të hapur për pranimin e anëtarëve të grupeve të tjera fetare në lidhje krushqie.

Një shumicë e madhe (87-93%) e shqiptarëve nuk ishin dakord ose aspak dakord me qëndrimet që fajësonin njerëzit e besimeve të tjera për gjendjen ekonomike, krimin, mungesën e vendeve të punës dhe korrupsionin e vlerave të shoqërisë. Një shumicë e konsiderueshme nuk ishin dakord ose aspak dakord me qëndrimet që fajësonin njerëzit e besimeve të tjera edhe për trazirat e kësaj bote, ndonëse rreth 14 për qind nuk ishin dakord ose aspak dakord.



# VIII. BIBLIOGRAFIA

- Clobert, M. et al. (2014) East Asian Religious Tolerance – A Myth or a Reality. *Empirical Investigations of Religious Prejudice in East Asian Societies, Journal of Cross-Cultural Psychology*, 45 (10): 1515–1533.
- Cohen, A. J. (2004) What Toleration Is, *Ethics*, 115: 68–95.
- Eisenstein, M. A. (2008) *Religion and the Politics of Tolerance: How Christianity Builds Democracy*. Waco: Baylor University Press.
- Endresen, C. (2010) 'Do Not Look to Church and Mosque'? Albania's Post-Communist Clergy on Nation and Religion, in Schmitt, O. J. (ed.), *Religion und Kultur im albanisch-sprachigen Südosteuropa*. Frankfurt am Main: Peter Lang.
- Endresen, C. (2015) Faith, Fatherland or Both? Accommodationist and Neo-Fundamentalist Islamic Discourses in Albania, in Elbasani, A. & Roy, O. (eds.), *The Revival of Islam in the Balkans: From Identity to Religiosity*. Basingstoke: Palgrave Macmillan.
- Hayden, R. et al. (2016) *Antagonistic Tolerance: Competitive Sharing of Religious Sites and Spaces*. London; New York: Routledge.
- Instituti i Statistikave INSTAT (2011) Regjistrimi i popullsisë dhe banesave në Shqipëri
- Ioannou, M. Lordos, A. & Filippou, G. (2015) The SCORE: From concepts to metrics. UNDP.
- Küpper, B. Zick, A. and Hövermann, A. (2011) *Intolerance, Prejudice and Discrimination: A European Report*. Berlin: Friedrich-Ebert-Stiftung
- Kymlicka, W. (1995) *Multicultural Citizenship: A Liberal Theory of Minority Rights*. Oxford: Clarendon Press.
- Lordos, A. and Louise, C. (2015) The future of the SCORE Index
- Roy, O. (2010) *Holy Ignorance: When Religion and Culture Part Ways*. Oxford: Oxford University Press.
- Scanlon, T. M. (1996) The Difficulty of Tolerance, in Heyd, D. (ed.) *Toleration: An Elusive Virtue*. Princeton: Princeton University Press.
- Stepan, A. (2000) Religion, Democracy, and the 'Twin Tolerations', *Journal of Democracy*, 11 (4): 37–57.
- Sulstarova, E. (2017) Shqiptaria si fe civile (English "Albanianism as a civic religion"), *Shenja*, nr. 73 (maj), Shkup, f. 62–64.
- Tan, C. (2008) Creating 'Good Citizens' and Maintaining Religious Harmony in Singapore, *British Journal of Religious Education*, 30 (2): 133–142.
- Tosic, J. (2015) The Loudspeaker of Faith in the 'Calm' City, in Elbasani, A. & Roy, O. (eds.), *The Revival of Islam in the Balkans: From Identity to Religiosity*. Basingstoke: Palgrave Macmillan.
- Turner, B. S. (2010) Religion in a Post-Secular Society, in Turner, B. S. (ed.), *The Sociology of Religion*. Malden (MA): Wiley-Blackwell.
- University of Oslo (2013) Survey on Strategies of Symbolic Nation-Building in West Balkan States – Albania. Available on the Internet: [http://www.hf.uio.no/ilos/forskning/prosjekter/nation-w-balkan/dokumenter/nb\\_albania-wine-summer.pdf](http://www.hf.uio.no/ilos/forskning/prosjekter/nation-w-balkan/dokumenter/nb_albania-wine-summer.pdf) (accessed on May 23, 2017).
- Widmalm, S. & Oskarsson, S. (2008) *Tolerance and Democracy in Liberal and Authoritarian Market Economies*. Stockholm: Glasshouse Forum.

# IX. SHTOJCAT

## IX.1. Pyetësi i sondazhit

### TOLERANCA FETARE NË SHQIPËRI

#### PYETËSORI

Letër e pëlqimit pas marrjes së informacionit

Unë quhem \_\_\_\_\_ dhe punoj për Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, si pjesë e një grupi hulumtues, i cili po zhvillon një anketim mbi tolerancën fetare në Shqipëri. Studimi mbështetet nga UNDP (PNUD) Shqipëri dhe ka për qëllim të analizojë tolerancën fetare në Shqipëri, kontekstin e saj dhe faktorët mundësues.

Gjetjet e studimit do të informojnë politikë-bërjen në vend për të përforcuar faktorët që inkurajojnë tolerancën dhe harmoninë fetare në Shqipëri, si dhe për të parandaluar/minimizuar faktorët që mund ta vënë në rrezik atë. Individëve që marrin pjesë në këtë studim nuk u ofrohen përfitime materiale.

Unë do t'ju bëj disa pyetje rreth fesë dhe besimeve, praktikave fetare dhe qëndrimeve, si edhe rreth perceptimeve mbi tolerancën fetare në Shqipëri. Ju mund të vendosni të mos merrni pjesë në anketim, ose mund të më bëni me dije që preferoni të mos i përgjigjeni një pyetjeje specifike dhe unë do ta kapërcej atë pyetje. Nuk është e nevojshme që t'i përgjigjeni pyetjeve që ju bëjnë të ndiheni jo-komod, si edhe duhet të keni parasysh që nuk ka përgjigje të drejtë apo të gabuar. Nëse dëshironi, ju mund ta përfundoni intervistën në çdo kohë dhe kjo nuk do të ndikojë në marrëdhënien tuaj me IDM-në apo me financuesit e projektit.

Ne garantojmë që i gjithë informacioni që ju do të na jepni gjatë plotësimit të këtij pyetësi do të jetë konfidencial, duke garantuar privatësinë tuaj. Të vetmit njerëz që do të kenë akses mbi këtë informacion janë hulumtuesit e studimit. Kur të paraqesim rezultatet e studimit, ne nuk do t'i bëjmë lidhje emrit tuaj/ të dhënave personale me gjithçka që ju shprehët.

Për çdo pyetje rreth studimit, ose nëse shfaqen probleme, ju mund të kontaktoni IDM në [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org) ose tel. 04 24 00 241.

#### PËR ANKETUESIN: SHËNO TË DHËNAT E INTERVISTËS

Kodi i Anketuesit	Intervista nr.	Bashkia	Qyteti	Fshati

## Të dhënat demografike

1. Gjinia

Mashkull	1
Femër	2

2. Mosha \_\_\_\_\_ (në vite)

3. Cili është niveli më i lartë i arsimit që keni përfunduar?

Pa arsim	1
Arsim 8/9 vjeçar	2
Arsim i mesëm	3
Arsim i lartë	4
Arsim pasuniversitar	5
Refuzim	88

4. A jeni aktualisht i punësuar?

Jo, nuk kam qenë ndonjëherë	1
Jo për momentin	2
Po, i/e punësuar në sektorin privat	3
Po, i/e punësuar në sektorin publik	4
Po, i/e vetëpunësuar	5
Tjetër (Specifiko _____)	6
Refuzim	88

5. Sa janë të ardhurat (neto) tuaja personale mujore?

Pa të ardhura personale	1
Deri në 20.000 lekë	2
20.001- 40.000 lekë	3
40.001- 60.000 lekë	4
60.001 – 100.000 lekë	5
+100.000 lekë	6
Refuzim	88

6. Cila është përkatësia fetare e familjes suaj të origjinës?

Myslimane	1
Ortodokse	2
Katolike	3
Bektashi	4
Protestante	5
E përzier	6
Tjetër _____	7
Refuzim	88
Nuk e di/ Nuk jam i sigurt	99

7. Personalisht ju si individ, a i përkisni të njëjtit besim fetar si familja juaj e origjinës?

Po (KALO TEK PYETJA 9)	1
Jo	2
Refuzim	88
Nuk e di/ Nuk jam i sigurt	99

8. Nëse jo, cila përkatësi fetare është më afër besimit/praktikave tuaja?

Mysliman	1
Ortodoks	2
Katolik	3
Bektashi	4
Protestant	5
Tjetër _____	6
Jam Ateist	7
Refuzim	88
Nuk e di/ Nuk jam i sigurt	99

9. A e konsideroni veten një besimtar praktikant të fesë suaj?

Po	1
Jo	2
Refuzim	88
Nuk e di / Nuk jam i sigurt	99

10. A mendoni se identifikoheni si besimtar praktikant nga rrethi juaj shoqëror ose i punës?

Po	1
Jo	2
Refuzim	88
Nuk e di / Nuk jam i sigurt	99

11. Sa njohuri mendoni se keni rreth fesë së komuniteteve fetare si më poshtë:

	Aspak njohuri	Pak	Deri diku	Të mjaftueshme	Njohuri shumë të mira	Refuzim
a) Myslimane	1	2	3	4	5	88
b) Ortodokse	1	2	3	4	5	88
c) Katolike	1	2	3	4	5	88
d) Bektashi	1	2	3	4	5	88
e) Protestante	1	2	3	4	5	88

## A. Individi dhe hyjnorja/e shenjta

12. Deri në çfarë mase jeni dakord me deklaratat e mëposhtme në një shkallë nga 1 (Aspak dakord) në 5 (Plotësisht dakord):

	Aspak dakord	Kryesisht jo-dakord	Asnjë	Kryesisht Dakord	Plotësisht dakord	Refuzim/ NA
a) Besimi im fetar përfshin çdo aspekt të jetës sime	1	2	3	4	5	88
b) Edhe pse jam besimtar, nuk lejoj që pikëpamjet fetare të ndikojnë në aktivitetet e mia të përditshme.	1	2	3	4	5	88
c) Edhe pse besoj në fenë time, mendoj që ka gjera të tjera më të rëndësishme në jetë.	1	2	3	4	5	88
d) Besimi im fetar shpesh kufizon veprimet e mia.	1	2	3	4	5	88
e) Nuk ka shumë rëndësi se çfarë besoj, për aq kohë sa bëj një jetë të moralshme	1	2	3	4	5	88

13. Deri në çfarë mase jeni dakord me deklaratat e mëposhtme në një shkallë nga 1 (Aspak dakord) në 5 (Plotësisht dakord):

	Aspak dakord	Kryesisht jo-dakord	Asnjë	Kryesisht Dakord	Plotësisht dakord	Refuzim/ NA
a) Vetëm një fe është e vërtetë; fetë e tjera janë false	1	2	3	4	5	88
b) Në thelb të gjitha fetë të mësojnë të njëjtat vlera të shenjta	1	2	3	4	5	88
c) Të kesh besim është shumë e rëndësishme, por se çfarë besimi konkretisht, është më pak e rëndësishme	1	2	3	4	5	88
d) Disa fe janë me afër të vërtetës se disa të tjera	1	2	3	4	5	88
e) Lutja/Falja mund të jetë e vlefshme vetëm nëse i lutesh / falesh Emrit të duhur Hyjnor	1	2	3	4	5	88
f) Shumë nga fetë kryesore kanë mësim të njëjta morale; Ju mund të jeni një person i mirë pavarësisht fesë që keni pranuar	1	2	3	4	5	88
g) Nëse je i sjellshëm dhe i dashur, do jesh pranë shpëtimit, pavarësisht fesë që beson/praktikon	1	2	3	4	5	88

14. Mund të më thoni se sa shpesh luteni / faleni:

Rregullisht (çdo ditë / javë) (1)	Në festa fetare përgjatë gjithë vitit (2)	Vetëm me raste, në ngjarje të veçanta fetare (3)	Vetëm me raste, në kohë krize personale/familjare (4)	Asnjëherë (5)	Refuzim (88)
-----------------------------------	---	--	---	---------------	--------------

15. Deri në çfarë mase jeni dakord me deklaratat e mëposhtme në një shkallë nga 1 (Aspak dakord) në 5 (Plotësisht dakord):

	Aspak dakord	Kryesisht jo-dakord	Asnjëherë	Kryesisht Dakord	Plotësisht dakord	Refuzim/ NA
a) Zoti (Besimi) im është Zoti (Besimi) i vetëm i vërtetë	1	2	3	4	5	88
b) Praktikimi i fesë nuk ka të bëjë fare me rritet fetare, por më tepër me besimin në Zot	1	2	3	4	5	88

16. Cila nga deklaratat e mëposhtme ju përshkruan më mirë ju personalisht?  
(VETËM NJË PËRGJIGJE)

Unë besoj në Zot dhe i praktikoj rregullisht të gjitha ritet e fesë sime

Unë besoj në Zot dhe praktikoj rregullisht shumicën e riteve të fesë sime

Unë besoj në Zot dhe praktikoj me raste ritet e fesë sime

Unë besoj në Zot por nuk i praktikoj ritet e fesë sime

Unë nuk besoj në Zot

Tjetër (Specifiko): \_\_\_\_\_

(88) Refuzim

(99) Nuk e di

## B. Perceptime mbi tolerancën fetare në Shqipëri

17. Deri në çfarë mase jeni dakord me deklaratat e mëposhtme në një shkallë nga 1 (Aspak dakord) në 5 (Plotësisht dakord):

	Aspak dakord	Kryesisht jo-dakord	Asnjëherë	Kryesisht Dakord	Plotësisht dakord	Refuzim
a) Toleranca fetare është një vlerë themelore në Shqipëri.	1	2	3	4	5	88
b) Drejtuesit e komuniteteve fetare luajnë një rol thelbësor në nxitjen e tolerancës fetare në vend	1	2	3	4	5	88
c) Klerikët fetarë në nivel vendor ushqejnë vlerat e tolerancës fetare tek besimtarët	1	2	3	4	5	88
d) Ndjenjat kombëtare ushqejnë tolerancën fetare në Shqipëri	1	2	3	4	5	88
e) Toleranca fetare është më e fortë në nivel vendor ku ka komunitete të përziera	1	2	3	4	5	88
f) Sekularizmi (ndarja e shtetit nga feja) ka forcuar tolerancën fetare në Shqipëri	1	2	3	4	5	88
g) Toleranca fetare në Shqipëri i detyrohet faktit që shqiptarët në përgjithësi nuk janë shumë fetarë	1	2	3	4	5	88
h) Kombësia e njëjtë është ajo që e bën të mundur tolerancën fetare në Shqipëri	1	2	3	4	5	88
i) Përfaqësimi i drejtë i komuniteteve fetare në administratën shtetërore është i rëndësishëm për tolerancën fetare në vend	1	2	3	4	5	88
j) Në Shqipëri shteti nuk i ndërhyr individit në besimin e vet fetar	1	2	3	4	5	88
k) Simbolet dhe ritualet fetare nuk duhet të lejohen në administratën publike ose në shkollë	1	2	3	4	5	88
l) Komunitetet fetare duhet të marrin financime nga buxheti i shtetit për të realizuar aktivitetet e tyre	1	2	3	4	5	88
m) Politikat komuniste kundrejt fesë (ndalimi i fesë) në periudhën 1967-1990 kanë kontribuar në tolerancën fetare në Shqipëri	1	2	3	4	5	88
n) Mungesa e informacionit për fetë e tjera i bën njerëzit të jenë më tolerantë ndaj tyre.	1	2	3	4	5	88

18. Sipas jush, cili është faktori më i rëndësishëm që mundëson tolerancën fetare në Shqipëri?

19. Ku do e rendisnit shoqërinë shqiptare sot, në një shkallë nga 1 (indiferencë e plotë fetare) deri në 5 (njohje e plotë dhe pranim i besimit fetar të tjetrit)?

(Indiferencë e plotë fetare)	2	3	4	Njohje e plotë & pranim i besimit fetar të tjetrit	Nuk e di / Refuzim
1	2	3	4	5	88

20. Ku do e rendisnit komunitetin ku jetoni, në një shkallë nga 1 (indiferencë e plotë fetare) deri në 5 (njohje e plotë dhe pranim i besimit fetar të tjetrit)?

(Indiferencë e plotë fetare)	2	3	4	Njohje e plotë & pranim i besimit fetar të tjetrit	Nuk e di / Refuzim
1	2	3	4	5	88

21. Sipas jush, cili është kërcënimi më i madh ndaj tolerancës fetare në Shqipëri?

---



## C. Qëndrimet dhe eksperiencat lidhur me tolerancën fetare

22. Sa shpesh i keni përjetuar ngjarjet e mëposhtme:

	Kurrë	Rrallë, me raste	Shpesh	Rregullisht	Refuzim/ NA (88)
a. Unë personalisht jam diskriminuar /përgjashtuar për shkak të përkatësisë fetare.	1 Shko tek P. 24	2	3	4	88 Shko tek P. 24
b. Një anëtar i familjes sime është diskriminuar / përgjashtuar personalisht për shkak të përkatësisë fetare.	1 Shko tek P. 24	2	3	4	88 Shko tek P. 24
c. Kam qenë dëshmitar i diskriminimit / përgjashtimit me bazë fetare të njerëzve të tjerë në komunitetin ku jetoj	1 Shko tek P. 24	2	3	4	88 Shko tek P. 24

23. Ju lutem përshkruani shkurt një rast të diskriminimit / përgjashtimit me bazë fetare që ju keni përjetuar ose keni dëshmuar:

---



---



---

24. Në komunitetin ku jetoni, si do t'i vlerësonit anëtarët e grupeve të tjera fetare përsa i përket cilësive të mëposhtme?

		Aspak... (1)-	2 Pak ...	3 Deri diku...	4 ...	Shumë... (5)	Feja nuk është përcaktor	Refuzim/ Nuk e di (88)
a) Punëtorë	a. Myslimane	1	2	3	4	5	6	88
	b. Ortodokse	1	2	3	4	5	6	88
	c. Katolike	1	2	3	4	5	6	88
	d. Bektashi	1	2	3	4	5	6	88
	e. Protestante	1	2	3	4	5	6	88
b) Miqësorë	a. Myslimane	1	2	3	4	5	6	88
	b. Ortodokse	1	2	3	4	5	6	88
	c. Katolike	1	2	3	4	5	6	88
	d. Bektashi	1	2	3	4	5	6	88
	e. Protestante	1	2	3	4	5	6	88
c) Inteligjentë	a. Myslimane	1	2	3	4	5	6	88
	b. Ortodokse	1	2	3	4	5	6	88
	c. Katolike	1	2	3	4	5	6	88
	d. Bektashi	1	2	3	4	5	6	88
	e. Protestante	1	2	3	4	5	6	88

d) Të dhunshëm	a. Myslimane	1	2	3	4	5	6	88
	b. Ortodokse	1	2	3	4	5	6	88
	c. Katolike	1	2	3	4	5	6	88
	d. Bektashi	1	2	3	4	5	6	88
	e. Protestante	1	2	3	4	5	6	88
e) Përtacë	a. Myslimane	1	2	3	4	5	6	88
	b. Ortodokse	1	2	3	4	5	6	88
	c. Katolike	1	2	3	4	5	6	88
	d. Bektashi	1	2	3	4	5	6	88
	e. Protestante	1	2	3	4	5	6	88

25. Në komunitetin ku jetoni, përgjithësisht si ndiheni kur mendoni për anëtarëve të grupeve të tjera fetare?

		Strongly disagree		Neutral		Strongly agree	Religion is not determinant	Refusal/ don't know
a) Threatened	a. Muslim	1	2	3	4	5	6	88
	b. Orthodox	1	2	3	4	5	6	88
	c. Catholic	1	2	3	4	5	6	88
	d. Bektashi	1	2	3	4	5	6	88
	e. Protestant	1	2	3	4	5	6	88
b) Calm	a. Muslim	1	2	3	4	5	6	88
	b. Orthodox	1	2	3	4	5	6	88
	c. Catholic	1	2	3	4	5	6	88
	d. Bektashi	1	2	3	4	5	6	88
	e. Protestant	1	2	3	4	5	6	88
c) Distressed	a. Muslim	1	2	3	4	5	6	88
	b. Orthodox	1	2	3	4	5	6	88
	c. Catholic	1	2	3	4	5	6	88
	d. Bektashi	1	2	3	4	5	6	88
	e. Protestant	1	2	3	4	5	6	88

26. Sa gjasa ka që ju të pranoni një person të një besimit tjetër (nga ju) fetar si:

	Completely unlikely		Neutral		Very likely	Refusal/ don't know
a) Political leader	1	2	3	4	5	88
b) Mayor of municipality, or head of administrative unit	1	2	3	4	5	88
c) Policeman in the area where you live	1	2	3	4	5	88
d) Teacher in your children's school	1	2	3	4	5	88
e) Boss or supervisor	1	2	3	4	5	88
f) Co-worker	1	2	3	4	5	88
g) Neighbours (next door)	1	2	3	4	5	88
h) Close friend	1	2	3	4	5	88
i) Relative	1	2	3	4	5	88

27. Deri në çfarë shkalle deklaratat e mëposhtme reflektojnë qëndrimet tuaja?

	Aspak dakord	Kryesisht jo-dakord	Asnjëherë	Kryesisht Dakord	Plotësisht dakord	Refuzim/ Nuk e di
a. Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për shumë prej trazirave në botë	1	2	3	4	5	88
a. Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për ekonominë e dobët në vend	1	2	3	4	5	88
a. Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për nivelin e lartë të kriminalitetit në vend	1	2	3	4	5	88
a. Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për më pak vende pune në vend	1	2	3	4	5	88
a. Unë fajësoj njerëzit e feve të tjera për korruptimin e vlerave të shoqërisë sonë	1	2	3	4	5	88

**28. JEPNI NJË SHEMBULL TË TOLERANCËS FETARE NË KOMUNITETIN TUAJ :**

---



---



---

**29. JU LUTEM PËRSHKRUANI NJË EKSPERIENCË PERSONALE NË LIDHJE ME TOLERANCËN FETARE:**

---



---



---

**JU FALEMINDERIT!**

## IX.2. SHPËRNDARJA E KAMPIONIT TË SONDAZHIT

Bashkia	Nr. i të intervistuarve nga zonat urbane	Nr. i të intervistuarve nga zonat rurale	Gjithsej nr. i të intervistuarve
Berat	17	9	26
Bulqizë	4	9	13
Cërrik	4	8	12
Devoll	3	9	12
Dibër	6	20	26
Divjakë	4	11	15
Durrës	53	24	77
Elbasan	39	24	63
Fier	23	29	52
Finiq	-	5	5
Gjirokastrë	7	4	11
Kamëz	31	15	46
Kavajë	9	8	17
Konispol	1	3	4
Korçë	22	11	33
Krujë	14	12	26
Kuçovë	7	7	14
Kukës	8	12	20
Kurbin	14	3	19
Lezhë	11	18	29
Librazhd	4	10	14
Lushnjë	15	21	36
Malësi e Madhe	5	8	13
Maliq	2	15	17
Mallakastër	3	8	11
Mat	5	7	12
Mirditë	4	5	9
Peqin	3	9	12
Përrenjas	3	7	10
Pogradec	11	15	26
Rrogozhinë	3	6	9
Sarandë	8	2	10
Shijak	4	10	14
Shkodër	33	26	59
Skrapar	5	-	5
Tiranë	207	37	244
Ura Vajgurore	4	8	12
Vau i Dejës	4	8	12
Vlorë	33	13	46
Vorë	6	5	11
<b>Gjithsej</b>	<b>639</b>	<b>461</b>	<b>1,100</b>





*Empowered lives.  
Resilient nations.*

**United Nations Development Programme Albania**  
Rruga "Skenderbej", Godina Gurten, Kati i dytë,  
Tirana, Albania

Për më shumë informacion: <http://www.al.undp.org>

*Copyright ©UNDP 2018. Të gjitha të drejtat e rezervuara*